6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë)”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): - Punime ndërtimi për autostrada, rrugë_45233100-0

8. Fondi limit: 2,165,325,695 (dy miliard e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e treqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH

9. Situata sipas parashikimeve të Nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Bazuar në Nenin 127 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, jemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas përcaktimit të këtij neni.

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka në zbatim kontratën Nr. 3494/5 prot, datë 10.06.2022 me objekt: “Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë)”, me REF-21837-03-11-2022.

- Vlera e kontratës është 2,164,693,349.44 Lekë (pa përfshirë vlerën e TVSH-së).

*Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe e Operacioneve me shkresën Nr. 5320 prot, datë 17.07.2024, ka paraqitur relacionin teknik, në të cilin janë paraqitur dhe prezantuar të gjitha shkaqet që kanë çuar në nevojën për këtë modifikim kontrate.

Afati i kësaj kontrate është 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Njoftimi për fillimin e punimeve datë 13.06.2022. Punimet janë pezulluar më datë 26.10.2023, raportuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, konform Udhëzimit nr. 2, datë 18.03.2022 “Mbi Raportimin e Zbatimit të Kontratës”.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën Nr. 1707/3 prot, datë 18.03.2024 “Detajimi pjesor i buxhetit për shpenzimet kapitale për vitet 2024-2026...” ka miratuar këtë projekt, me detajimin përkatës. Financimi për vitin 2024 është 104,000,000 Lekë me TVSH.

Propozimet, të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar nga Mbikëqyrësi i punimeve, janë bërë për arsye të mëposhtme:

Rishikim i projektit të urës mbi përroin e Selenicës;

Rishikim i projektit në lidhje me përmirësimin e tabanit të rrugës;

Ndryshime të volumeve për shkak të mospërputhjes së projektit me faktin në terren;

Ndryshim të volumeve për shkak të mospërputhjes së projektit me preventivin.

Bazuar në Ligjin Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Nenin 127, pika 1/b “Modifikim Kontrate” citohet:

“Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme:

“b) për furnizimin e mallrave, shërbimeve apo kryerjen e punëve në një kontratë që është ende në zbatim nga kontraktori fillestar, të cilat janë bërë të domosdoshme dhe nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit për kontratën fillestare dhe kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar:

i. nuk është i mundur për arsye ekonomike apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruar gjatë procedurës fillestare; si dhe

ii. do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor.

si dhe Nenit 26 “Modifikimi i Kontratës”, të kontratës bazë, pikat:

26.1 Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

26.2 Autoriteti/Enti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm:

Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve

Korrigjime në materiale

Korrigjime në sasi

26.3 Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për

përlllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

26.4 Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Autoritetit/Entin Kontraktor, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktorit dhe Autoritetit/Entin Kontraktor.

Argumentojmë se ndodhemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas parashikimit ligjor të sipërcituar.

Bazuar në pikën 6 të Nenit 127 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet:

“Arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës ose të marrëveshjes kuadër duhet të dokumentohen nga autoriteti ose enti kontraktor”; dhe

në pikën 7 të këtij neni “Në rastet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një argumentim të të gjitha arsyeve se përse furnizimet, shërbimet ose punët janë të nevojshme, arsyet përse ato nuk janë mbuluar nga kontrata fillestare apo marrëveshja kuadër, si dhe arsyet ekonomike dhe teknike prej të cilave nuk mund të zëvendësohet kontraktuesi fillestar.

Ju bëjmë me dije se propozimet e Mbikëqyrësit, të cilat konsistojnë në përmirësimin e projektit pas shqyrtimit në Këshillin Teknik të ARRSH-së janë miratuar në parim me Vendimin e Këshillit Teknik Nr. 17, datë 22.05.2023. Referuar modifikimit të kësaj kontrate, rishikimi i projektit lind si nevojë gjatë zbatimit të projektit, në të cilat një nga detyrat e Mbikëqyrësit e mirëpërcaktuar në Termat e Referencës është si më poshtë:

“Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikëqyrësi i punimeve duhet t'i paraqesë ARRSH-së një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse), ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga ARRSH-ja”.

si dhe referuar Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”, Kreu I, pika 7.2 në të cilin citohet:

“Propozimet për rritjen e vlefës së kontratës dhe zgjatjen e afatit të punimeve i paraqiten investitorit, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, kur ato përmirësojnë treguesit e veprës, vijnë nga shkaqe pamundësisht të paparashikueshme, në kohën e duhur dhe nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës”.

Më pas, miratimi nga ARRSH kryhet në parim nga Këshilli Teknik i Autoritetit Rrugor Shqiptar, i mbledhur nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH-së (Kryetar); drejtorë të drejtorive të ARRSH-së; dhe specialistë të fushës. Pas miratimit nga Këshilli Teknik i ARRSH-së, Mbikëqyrësi i punimeve dorëzon materialin e nënshkruar për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Propozimet janë bërë për arsyet e mëposhtme:

Rishikim i projektit të urës mbi përroin e Selenicës;

Rishikim i projektit në lidhje me përmirësimin e tabanit të rrugës;

Ndryshime të volumeve për shkak të mospërputhjes së projektit me faktin në terren;

Ndryshim të volumeve për shkak të mospërputhjes së projektit me preventivin.

Konkretisht:

Nga progresivi 11+764.83-11+876.08 në projektin e zbatimit ishte parashikuar ndërtim i një ure me HD (4x29) m që kalon mbi përroin e Selenicës, si dhe mbushje me terramesh me lartësi H=18 m dhe gjatësi L= 108 m. Gjatë zbatimit rezultoi se ura e parashikuar në projektin e tenderuar nuk e mbulonte gjerësinë e shtratit të lumit, i cili në periudha të ndryshme të vitit zgjeron shtratin e tij. Në këto kushte, u miratua propozimi për ndërtimin e një ure me HD (7x30) m midis progresivit 11+697-11+90, me gjatësi L= 209.4 m, e cila mbulon gjerësinë e shtratit të lumit. Ndërtimi i kësaj ure me HD (7X30) m zvogëlon ndjeshëm mbushjen me mur terramesh, e cila nga një mbushje me gjatësi L=108 m realizohet me një gjatësi L= 12 m.

Rishikim i projektit në lidhje me përmirësimin e tabanit të rrugës në seksionet 409-424; 432-445; 456-461; 646-653; 478-496 për shkak se gjatë zbatimit të punimeve është hasur prezencë e ujërave në thellësinë e gjermimit 2,5-3 m (zonë kënetore me përbërje torfike e argjila të ngopura). Prania e ujit në kuotën e tabanit të rrugës e bën të pamundur ndërtimin e shtresave rrugore. Në këto kushte, u miratuan propozimet për ndërtimin e drenazheve tërthore dhe gjatësore, përdorimi i materialeve të fraksionuara të rrethuar me gjeotekstil, si dhe përdorimi i gjeodrenantit dhe gjeogridit biaxial me gjeotekstil për të shmangur deformimet e trupit të rrugës.

Gjatë zbatimit të punimeve rezultoi se lartësia e disa mureve nuk përputhej me lartësinë sipas terrenit, duke kërkuar rritjen e lartësisë apo edhe të gjatësisë së këtyre mureve. Gjithashtu, në piketat 168-175 është propozuar ndërtimi i një kanali të hapur me L= 190 m për të mbledhur ujërat që grumbullohen nga sipërfaqja e skarpateve për t'i shkarkuar ato në box në seksionin 167. Mospërputhja e projektit me faktin në terren sjell edhe ridimensionimin e gjatësisë së tombinove rrethore.

Për shkak të ndërprerjes së aksit të rrugës me linjat e tensionit të lartë në seksionin 198 dhe 256, si dhe nisur nga fakti që traseja e rrugës është jo mbi rrugë ekzistuese, u propozua spostimi i aksit të rrugës për të shmangur spostimin e linjës së tensionit të lartë me një kosto relativisht të konsiderueshme. Nga spostimi i aksit rrugor midis seksionit 198-256, trupi i ri i rrugës shmangte edhe një zonë me rrëshqitshmëri të lartë dhe me strukturë të degraduar, e cila kërkonte masa mbrojtje inxhinierike.

Gjatë zbatimit të projektit kanë rezultuar edhe mospërputhje të projektit me preventivin, për sa i përket zërit të shtresave rrugore (asfaltobeton me trashësi 5 cm dhe binder me trashësi 6 cm), punimeve të gjermimit, punimeve për linjën e fibrës optike, punimet për sinjalistikën horizontale dhe vertikale.

Në total:

Për realizimin e punimeve për përfundimin e punimeve të këtij objekti me ndryshimet e bëra vlera e këtij objekti është: 2,596,932,014.52 Lekë pa TVSH

Vlera e punimeve sipas projektit të tenderuar: 2,164,693,349.44 Lekë pa TVSH

Fondi rezervë: 63,049,320.86 Lekë pa Tvsh (përdorur)

Vlera e modifikimit të kontratës: 432,238,665.08 Lekë pa TVSH

Sqarojmë se vlera e punimeve jashtë kontrate e tejkalon disa herë vlerën e fondit rezervë, fond, i cili është ezauruar për pjesën e punimeve, të cilat janë realizuar në radhë teknologjike më përpara se të lindte nevoja për punimet jashtë kontrate.

Me Vendimin e Këshillit Teknik është vendosur:

Vlera e punimeve që mbeten jashtë vlerës së preventivit të kontratës së tenderuar prej: 432,238,665.08 Lekë pa TVSH të merren në preventivin me objekt: “Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë)” (Modifikim projekti).

Punimet e përfshira në preventivin “Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë)” janë domosdoshmëri të kryhen nga Kontraktori, aktualisht, për shkak të 3 arsyeve:

Punime të ndërthurura me kontratën bazë

Këto punime janë të ndërthurura me punimet e kontratës bazë, në mënyrë të tillë që e bëjnë të pamundur ndarjen e tyre fizike në terren. Prandaj, në gjykimin tonë, këto punime duhet të kryhen nga kontraktori ekzistues, pasi nëse punimet e mbetura jashtë kontrate do të realizohen nga një operator tjetër duhet që fillimisht të përfundojnë punimet e kontratës bazë, të kolaudohet objekti dhe të lirohet sheshi i ndërtimit për të bërë të mundur fillimin e punimeve nga operatori tjetër, pasi nuk mund të punojnë njëkohësisht dy operatorë ekonomikë në të njëjtin shesh ndërtimi. Kjo gjë nuk mund të ndodhë, sepse punimet janë të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe kryerja e punimeve për disa zëra të kontratës bazë varet nga realizimi i punimeve të disa zërave të mbetur jashtë kontratës.

Zero kosto për ndërtimin e kantierit

Kontraktori ekzistues e ka kantierin e ngritur me mjetet dhe stafin teknik të gatshëm për realizimin e punimeve të mbetura. Gjithashtu është i familjarizuar me realizimin e projektit.

Garant për punimet e kryera

Nëse punimet e mbetura do të realizohen nga një operator tjetër do të kemi rritje të kostos dhe zgjatje të afatit të përfundimit të punimeve për shkak të korigjimit të defekteve të punimeve të kryera më parë. Ndërsa, kontraktori ekzistues është vetë garant i punimeve që ka realizuar.

Kostoja e ndërtimit

Nuk mundet kurrësesi që një operator të ofertojë më lirë se ai aktual, duke pasur parasysh:

Pavarësisht që punimet jashtë kontratës bazë përfshijnë segmente shumë më të vogla të rrugës në lidhje me segmentin rrugor të kontratës bazë, mobilizimi dhe kërkesat që duhet të plotësojë kontraktori fitues i punimeve jashtë kontrate janë të njëjta sikurse ato të kontraktorit fillestar, për vete kompleksitetin dhe rëndësinë e këtij investimi sikurse është Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë).

Vazhdimësia e kontratave të furnizimit që ka aktualisht kontraktori.

Kosto shtesë që vijnë nga përsëritja e shpenzimeve për ngritjen e kantierit nga kontraktori “i ri”.

Kostot shtesë për mobilizimin e stafit teknik drejtues të punimeve.

Nga sa më sipër, bazuar në Nenin 127 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, jemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas përcaktimit të këtij neni.

a) Autoriteti Kontraktor nuk mund të parashikonte mospërputhjet midis projektit-faktit-preventivit, si dhe nevojave dhe domosdoshmërisë së ndryshimeve në funksion të përdoruesve të rrugës.

b) Të gjitha modifikimet e kryera janë të nevojshme të kryhen në këtë fazë, pasi janë të lidhura ngushtësisht me ndërtimin e trupit kryesor të rrugës. Kryerja e punimeve në një fazë të dytë ose nga një tjetër kontraktor do të ishte teknikisht e pamundur, kryesisht, për nderlidhjen e punimeve me jashtë kontrates me punimet e kontrates baze si germime shtresa, mure, sipas propozimeve të ardhura. Këtu mund të përmendim, përfundimin e plotë të shtresave asfaltike, përfundimin e plotë të mureve; punimeve të gërmimit, etj. që është e pamundur të realizohen në një fazë të dytë, apo nga një OE tjetër. Sipas kërkesave të paraqitura nga palët e treta, realizimi i këtyre punimeve mund të kryhet vetëm nga kontraktori fillestar, pasi kemi të bëjmë me ndërthurje punimesh, ku nuk mund të punojnë dy kontraktorë të ndryshëm në të njëjtin kantier ndërtimi.

c) Kontrata shtesë nuk kalon 20% të vlerës së kontratës bazë. Autoriteti Kontraktor vlerëson se kostoja e përgjithshme e këtyre punimeve është (19 %), pasi çmimet e preventivit të këtyre punimeve shtesë mbeten ato të tenderuara në kontratën bazë dhe të negociuara.

Përpos fakteve dhe arsyeve të lartëpërmendura, ripunimi i projektit fillestar të realizuar nga Bashkia Ersekë për objektin “Ndërtim rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë)” ka zgjatur disa muaj dhe në këtë proces janë angazhuar mjete, instrumente dhe staf teknik me eksperiencë.

Sqarojmë edhe njëherë se këto modifikime nuk janë parashikuar në projektin fillestar, për arsyet e mëposhtme:

Sipas këtij projekti, përveç të tjerave do të kryeshin punime si më poshtë, të cilat nuk ishin marrë parasysh në lidhje me situatën në fakt:

Objekti realizohet në afërsi të një zone të banuar (fshati Mollas), duke prekur disa prona, të cilat detyrimisht duhet të spostoheshin, si dhe shmangien e ndikimit në shtratin e përroit të Selenicës. Për shmangien e impaktit social-ekonomik e mjedisor (për të eliminuar prishjen apo dëmtimin e tyre) është propozuar të realizohet ndërtimi i trupit të rrugës nga mbushje me skarpatë në mbushje me mure me dhë të armuar (terramesh).

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 432,238,665.08 Lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 2,596,932,014.52 Lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së.

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 18 muaj

Dhe afati i ri (nëse është rasti): 22 muaj

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve ekonomik/ë:

Emri: “A. N. K.”

NIPT: J92408001N

Adresa: TIRANE Rruga e Kavajes, Pallatet Condor, Kulla 1, Hyrja e pare, kati i trete.

Kontaktet: +355684022362

e-mail: info@ank.al

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 30/08/2024

16. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor:

NJOFTIME FITUESI PARAPRAK

BASHKIA VLORË

Për: L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k

Seli/Zyra Qendrore:

Tirane, KASHAR, Rruga 3 Deshmoret, Kompleksi Grand, Apartamenti F-2-08, Kati 1

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur, Punë

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-13653-07-19-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksioni i rrugës së fshatit "Radhimë"

3(tre) muaj nga nënshkrimi i kontratës

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k

Nipt L78006801F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 19,869,600.00 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind)

Lekë pa TVSH;

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. K.M.K sh.p.k

Nipt L78223801E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 20,637,000.00 (njëzet milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSH;

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. ASI-2A CO sh.p.k

Nipt K53002402C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 21,900,000.00 (njëzet e një milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH;

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. Shendelli sh.p.k

Nipt K07924803N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 22,737,000.00 (njëzet e dy milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë) Lekë pa TVSH;

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

5. ERAL CONSTRUCTION COMPANY sh.p.k Nipt K82230002K
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t
 Vlera 23,262,000.00 (njëzetë e tre milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) Lekë pa TVSH;

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

6. B.O.E. ISOBAR CONSTRUCTION sh.p.k Nipt L12210036D
 & VIANTE Konstruksion sh.p.k Nipt K47103804L
 & APIS CONSTRUCTION sh.p.k Nipt L41513008A
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t
 Vlera 23,601,000.00 (njëzetë e tre milion e gjashtëqind e një mijë) Lekë pa TVSH;
 (e shprehur në shifra dhe fjalë)

7. LLAZO sh.p.k Nipt K24218401K
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t
 Vlera 24,174,600.00 (njëzet e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH;
 (e shprehur në shifra dhe fjalë)

8. AVDULI sh.p.k Nipt J66703306O
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t
 Vlera 24,804,600.00 (njëzet e katër milion e tetëqind e katër mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH;
 (e shprehur në shifra dhe fjalë)

9. XHAST sh.p.k Nipt K12512837I
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t
 Vlera 25,047,000.00 (njëzet e pesë milion e dyzet e shtatë mijë) Lekë pa TVSH;
 (e shprehur në shifra dhe fjalë)

10. SARK sh.p.k Nipt K52531415H
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t
 Vlera 25,063,200.00 (njëzet e pesë milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind) Lekë pa TVSH;
 (e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar 2 (dy) ofertues

1. XHAST sh.p.k Nipt K12512837I
 Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t
 Vlera 25,047,000.00 (njëzet e pesë milion e dyzet e shtatë mijë) Lekë pa TVSH;
 (e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 77 të Ligjit Nr. 162 , datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 40, VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim pikën 2.3.2, për këtë arsye KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë.

- Mungon kategoria NS – 18 B Punime topogjodezike tek licencat profesionale të shoqërisë

2. SARK sh.p.k

Nipt K52531415H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 25,063,200.00 (njëzet e pesë milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind) Lekë pa TVSH;
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 77 të Ligjit Nr. 162 , datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 40, VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim pikën 2.3.2, për këtë arsye KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë.

- Mungon kategoria NS – 18 B Punime topogjodezike tek licencat profesionale të shoqërisë

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k me Nipt L78006801F se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 19,869,600.00 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) Lekë pa TVSH / pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

BASHKIA DELVINË

Drejtuar: BOE ["ILIRIA/D" Sh.p.k me adresë: Lagjia Nr. 2, Rruga Telat Noga, Sarandë
9700 dhe "ARTI" Sh.p.k me adresë: Lagjia Nr. 1, Rruga Onhezmi, Sarandë]

Procedura e prokurimit: “E Hapur” - Punë

Numri i procedurës: REF-14135-07-24-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti: Riparim i Urës së Vanës, fshati Vanë, Bashkia Delvinë dhe kohëzgjatja e kontratës: 90 (nëntëdhjetë) ditë, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës nga palët (lëshimi/miratimi i lejes së ndërtimit për objektin)]

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike [Data: 29 Korrik 2024] [Numri: 42]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim (X)

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Emri i plotë i shoqërisë – “APIS CONSTRUCTION” Sh.p.k
Numri i NIPT-t: L41513008A
Vlera: 22,059,676 (njëzetë e dy milionë e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqindë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH
2. Emri i plotë i shoqërisë – BOE “ILIRIA/D” Sh.p.k & “ARTI” Sh.p.k
Numri i NIPT-t: J66702510D dhe Numri i NIPT-t: J64103808P
Vlera: 18,030,747 (tetëmbdhjetë milionë e tridhjetë mijë e shtatëqindë e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH
3. Emri i plotë i shoqërisë – “KALIVIOTI” Sh.p.k
Numri i NIPT-t: J64228811C
Vlera: 21,857,241 (njëzetë e një milionë e tetëqindë e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqindë e dyzetë e një) lekë pa TVSH
4. Emri i plotë i shoqërisë – “Shendelli” Sh.p.k
Numri i NIPT-t: K07924803N
Vlera: 18,360,104 (tetëmbëdhjetë milion e treqindë e gjashtëdhjetë mijë e njëqindë e katër) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

- Në këtë procedurë prokurimi nuk ka asnjë operator ekonomik të skualifikuar në këtë fazë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: BOE ["ILIRIA/D" Sh.p.k me adresë: Lagjia Nr. 2, Rruga Telat Noga, Sarandë 9700 dhe "ARTI" Sh.p.k me adresë: Lagjia Nr. 1, Rruga Onhezmi, Sarandë] se oferta e paraqitur prej tyre me vlerë totale prej 18,030,747 (tetëmbdhjetë milionë e tridhjetë mijë e shtatëqindë e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

BASHKIA ELBASAN

Nga: Bashkia Elbasan adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: "FLED" sh.p.k me adresë: Lagja Havaleas, rruga Ura e kozares, Kucove, godine private 1-kateshe, Nr.307, Havalehas.

Procedura e prokurimit: "Proçedurë e hapur".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-11977-07-03-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Mbrojtja e lagjes Noneve nga gerryerja e perroit te Gostimes, fshati Polis Vale, Njesia Administrative Shushice" me fond limit: 22,568,808 (njëzet e dymilion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e tetëqind e tetë) lekë (pa tvsh), vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, dhe me afat për kryerjen e punimeve 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "2 N" sh.p.k me Nipt: L 31615017 L

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 17,918,863.46 (shtatembedhjete milion e nenteqind e tetembedhjete mije e teteqind e gjashtedhjete e tre presje dyzet e gjashte) lekë (pa tvsh).

2. "Aida Construction" sh.p.k me Nipt: M 03116403 L

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 18,250,617.24 (tetembedhjete milion e dyqind e pesedhjete mije e gjashteqind e shtatembedhjete presje njezet e kater) lekë (pa tvsh).

3. "Bajrami - N" sh.p.k me Nipt: K 02727202 O

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 17,025,959.34 (shtatembedhjete milion e njezet e pesemije e nenteqind e pesedhjete e nente presje tridhjete e kater) lekë (pa tvsh).

4. "Bean" sh.p.k me Nipt: J 72510445 Q

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 17,376,809.64 (shtatembedhjete milion e treqind e shtatedhjete e gjashtemije e teteqind e nente presje gjashtedhjete e kater) lekë (pa tvsh).

5. "BEQIRI" sh.p.k me Nipt: J 98624801 V

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 18,353,566.86 (tetembedhjete milion e treqind e pesedhjete e tremije e peseqind e gjashtedhjete e gjashte presje tetedhjete e gjashte) lekë (pa tvsh).

6. "Besta" sh.p.k me Nipt: J 62903182 B

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 14,505,897 (katëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëmijë e teteqind e nentëdhjetë e shtatë) lekë (pa tvsh).

7. “Caushi M” sh.p.k me Nipt: L 88419801 O

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 18,268,706 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e gjashtë) lekë (pa tvsh).

8. “ERGI” sh.p.k me Nipt: K 02727229 P

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 20,831,944 (njëzet milion e teteqind e tridhjetë e njëmijë e nentëqind e dyzet e katër) lekë (pa tvsh).

9. “FLED” sh.p.k me Nipt: K 17621104 C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 16,483,840.05 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tremijë e teteqind e dyzet presje zero pese) lekë (pa tvsh).

10. “HASTOÇI” sh.p.k me Nipt: J 62028009 B

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 19,177,224 (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatëmijë e dyqind e njëzet e katër) lekë (pa tvsh).

11. “INA” sh.p.k me Nipt: J 61814009 W

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 19,054,021.26 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëdhjetë e katërmijë e njëzet e një presje njëzet e gjashtë) lekë (pa tvsh).

12. “K.M.K” sh.p.k me Nipt: L 78223801 E

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 18,952,928 (tetëmbëdhjetë milion e nentëqind e pesëdhjetë e dymijë e nentëqind e njëzet e tete) lekë (pa tvsh).

13. “NIKA” sh.p.k me Nipt: J 76705047 U

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 14,672,640.84 (katëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e dyzet presje tetëdhjetë e katër) lekë (pa tvsh).

14. “SARDO” sh.p.k me Nipt: K 13120402 W

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 17,287,350 (shtatëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatëmijë e treqind e pesëdhjetë) lekë (pa tvsh).

15. “SARK” sh.p.k me Nipt: K 52531415 H

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 17,166,271 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) lekë (pa tvsh).

16. “STERKAJ” sh.p.k me Nipt: J 68310708 M

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 20,039,387.16 (njetzëtmilion e tridhjetë e nentemije e treqind e tetëdhjetë e shtatë presje gjashtëmbëdhjetë) lekë (pa tvsh).

17. “Vellezerit HYSA” sh.p.k me Nipt: K 12911201 C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 17,265,888.33 (shtatëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesemije e tetëqind e tetëdhjetë e tete presje tridhjetë e tre) lekë (pa tvsh).

18. “XHAJ” sh.p.k me Nipt: K 12512837 I

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 17,733,924.92 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e tremije e nentëqind e njetzë e katër presje nentëdhjetë e dy) lekë (pa tvsh).

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Besta sh.p.k.

Pas shqyrtimit dhe vleresimit të ofertes tuaj KVO vendosi ta kualifikoje atë. Me pas KVO bazuar në Nenin 93 pika 5 Ligjin nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, verifikoi nëse oferta është ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Oferta e dhënë nga ana juaj është 14,505,897 leke pa tvsh dhe është me e ulët se 85% e mesatares së oferta të vlefshme, duke u vlerësuar anomalisht e ulët.

Oferta juaj refuzohet bazuar në Nenin 93 pika 5 Ligjin nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar me këtë përmbajtje:

“5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”.

Nika sh.p.k.

Pas shqyrtimit dhe vleresimit të ofertes tuaj KVO vendosi ta kualifikoje atë. Me pas KVO bazuar në Nenin 93 pika 5 Ligjin nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, verifikoi nëse oferta është ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Oferta e dhënë nga ana juaj është 14,672,640.84 leke pa tvsh dhe është me e ulët se 85% e mesatares së oferta të vlefshme, duke u vlerësuar anomalisht e ulët.

Oferta juaj refuzohet bazuar në Nenin 93 pika 5 Ligjin nr.162/2020, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar me këtë përmbajtje:

“5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”.

Sark

Ne permbushje të kërkesës së parashikuar në piken 2.3.1 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta për kualifikim, keni paraqitur kontratat e punës me objekt: 1. “Mbrotjtje nga perroi i Kushes.....”; 2. “Mbrotjtje nga perroi i Llixhes.....”; 3. “Mbrotjtje nga perroi i Gurres.....”; 4. “Rikonstruksion i kanalit ujites kryesor Ferras Harvalet.....”; 5. “Pastrim dhe Sistemim ishtratit të perrenjve në

Xibrake.....”; 6.”Sistemim i perroit te Balldrenit”; 7.”Mbrojtje nga perroi i Allambresit.....”; 8.”Mbrojtje e rruges se lagjes Tanush nga perroi i Gostimes.....”; 9.”Mirembajtje dhe riparime te kanalit ujites Balez e Poshtme”; 10.”Mirembajtje dhe riparime te kanalit ujites Karakullak”.

Kontratat me objekt: : 1.”Mbrojtje nga perroi i Kushes.....”; 2.”Mbrojtje nga perroi i Llixhes.....”; 3.”Mbrojtje nga perroi i Gurres.....”; 4.”Rikonstruksion i kanalit ujites kryesor Ferras Harvales.....” jane realizuar jashte afatit 5 vjecar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës sic eshte kerkuar ne kerkesen e sipercituar ku parashikohet: Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punë vetë kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kontratat e tjera nuk permbushin kushtin e parashikuar ne germat a dhe b per vleren per nje objekt te vetem ose dyfishin e te gjitha kontratave te marra se bashku.

OE nuk ploteson kriterin e sipercituar.

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

INA

Ne permbushje te kerkeses se parashikuar ne piken 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta per kualifikim, keni paraqitur kontratat e punes me objekt:1.”Hartim i projektit dhe zbatimi i punimeve per ndertimin e godines 21 ne zonen zhvillimore “5 Maji”; 2.”Ndertimi i varrezave te qytetit”.

Kontratat e paraqitura nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit, i cili eshte kryerja e punimeve per mbrojtjen e lagjes se Noneve nga gerryerja e perroit te Gostimes, njesia administrative Shushice, te cilat perfshihen ne kategorine NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

OE nuk ploteson kriterin e sipercituar.

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

Caushi M

Ne permbushje te kerkeses se parashikuar ne piken 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta per kualifikim, keni paraqitur kontratat e punes me objekt: 1.”Ndertim i tregut te gjelber Berat”; 2.”Rikonstruksion i rruges Bejar - Diga e Rezervuarit”; 3.”Sistemim asfaltim i rruges se fashtit Çercan, Nj.Ad. Hotolisht”; 4.”Rikualifikim i lulishtes ne qender te qytetit te Elbasanit”; 5.”Rikonstruksion rruga Taulantia”; 6.”Rikonstruksion rruga Pjeter Bogdani”; 7.”Permiresim furnizimi me uje ne zonen e poshte depove Yzberisht 1,2”; 8.”Rikonstruksion rruge NJ.A Katund i Ri”; 9.”Rehabilitim dhe riasfaltim i rruges Babice - Xhyherine”; 10.”Riasfaltim i disa rrugeve ne fshatin Poro, NjA Novosele”; 11.”Mbrojtja nga lumi Vjose ne Bishan”; 12.”Mbrojtja Nr.3 nga gerryerjet e lumit Zhullima, Baldushk”; 13.”Rehabilitim argjinatura Perlat”; 14.”Ndertim Gabionash dhe marrje masash per realizimin e mbrojtjes se tubit DN-863mm”.

Kontratat e paraqitura me objekt: 1.”Ndertim i tregut te gjelber Berat”; 2.”Rikonstruksion i rruges Bejar - Diga e Rezervuarit”; 3.”Sistemim asfaltim i rruges se fashtit Çercan, Nj.Ad. Hotolisht”; 4.”Rikualifikim i lulishtes ne qender te qytetit te Elbasanit”; 5.”Rikonstruksion rruga Taulantia”; 6.”Rikonstruksion rruga Pjeter Bogdani”; 7.”Permiresim furnizimi me uje ne zonen e poshte depove Yzberisht 1,2”; 8.”Rikonstruksion rruge NJ.A Katund i Ri”; 9.”Rehabilitim dhe riasfaltim i rruges

Babice - Xhyherine”; 10. ” Riasfaltim i disa rrugeve ne fshatin Poro, NjA Novosele”; nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit, i cili eshte kryerja e punimeve per mbrojtjen e lagjes se Noneve nga gerryerja e perroit te Gostimes, njesia administrative Shushice, te cilat perfshihen ne kategorine NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

Kontratat e tjera e konkretisht : 1. ”Mbrojtja nga lumi Vjose ne Bishan”; 2. ”Mbrojtja Nr.3 nga gerryerjet e lumit Zhullima, Baldushk”; 3. ”Rehabilitim argjinatura Perlat”; 4. ”Ndertim Gabionash dhe marrje masash per realizimin e mbrojtjes se tubit DN-863mm” nuk permbushin kushtin e parashikuar ne piken 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kritereve te veçanta per kualifikim ku parashikohet: Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punë vetë kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

OE nuk ploteson kriterin e sipercituar.

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

Beqiri

Nuk keni deklaruar ne shtojcen 8 te vetedeklarimit/nuk keni paraqitur asnje dokumentacion qe keni si staf teknik nje inxhinier topograf duke mos permbushur kerkesen e parashikuar ne piken 2.3.5 te kapacitetit teknik, te kritereve te veçanta per kualifikim.

OE nuk ploteson kriterin e sipercituar.

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

XHAST

Ne permbushje te kerkeses se parashikuar ne piken 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kritereve te veçanta per kualifikim, keni paraqitur dy kontrata pune, njera me objekt ”Ndertimin e infrastruktures publike ne zonen e Ndroqit” dhe tjetra ”Rindertimin e banesave individualene njesine administrative Ndroq”.

Kontratat e paraqitura nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit, i cili eshte kryerja e punimeve per mbrojtjen e lagjes se Noneve nga gerryerja e perroit te Gostimes, njesia administrative Shushice, te cilat perfshihen ne kategorine NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

OE nuk ploteson kriterin e sipercituar.

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

SARDO

1. Ne permbushje te kerkeses se parashikuar ne piken 2.3.1 te kapacitetit teknik, te kritereve te veçanta per kualifikim, keni paraqitur kontratat e punes me objekt: 1.”Rikonstruksion i rrjetit shperndares te ujesjellesit Selenice, Kote dhe Armen”; 2.”Rehabilitim i kanalit Kallafet dhe Babice Vlore.....”; 3. ”Rehabilitim i kanalit ujites ne Babice, Vlore skema ujites VLU-9 dega djathtas”; 4. “Mirembajtje e skemes ujites Nj.A Guri i Zi”; 5. “Rikonstruksion i godines se vjeter Dega e Doganes Vlore”.

Kontratat e paraqitura nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit, i cili eshte kryerja e punimeve per mbrojtjen e lagjes se Noneve nga gerryerja e perroit te Gostimes, njesia administrative Shushice, te cilat perfshihen ne kategorine NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime, ndersa kontratat e paraqitura nga subjekti juaj jane punime qe perfshihen ne kategorine

NP-7 Ujesjelles,vajsjellësa,vepra kullimi e vaditje dhe NP-3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

OE nuk ploteson kriterin e sipercituar.

2. Ne permbushje te kerkeses te parashikuar ne piken 2.3.4 te kapacitetit teknik, te kriterëve te veçanta per kualifikim keni deklaruar se keni te punësuar si drejtues teknik vetem inxhinier hidroteknik, duke mos permbushur kerkesen e sipercituar ku kerkohet:

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencen si dhe listëpagesat e shoqërisë per tre muajt e fundit, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier Ndertimi
- 1 (një) inxhinier Hidroteknik

OE nuk ploteson kriterin e sipercituar.

Sa mesiper, oferta juaj refuzohet.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: “ FLED ” sh.p.k me adresë: Lagja Havaleas, rruga Ura e kozares, Kucove, godine private 1-kateshe, Nr.307, Havalehas, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej 16,483,840.05 (gjashtëmbëdhjete milion e katerqind e tetedhete e tremije e teteqind e dyzet presje zero pese) lekë (pa tvsh), është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

BASHKIA MAT

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik: “**LIS KONSTRUKSION**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K66613407H, me seli: *Dibër, Bulqizë, Lagjja “Minatori”, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15*, “**VIANTE Konstruksion**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K47103804L, me seli: *Elbasan, Gramsh, GRAMSH, SPORTI*, dhe “**M U R A T I**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J66702413V, me seli: *Dibër, Bulqizë, BULQIZË, Rruga Ish Këshilli i Rrethit Bulqizë, Lagjja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1.*

Procedura e prokurimit: “E Hapur - Punë”, prokurim elektronik.

Numri i referencës së procedurës: REF-13833-07-22-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Mbrotja nga përroi i Urakës, Nj.A Rukaj, Bashkia Mat (Faza 1)”, me fond limit në vlerën: 50 064 348.15 (pesëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e dyzet e tetë pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2024 në vlerën: 17 522 522 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2025 në vlerën: 32 541 826.15 (tridhjetë e dy milion e pesëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e njëzet e gjashtë pikë pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, me afat zbatimi: 5 (pesë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 42, datë 29 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “LIS KONSTRUKSION” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K66613407H, “VIANTE Konstruksion” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K47103804L, dhe “M U R A T I” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J66702413V.

Vlera: 48 352 605.7 (dyzet e tetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik: “SENKA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J94808405Q

Vlera: 49 518 736.05 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë pikë zero pesë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “SENKA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J94808405Q

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “SENKA” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:
 - I. Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.3/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistem (SPE) konstatohet se, nuk është paraqitur Çertifikata e kërkuar ISO BS EN 13331-1: 2002, ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
 - II. Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, si: *Autorizimet e prodhuesit/*

distributorit, Katalogjet dhe Çertifikatat ISO 9001 të prodhuesit, për listën e mallrave/ materialeve të kërkuar.

- III. Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.6/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistem (SPE) konstatohet se, nuk është paraqitur kontratë noteriale shërbimi të lidhur me një laborator të akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar për kryerjen e analizave të materialeve të kërkuara.
- IV. Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.8 gërma “a”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/ Kualifikimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk ka deklaruar se disponon *minimumi* 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Infrastrukturë/ ura);
- V. Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.9/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk ka deklaruar se disponon *minimumi* 8 (tetë) manovratorë/ eskavatoristë/ automakinist.
- VI. Nuk është përmbushur kriteri i pikës 2.3.12/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, nuk është paraqitur Analiza e çmimeve të preventivit, Plan – organizimi dhe metodologjia e punimeve në objekt.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: “LIS KONSTRUKSION” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K66613407H, me seli: *Dibër, Bulqizë, Lagjja “Minatori”, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15*, “VIANTE Konstruksion” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K47103804L, me seli: *Elbasan, Gramsh, GRAMSH, SPORTI*, dhe “M U R A T I” Sh.p.k., me numër Nipt-i: J66702413V, me seli: *Dibër, Bulqizë, BULQIZË, Rruga Ish Këshilli i Rrethit Bulqizë, Lagjja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1.*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: 48 352 605.7 (dyzet e tetë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesë pikë shtatë) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

AGJENCIA KOMBËTARE TE UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Drejtuari: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “NG STRUCTURES” sh.p.k & Shoqëria “G.P.G. COMPANY” sh.p.k. me të dhënat si më poshtë:

Shoqëria “NG STRUCTURES” sh.p.k me NIPT L79326502O, me adresë të selisë Gjirokaster Tepelenë, Lagjja “Selam Musai”, Rruga Dule Dalani, Nr. pasurie 14/324, Zona Kadastrale 3574, Kati i dytë.

Shoqëria “G.P.G. COMPANY” sh.p.k me NIPT J64324443V, me adresë të selisë Fier, Lushnjë Lagjja 18 Tetori, godinë 1 katëshe tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, pranë Rotondos së Plukut.

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur me mjete elektronike / punë.

Numri i referencës së procedurës: REF - 11674-07-01-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Furnizimi me ujë i fshatrave Prokuc, Kalluc dhe Sistemi i KUZ fshati Bregas

Afati kohor për ekzekutimin: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Fondi limit: 168,451,427 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi, ju informojmë se në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik:

- Shoqëria “B93 II” sh.p.k. NIPT L522090500

Vlera e Ofertës: 138,258,612 (njëqind e tridhjetë e tetë milion e dyqind e pesëdhjete e tetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “NG STRUCTURES” sh.p.k & Shoqëria “G.P.G. COMPANY” sh.p.k.

Shoqëria “NG STRUCTURES” sh.p.k

NIPT L79326502O

Shoqëria “G.P.G. COMPANY” sh.p.k

NIPT J64324443V

Vlera e Ofertës: 143,000,344 (njëqind e dyzet e tre milion e treqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH

3. Operatori Ekonomik:

- Shoqëria “LLAZO” sh.p.k NIPT K24218401K

Vlera e Ofertës: 160,934,920 (njëqind e gjashtëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH

4. Operatori Ekonomik:

- Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k NIPT L619120240

I cili nuk ka paraqitur Ofertë Ekonomike.

5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k & Shoqëria “FLED” sh.p.k.

Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k NIPT K68121808W
Shoqëria “FLED” sh.p.k NIPT K17621104C

Vlera e Ofertës: 116,627,310.45 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e dhjetë pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH

6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “Caushi M” sh.p.k & Shoqëria “K.M.K” sh.p.k.

Shoqëria “Caushi M” sh.p.k NIPT L88419801O
Shoqëria “K.M.K” sh.p.k NIPT L78223801E

Vlera e Ofertës: 148,553,375.25 (njëqind e dyzet e tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë pikë njëzet e pesë) lekë pa TVSH

7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k. & Shoqëria “M U R A T I” sh.p.k.

Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k NIPT K47103804L
Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k NIPT K66613407H
Shoqëria “M U R A T I” sh.p.k NIPT J66702413V

Vlera e Ofertës: 166,531,053.7 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e tridhjetë e një mijë e pesëdhjetë e tre pikë shtatë) lekë pa TVSH

8. Operatori Ekonomik:

- Shoqëria “METEO” sh.p.k NIPT L26310801C

Vlera e Ofertës: 166,092,414 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e katerqind e katëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

9. Operatori Ekonomik:

- Shoqëria “BE - IS” sh.p.k NIPT K71412003A

Vlera e Ofertës: 164,418,018 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

Oferta të refuzuara nga Autoriteti Kontraktor:

I. Operatori Ekonomik Shoqëria “B93 II” sh.p.k. me NIPT L522090500, me vlerë të ofertës 138,258,612 (njëqind e tridhjetë e tetë milion e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

S’Kualifikohet për këto arsye:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky operator ekonomik në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatoi se nuk plotëson:

Operatori Ekonomik Shoqëria “B93 II” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.1, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën: a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ose b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH). Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike: Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë formular vlerësimi leshuar nga

Investitori sipas Shtojces 9 dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat: Operatori Ekonomik, si dëshmi të përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vertetime të shoqeruara me faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat, natyra e punes se kryer dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

➤ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

- *Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

Konkretisht për Objektin “Ujësjiellësi Lazarat” me Autoritet Kontraktor Bashkinë Gjirokastër dhe Kontraktues Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “B93 II” sh.p.k & “Alba Konstruksion” sh.p.k & “METEO” sh.p.k., nuk është paraqitur Kontrata e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë. Si rezultat nuk përcaktohen punimet dhe vlera që ka kryer Operatori Ekonomik Shoqëria “B93 II” sh.p.k.

Operatorit Ekonomik Shoqëria “B93 II” sh.p.k për objektin “Ujësjiellësi Lazarat” me autoritet kontraktor Bashkinë Gjirokastër dhe Kontraktues Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “B93 II” sh.p.k & “Alba Konstruksion” sh.p.k & “METEO” sh.p.k., nëpërmjet komunikimit elektronik nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave i Autoritetit Kontraktor në datën 06.08.2024 i është kërkuar dërgimi i Kontratës së Bashkëpunimit shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i Bashkimit të Operatorëve. Gjithashtu nëpërmjet komunikimit elektronik në datën 07.08.2024 i është kërkuar dërgimi i këtij informacioni brenda datës 08.08.2024.

Në datën 07.08.2024 Operatori Ekonomik Shoqëria “B93 II” sh.p.k ka dërguar përgjigje mbi informacionin e kërkuar duke bashkëngjitur Kontratën e Bashkëpunimit Nr. Rep. 1755, Nr. Kol. 489/1, datë 27.05.2020 ku në Nenin 3 - Ndarja e Punimeve, përcaktohet volumi i punëve që do të kryejë B 93 II, në masën 21.99%. Vlera koresponduese e punimeve pa TVSH për Operatorin Ekonomik Shoqëria “B93 II” sh.p.k në këtë rast është 49,122,489.7 lekë. Kjo vlerë është më e vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) prej 84,225,713.5 leke, si konkluzion nuk plotëson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën a) me sipër.

Operatori Ekonomik Shoqëria “B93 II” sh.p.k, në bazë të dokumentacionit të paraqitur për punë të së njëjtës natyrë, nuk plotëson kriterin e përcaktuar si më sipër në pikën b), pasi vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku nuk plotëson vlerën e kërkuar sa dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Operatori Ekonomik Shoqëria “B93 II” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.2, “Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës“, pika c, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë: Matësa Uji; Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*

Rezultoi se Operatori Ekonomik Shoqëria “B93 II” sh.p.k ka paraqitur autorizimin nga Distributori Subjekti “AMU” për furnizim me matësa uji nga Prodhuesi “Baylan”. Gjithashtu ka paraqitur autorizimin nga Prodhuesi “Baylan” për Distributorin “AMU” vetëm në gjuhën angleze të papërkthyer në gjuhën zyrtare shqipe, duke mos plotësuar kriterin për kualifikim.

II. Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k me NIPT L61912024O i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

S’Kualifikohet për këto arsye:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky operator ekonomik në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatoi se nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Paragrafi 2, pika 1, gërma a dhe b, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, për rrjedhojë nuk përmbush Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes / Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në përbërje të Formularit të Vetëdeklarimit. Në këto kushte, Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit të publikuara në Shtojcën Nr.7 të DST- së.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk ka paraqitur Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim. Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk ka paraqitur Listën e cmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Gjithashtu, Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Shtojcën Nr. 7 të DST-së, si më poshtë:

Nuk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik sipas kërkesave të pikës 1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 dhe Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 të DST-së. Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, Shtojcën 1 dhe 2.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Shtojcën Nr. 7 të DST-së, Kapitullin 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional Paragrafi 2.3.1., pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për punë të kryera të ngjashme me objektin që prokurohet, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Shtojcën Nr. 7 të DST-së, Kapitullin 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional Paragrafi 2.3.2 “Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës“ pika c.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk ka paraqitur Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, nuk ka paraqitur Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit, nuk ka paraqitur certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matesave të ujit sipas OIML R49 / ekuivalente me të, certifikatën e aprovimit sipas MID / ekuivalente me të për matesave të ujit, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Shtojcën Nr.7 të DST-së, Kapitullin 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional, Paragrafi 2.3.3, pikat “a” dhe “e”, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës nuk ka deklaruar se ka të punësuar të paktën 90 (nëntëdhjetë) punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit.
e) Operatori ekonomik pjesëmarrës, nuk ka deklaruar stafin teknik të punësuar të përbërë nga të paktën 25 (njëzet e pesë) punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- 2 (dy) teknik ndërtimi
- 2 (dy) muratorë
- 1 (një) betonues
- 4 (katër) hidraulikë
- 4 (katër) specialistë karpentier
- 3 (tre) hekurkthyes
- 1 (një) mekanik
- 2 (dy) specialistë hidroizolues
- 1 (një) topograf
- 1 (një) bojaxhi
- 4 (katër) shoferë për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorine ”C” dhe /ose ”CE” dhe/ose ”D” dhe/ose ”DE” lëshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar më sipër, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Shtojcën Nr.7 të DST-së, Kapitullin 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional, Paragrafi 2.3.3, pika g, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (ne rast se është inxhinier), dëshmi / çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 te VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas

zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.

- 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.
- Shenim: Për specialistin “Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Operatori Ekonomik mund ta disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër. *** *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.* Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar me sipër, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Shtojcën Nr.7 të DST-së, Kapitullin 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional, Paragrafi 2.3.3, pika h, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar me sipër, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, të publikuara në Shtojcën Nr.7 të DST-së, Kapitullin 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional, Paragrafi 2.3.5. “Makineri Pajisje”, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për makineri dhe pajisje sipas tabelës së kërkuar nga autoriteti kontraktor të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk ka paraqitur grafikun e punimeve, duke mos plotësuar kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk ka paraqitur Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social.

Operatori Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k nuk ka paraqitur deklaratën mbi Periudhën e garancisë së objektit.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe

specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të

Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqëria “ZEQILLARI” sh.p.k.

III. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k & Shoqëria “ FLED” sh.p.k. me të dhëna përkatësisht Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k me NIPT K68121808W dhe Shoqëria “FLED” sh.p.k. NIPT K17621104C, me vlerë të ofertës 116,627,310.45 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e dhjetë pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH. S`Kualifikohet për këto arsye:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky bashkim operatorësh ekonomikë konstatoi se nuk plotëson:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k & Shoqëria “ FLED” sh.p.k. nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.1, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën: a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ose b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH). Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9 dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Në rast se punimet janë kryer me sektorin privat: Operatori Ekonomik, si dëshmi të përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat, natyra e punës së kryer dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

Operatori Ekonomik Shoqëria “FLED” sh.p.k sipas përqindjes së ndarjes së punëve në marrëveshjen e bashkëpunimit ka 36%. Referuar dokumentacionit të dorëzuar për punë të së njëjtës natyrë, nuk plotëson kriterin e përcaktuar si më sipër në pikën a), pasi asnjë nga prej punëve të ngjashme nuk plotëson vlerën e kërkuar në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k & Shoqëria “FLED” sh.p.k. në bazë të dokumentacionit të paraqitur për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, nuk plotësojnë kriterin e përcaktuar si më sipër në pikën b), pasi vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku nuk plotëson vlerën e kërkuar sa dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH) në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Subjekti mbështetës Shoqëria Zdrava sh.p.k ka paraqitur Deklaratën e Angazhimit datë 22.07.2024, ku në fund të tekstit citohet se deklarata jepet me kërkesë të subjektit BOE “Shkëlqimi 07 & Fled & Desaret”!

Për këtë objekt prokurimi, ka ofertuar Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k & Shoqëria “ FLED” sh.p.k. duke mos patur pjesë të bashkëpunimit subjektin Shoqërinë “Desaret” sh.p.k.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k & Shoqëria “ FLED” sh.p.k. nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës pika c, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8
- Tuba PE 100 RC
- Puseta shkarkimi plastike
- Matësa Uji

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe. Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar. Shënim:Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t`i referohen edhe

ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Operatorët Ekonomikë për produktet Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8, Tuba PE 100 RC, Puseta shkarkimi plastike, Matësa Uji, ka paraqitur autorizimin e prodhuesit “Konti Hidroplast” për Distributorin “AMU”, por nuk ka paraqitur autorizimin e Distributorit “AMU” për operatorin ofertues Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k & Shoqëria “FLED” sh.p.k. për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatorët Ekonomikë për produktet matësa të ujit, ka paraqitur Autorizimin e Prodhuesit “Baylan” për Distributorin “AMU”, por nuk ka paraqitur autorizimin e Distributorit “AMU” për operatorin ofertues Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k & Shoqëria “FLED” sh.p.k. për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Bashkimi Operatorëve Ekonomikë nuk ka paraqitur Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social.

Gjithashtu, Bashkimi Operatorëve Ekonomikë nuk ka paraqitur Deklaratën mbi Periudhën e garancisë së objektit.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “SHKELQIMI 07” sh.p.k & Shoqëria “FLED” sh.p.k.

IV. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “Caushi M” sh.p.k & Shoqëria “K.M.K” sh.p.k., me të dhëna përkatësisht Shoqëria “Caushi M” sh.p.k me NIPT L88419801O dhe Shoqëria “K.M.K” sh.p.k me NIPT L78223801E, me Vlerë të Ofertës 148,553,375.25 (njëqind e dyzet e tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë pikë njëzet e pesë) lekë pa TVSH. S’Kualifikohet për këto arsye:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “Caushi M” sh.p.k & Shoqëria “K.M.K” sh.p.k. nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.1, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën: a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ose b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH). Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë formular vlerësimi lëshuar nga Investitori

sipas Shtojcës 9 dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Operatori Ekonomik Shoqëria “K.M.K” sh.p.k, me përqindjen më të madhe të ndarjes së punëve në marrëveshjen e bashkëpunimit, në bazë të dokumentacionit të paraqitur për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, nuk plotëson kriteret e përcaktuara si më sipër në pikën a) pasi asnjë nga prej punëve të ngjashme nuk plotëson vlerën e kërkuar (jo me të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Operatori Ekonomik Shoqëria “Caushi M” sh.p.k, sipas përqindjes së ndarjes së punëve në marrëveshjen e bashkëpunimit, në bazë të dokumentacionit të paraqitur për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, nuk plotëson kriteret e përcaktuara si më sipër në pikën a), pasi asnjë prej punëve të ngjashme nuk plotëson vlerën e kërkuar.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “Caushi M” sh.p.k & Shoqëria “K.M.K” sh.p.k. sipas përqindjes së ndarjes së punëve në marrëveshjen e bashkëpunimit, në bazë të dokumentacionit të paraqitur për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara si më sipër në pikën b), pasi vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku nuk plotëson vlerën e kërkuar.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria Caushi M”sh.p.k & Shoqëria “K.M.K” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pika c, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8
- Tuba PE 100 RC
- Puseta shkarkimi plastike
- Matësa Uji

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhena të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëebsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe

cilit prodhues i përkasin. Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë certifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar. Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria "Caushi M" sh.p.k & Shoqëria "K.M.K" sh.p.k për produktet Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8, ka paraqitur Autorizimin e Prodhuetit "Teqja International" për operatorin ekonomik Shoqëria "K.M.K" sh.p.k, por nuk ka paraqitur autorizimin për Operatorin Ekonomik Shoqëria "Caushi M" sh.p.k, i cili në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë punime për F.V. tuba të brinjëzuar SN 8, për rrjedhojë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë për produktet Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8, ka paraqitur Autorizimin e Prodhuetit "Konti Hidroplast" për Distributorin "AMU", por nuk ka paraqitur Autorizimin e Distributorit "AMU" për Operatorin Ekonomik Shoqëria "Caushi M" sh.p.k dhe Operatorin Ekonomik Shoqëria "K.M.K" sh.p.k, të cilet në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit kanë marrë përsipër të kryejë punime për FV tuba të brinjëzuar SN 8, Tuba PE 100 RC, Puseta shkarkimi plastike, për rrjedhojë nuk plotësojnë kriterin për kualifikim.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë për produktet Matësa Uji, ka paraqitur autorizimin e Prodhuetit "BAYLAN" për Distributorin "AMU" ndërsa Distributori "AMU" ka lëshuar Autorizimin vetëm për Operatorin Ekonomik Shoqëria "K.M.K" sh.p.k, por nuk ka paraqitur autorizimin për Operatorin Ekonomik Shoqëria "Caushi M" sh.p.k.

Gjithashtu, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e

tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji", Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s'kualifikimin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria "Caushi M" sh.p.k & Shoqëria "K.M.K" sh.p.k.

V. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria "VIANTE KONSTRUKSION" sh.p.k & Shoqëria "LIS KONSTRUKSION" sh.p.k. & Shoqëria "M U R A T I" sh.p.k. me të dhëna përkatësisht: Shoqëria "VIANTE KONSTRUKSION" sh.p.k me NIPT K47103804L, Shoqëria "LIS KONSTRUKSION" sh.p.k me NIPT K66613407H dhe Shoqëria "M U R A T I" sh.p.k me NIPT J66702413V, me Vlerë të Ofertës 166,531,053.7 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e tridhjetë e një mijë e pesëdhjetë e tre pikë shtatë) lekë pa TVSH. S'Kualifikohet për këto arsye:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria "VIANTE KONSTRUKSION" sh.p.k & Shoqëria "LIS KONSTRUKSION" sh.p.k. & Shoqëria "M U R A T I" sh.p.k. nuk plotëson Kriteret e Vecanta të

Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.1, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën: a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ose b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH). Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9 dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Operatori Ekonomik Shoqëria “**LIS KONSTRUKSION**” sh.p.k. sipas përqindjes së ndarjes së punëve në marrëveshjen e bashkëpunimit ka përqindjen më të madhe prej 49%. Referuar dokumentacionit të dorëzuar për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, nuk plotëson kriterin e përcaktuar si më sipër në pikën a), sepse vlera monetare e secilës prej punëve të ngjashme është më e vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH), pasi vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Operatorët Ekonomikë Shoqëria “**VIANTE KONSTRUKSION**” sh.p.k & Shoqëria “**M U R A T I**” sh.p.k. sipas përqindjes së ndarjes së punëve në marrëveshjen e bashkëpunimit përkatësisht 47% dhe 4%, referuar dokumentacionit të dorëzuar për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, nuk plotëson kriterin e përcaktuar si më sipër në pikën a), sepse vlera monetare e punës së ngjashme është më e vogël se vlera koresponduese sipas përqindjes në pjesëmarrje në bashkim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “**VIANTE KONSTRUKSION**” sh.p.k sipas përqindjes së ndarjes së punëve në marrëveshjen e bashkëpunimit ka 47%. Referuar dokumentacionit të dorëzuar për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, nuk plotëson kriterin e përcaktuar si më sipër në pikën b), pasi vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Operatori Ekonomik Shoqëria “**M U R A T I**” sh.p.k, sipas përqindjes së ndarjes së punëve në marrëveshjen e bashkëpunimit ka përqindjen më të vogël prej 4%. Referuar dokumentacionit të dorëzuar për punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, nuk plotëson kriterin e përcaktuar si më sipër në pikën b), pasi vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “**VIANTE KONSTRUKSION**” sh.p.k & Shoqëria “**LIS KONSTRUKSION**” sh.p.k. & Shoqëria “**M U R A T I**” sh.p.k. nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.3, pika g, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (ne rast se është inxhinier), dëshmi / çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të çertifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 te VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkepunitimit.
- 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.
- Shenim: Për specialistin “Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Operatori Ekonomik mund ta disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër.

Operatori Ekonomik Shoqëria “M U R A T I“ sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion, duke mos plotësuar kriterin për kualifikimin.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “ LIS KONSTRUKSION” sh.p.k. & Shoqëria “M U R A T I“ sh.p.k. nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.3, pika h, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkepunitimit.

Operatori Ekonomik Shoqëria “M U R A T I“sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion per punesimin e mjekut duke mos plotesuar kriterin per kualifikim.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k. & Shoqëria “M U R A T I“ sh.p.k. nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e

Veçanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.4, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”.

Operatori Ekonomik Shoqëria “M U R A T I” sh.p.k, sipas ndarjes së punëve në kontratën për bashkëpunim ka deklaruar kryerjen e punimeve tek Kapitulli V-Germim dhe mbushje për pusetat, zëri nr. 1– Germim me krahë, gropa te vecuara sip. 10 – 30 m2, tokë e zakonshme. Ky proces pune gjithashtu kërkon ruajtjen e materialeve të gërmuara për ti përdorur për mbushje si dhe transportin e materialeve të tepërta në sasi nga germimi dhe të papershtatshme teknikisht për mbushje që kërkojnë transport dhe largim pasi nuk nevojiten për mbushje, por ky operator nuk e disponon licensen (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte” duke mos plotësuar kriterin për kualifikim.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “ LIS KONSTRUKSION” sh.p.k. & Shoqëria “M U R A T I” sh.p.k. nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.5, “Makineri Pajisje”, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë të mësipërm, në formularët e vetëdeklarimit sipas Shtojces 8, nuk kanë deklaruar posedimin e makinerisë Rimorkiator për transportin e makinerive - 1 (një) copë, duke mos-plotësuar kriterin për kualifikim.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k. & Shoqëria “M U R A T I” sh.p.k. nuk plotëson Kapitullin 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional Paragrafi 2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës pika c, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.3. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8
- Tuba PE 100 RC
- Puseta shkarkimi plastike
- Matesa uji

Kontrata e Distribucionit te artikujve si më sipër midis “Vibtis” dhe Shoqërisë “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k. nuk provon Autorizimin e Prodhuesit Pestan dhe Distributorit të autorizuar prej Prodhuesit. Vibtis vetëdeklaroi që është përfaqësues i Prodhuesit “Pestan” por nuk ka dorëzuar Autorizimin e Prodhuesit, duke mos-plotësuar kriterin për kualifikim.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “ LIS KONSTRUKSION” sh.p.k. & Shoqëria “M U R A T I” sh.p.k. nuk plotëson Kapitullin 2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional: Paragrafi 2.3.3 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pika c, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.3. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Matësa Uji

Distributori “Vibtis” ka lëshuar autorizim për furnizim me matësa uji për Operatorin Ekonomik Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k dhe për Operatorin Ekonomik Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k si produkte të Prodhuesit Pestan. Prodhuesi Pestan ka lëshuar autorizim për furnizim me artikuj për operatorin ekonomik Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k dhe për operatorin ekonomik Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k, ku nuk

është përfshirë artikulli matësa uji. Nga verifikimet rezulton se Subjekti “Pestan” nuk prodhon matësa uji por vetëm tuba HDPE, tuba korrugato dhe puseta plastike.

Nuk është paraqitur Autorizimi i Prodhuesit të matësive Madalena per Distributorin “Vibtis”, për rrjedhje nuk plotësohet kriteri për kualifikim.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë nuk ka paraqitur Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social.

Gjithashtu, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë nuk ka paraqitur Deklaratën mbi Periudhën e garancisë së objektit.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k. & Shoqëria “M U R A T I” sh.p.k.

VI. Operatori Ekonomik Shoqëria “METEO” sh.p.k me NIPT L26310801C me vlerë të ofertuar 166,092,414 (njqind e gjashtedhjetë e gjashtë milione e nentedhjetë e dy mije e katerqinde e katermbedhjetë) Lekë pa TVSH; S`kualifikohet për këto arsye:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky operator ekonomik në Sistemin e Prokurimit Elektronik konstatoi se nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Paragrafi 2, pika 1, gërma b, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Operatori Ekonomik Shoqëria “METEO” sh.p.k ka paraqitur Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojcës 3, pa logon dhe pa vulen e Shoqërisë siguroese “Sigal Uniqa Group Austria”, duke e bërë dokument të pavlefshëm, për rrjedhje nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik Shoqëria “METEO” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.1, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën: a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Ose b. punë

të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Operatori Ekonomik Shoqëria “METEO” sh.p.k nuk plotëson kriterin e percaktuar si më sipër në pikën a), pasi asnjë nga prej punëve të ngjashme nuk plotëson vlerën e kërkuar jo më të vogël 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Operatori Ekonomik Shoqëria “METEO” sh.p.k nuk plotëson kriterin e percaktuar si më sipër në pikën b), pasi vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Operatori Ekonomik Shoqëria “METEO” sh.p.k nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST-në e publikuar, Shtojca Nr.7 Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapitulli 2.3 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, Paragrafi 2.3.2, pika c, ku nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8
- Tuba PE 100 RC
- Puseta shkarkimi plastike
- Matësa Uji

- Fatura Nr. 112, datë 05.12.2019, me vlerë prej 1,087,077 Lek pa Tvsh, (brenda pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),

Për rrjedhojë vetëm Fatura me Nr. 22, datë 19.09.2019, me vlerë prej 52,700,141 Lek pa Tvsh, Fatura me Nr. 111, datë 05.12.2019, me vlerë prej 16,559,820 Lek pa Tvsh dhe Fatura me Nr. 112, datë

05.12.2019, me vlere prej 1,087,077 Lek pa Tvsh, me vlere totale punimesh prej 70,347,038 Leke pa Tvsh jane leshuar brenda 5 (pese) viteve nga nenshkrimi i kontrates.

Per sa me lart, konstatohet se vetem fatura Fatura me Nr. 22, date 19.09.2019, Fatura me Nr. 111, date 05.12.2019 dhe Fatura me Nr. 112, date 05.12.2019, me vlere totale punimesh prej 70,347,038 Leke pa Tvsh, vertetojne punime te realizuara brenda afatit 5 (pese) vjecar nga shpallja e njoftimit te kontrates.

Sa konstatuam me siper, Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per me teper edhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) ne vendimin nr. 670/2019, ka mbajtur te njejtin qendrim ku nder te tjera ka theksuar se: *“Në kriteret e veçanta të kualifikimit të hartuar nga autoriteti kontraktor, si edhe vetë parashikimeve të aktit nënligjor në zbatim të ligjit, KPP gjykon se operatorët ekonomikë, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme në kontratat për punë publike duhet të dorëzojnë kontrata të përfunduara, pra me anë të dokumentacionit duhet të dëshmojnë se kanë realizuar me sukses punime të përfunduara brenda 3 viteve të fundit (afati sipas parashikimeve ligjore te kohes)”*.

Gjithashtu ne kete vendim Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), ka arsyetuar se: *“Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm”*.

Si perfundim operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa me siper duke qene se per pune te ngjashme nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit, kriteri 2.3.1 konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, në shtojcën 7, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7, të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se: *“Operatorët Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:*

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 18 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	3
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes min 12 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 3.5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
4	Kamion me Vinc	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

5	Eskavator me zinxhire	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
6	Eskavator me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
7	Fadrome me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
8	Minieskavator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
9	Asfaltoshtruese	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
10	Grejder	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
11	Rimorkjator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
12	Autobot uji	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
13	Rrul Vibrues	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
14	Prerese asfalti	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
15	Aparat topogjeodezik me GPS	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësine e mjetit: - certifikaten e pronësise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases/ bashkepunitimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimi, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkepunitimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

KVO thekson se per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te paraqesin si me poshte:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësine e mjetit: - certifikaten e pronësise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit

teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.

Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases/ bashkëpunimit.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe per permbushjen e ketij kriteri rezulton se:

I. KVO veren se per “Eskavatorin me goma”, me targe AHMT 77, i deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet ne dispozicion me ane te kontrates se qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetes, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se OE nuk ka paraqitur kontraten e qirase, çertifikaten e pronesise, lejen e qarkullimit, çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin vjetor, Taksat vjetore, Lejen e transportit si dhe fotot e kerkuara ne DST.

II. KVO veren se per “Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 3.5 ton”, me targa AA274TE, deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet ne dispozicion me ane te kontrates se qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetes, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur çertifikaten e pronesise, çertifikaten e kontrollit Teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, si dhe fotot e kerkuara ne DST.

Po ashtu, verehet se per mjetin “Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 3.5 ton”, me targa AA 274 TE, per disponimin e ketij mjeti, ky operator ekonomik ka paraqitur nje kontrate te thjeshte qiraje lidhur ndermjet tij dhe subjektit “ARDMIR” Shpk, i cili nga verifikimi nuk rezulton te jete pronar i mjetit per te cilin eshte lidhur kontrata e qirase pasi Kamionçina me kapacitet mbajtës min 3.5 ton, me targa AA 274 TE, rezulton te jete ne pronesi te subjektit “ANXHELO-BR 2007”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se subjekti “ANXHELO-BR 2007” me ane te kontrates noteriale te qirase me Nr. Repertori 655 dhe Nr. Koleksioni 537, date 18.06.2023, i ka dhene me qira subjektit “ARDMIR” Shpk kamionçinen me kapacitet mbajtës min 3.5 ton, me targa AA 274 TE, me nje afat prej pese vitesh duke i dhene te drejten e perdorimit te sendit por jo te drejten per dhenien me qira ose perdorim paleve te treta.

III. KVO veren se per “Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 12 ton”, me targa AA760LK, i deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet ne dispozicion me ane te kontrates se qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetes, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, lejen e transportit, si dhe foto e kerkuara ne DST.

IV. KVO veren se per “Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 3.5 ton”, me targa AA173DA i deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet ne dispozicion me ane te kontrates se qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetes, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, si dhe fotot e kerkuara ne DST.

V. KVO veren se per “Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 12 ton”, me targa AB665IS, i deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet ne dispozicion me ane te kontrates se qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetes, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, lejen e transporti si dhe foto e kerkuara ne DST.

VI. KVO veren se per “Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 12 ton”, me targe AA791XF, i deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet ne dispozicion me ane te kontrates se qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetes, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur certifikaten e kontrollit Teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, lejen e transportit, si dhe foto e kerkuara ne DST.

Sa me siper bazuar ne konstatimet e sipercituara, kriteri 2.3.7 i kushteve te vecanta te kualifikimit konsiderohet i paperbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “ALB TIEFBAU” SH.P.K, per mos përbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ALB TIEFBAU” SH.P.K, me Nuis J66703049C, *skualifikohet*.

IX- Operatori Ekonomik “A.L-ASFALT” SH.P.K, me Nuis K81511508A,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te procedures se prokurimit konstatohet se me procesverbalin Nr. 01, date 19/07/2024 për vleresimin e dokumentacioni per proceduren e prokurimit me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne administrim te Bashkise Lezhe”, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka kualifikuar paraprakisht Operatorin Ekonomik “A.L-ASFALT” SH.P.K, me Nuis K81511508A dhe me daten 23.07.2024 i ka kerkuar me ane te Sistemit te Prokurimeve Elektronike dorezimin e dokumentacionit fizik origjinal ose kopje te njehesuar me origjinalin sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike deri me daten 01.08.2024.

Ne vijim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar prane Bashkise Lezhe, me ane te shkreses me Nr. 13231 protokolli hyres, date 01.08.2024, nga OE “A.L-ASFALT” SH.P.K, konstatoi se:

Në shtojcën 7, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5, të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se: Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Ing. Gjeodet	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeodet (topograf)	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Punonjes per punime ne Rruge dhe Asfaltim	5 (pese)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Shofer	5 (pese)	Leje Drejtimi
- Manovrator	5 (pese)	Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per muajin Prill 2024.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					

.....					
-------	--	--	--	--	--

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cila duhet te dorezohet ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Theksojme se per te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesemarrës duhet te paraqesin per stafin e sipercituar formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cila duhet te dorezohet ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues si kontratat individuale te punës, Diplomat Universitare/ Diplomat e shkolles mesme/ Deshmite profesionale, Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP), Lejet Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori si dhe listepagesat e shoqerise per muajin Prill 2024 duhet te paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se OE per permbushjen e ketij kriteri ka paraqitur Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit ne te cilin per disponimin e 5 (pese) punonjesve “Per punime ne Rruge dhe Asfaltim”, ka deklaruar si me poshte:

“...Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.

Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:

- 1.Xhevahir Deliallisi, me profesion Specialist per Punime ne Rruge dhe Asfaltim, i punesuar prane shoqerise tone, i paisur me certifikate trajnimi AQS/T/S125522024.
- 2.Ivan Deliallisi, me profesion Specialist per Punime ne Rruge dhe Asfaltim, i punesuar prane shoqerise tone, i paisur me certifikate trajnimi AQS/T/S1255122024.
- 3.Dorjan Elezi, me profesion Specialist per Punime ne Rruge dhe Asfaltim, i punesuar prane shoqerise tone, i paisur me certifikate trajnimi AQS/T/S125532024.
- 4.Isuf Saliu, me profesion Specialist per Punime ne Rruge dhe Asfaltim, i punesuar prane shoqerise tone, i paisur me certifikate trajnimi AQS/T/S1255422024.
- 5.Mexhit Shani, me profesion Specialist per Punime ne Rruge dhe Asfaltim, i punesuar prane shoqerise tone, i paisur me certifikate trajnimi AQS/T/S1255422024.....”

Per rrjedhoje, KVO bazuar ne nenin 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik”, te ndryshuar, mori te mireqene deklarimin e OE-se ne formularin Permbledhes duke kualifikuar kete Operator Ekonomik ne fazen e pare te vleresimit te ofertave ne SPE.

Ne vijim pas dorezimit te dokumentacionit fizik sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike mori ne shqyrtim kete dokumenacion ku konstatoi se:

- Eshte paraqitur per Z. Xhevahir Deliallisi, kontrate individuale pune dhe certificate trajnimi me numer identifikues AQS/T/S21462023. *(Ne formular deklaruar ndryshe AQS/T/S125522024).*
- Eshte paraqitur per Z. Isuf Saliu, kontrate individuale pune dhe certificate trajnimi me numer identifikues AQS/T/S21412023. *(Ne formular deklaruar ndryshe AQS/T/S1255422024).*
- Eshte paraqitur per Z. Mexhit Shani, kontrate individuale pune dhe certificate trajnimi me numer identifikues AQS/T/S21422023. *(Ne formular deklaruar ndryshe AQS/T/S1255422024).*

Sa me siper verehet se numrat identifikues te certifikatave te trajnimit te vetedeklaruar ne formularin permbeledhes nuk rezultojne te njejte me numrat identifikues te certifikatave te trajnimit te dorezuara fizikisht prane AK-se.

Ndersa per punonjesit e deklaruar ne formularin permbeledhes te vetedeklarimit, konkretisht per Z. Ivan Deliallisi dhe Z. Dorjan Elezi nuk eshte paraqitur asnje lloj dokumentacioni qe provon disponimin e ketyre punonjesve te deklaruar ne formularin e vetedeklarimit sipas kerkesave te kriterit 2.3.5 te DST-se.

Si perfundim nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Autoritetit Kontraktor, KVO konstaton se operatori ekonomik, ka paraqitur dokumentacion vetem per 3 (tre) punonjes ”per punime ne Rruge dhe Asfaltim”, ndersa per 2 (dy) te tjere nuk eshte paraqitur asnje lloj dokumentacioni sipas kerkesave te kriterit 2.3.5 te DST-se, duke mos permbushur kete kriter ne lidhje me disponimin e 5 (pese) punonjesve per punime ne Rruge dhe Asfaltim.

Po ashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se OE per permbushjen e ketij kriteri ka deklaruar ne Formularin Permbeledhes te Vetedeklarimit mbeshtetjen ne kapacitetet e subjektit “VILDEV – CO” SH.P.K per disponimin e 1 (nje) Ing. Ndertimi, 1 (nje) Ing. Gjeodet dhe 3 (tre) manovratoreve si dhe disponimin e disa prej mjeteve duke dorezuar prane Autoritetit Kontraktor per subjektin mbeshtetes dokumentacionin si Formularin permbeledhes te Vetedeklarimit, Deklaraten per mbeshtetjen e subjektit, Ekstraktin Historik, Licensen e Shoqerise, kontratat individuale te punes, diplomat perkatese, si dhe dokumentacion mjetesht etj.

KVO verifikoi dokumentacionin e dorezuar fizikisht prane AK-se, ku nga verifikimi rezulton se nuk jane paraqitur listpagesat per muajin Prill 2024 per subjektin mbeshtetes “VILDEV – CO” SH.P.K.

KVO thekson se me mungesen e Listpagesave per muajin Prill 2024 eshte e pamundur te verifikohet nese punonjesit e deklaruar ne formularin permbeledhes te vetedeklarimit figurojne ne listpagesat per muajin Prill 2024 te subjektin mbeshtetes “VILDEV – CO” SH.P.K duke mos permbushur kerkesat per disponimin e 1 (nje) Ing. Ndertimi, 1 (nje) Ing. Gjeodet dhe 1 (nje) manovratori sipas kriterit 2.3.5, te DST-se.

Si perfundim Operatori Ekonomik ofertues per kete procedure prokurimi nuk disponon 2 (dy) punonjes per punime ne Rruge dhe Asfaltim, 1 (nje) Ing. Ndertimi, 1 (nje) Ing. Gjeodet dhe 1 (nje) manovratori, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne kriterin 2.3.5, te DST-se

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, te ligjit nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kerkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kerkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kerkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për permbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", ku parashikohet: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kerkesat dhe specififikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me percaktimet e nenit 38 të këtij ligji", vendosi te refuzoje oferten e OE "A.L-ASFALT" SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", OE "A.L-ASFALT" SH.P.K, me Nuis K81511508A, *skualifikohet*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "BE - IS SH.P.K", me Nuis K71412003A & "RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN" SH.A, me Nuis J62904264O dhe me oferte ekonomike 155,442,534 (njqind e pesedhjetë e pese milion e katerqind dyzet dy mije e peseqind tridhjetë kater) Lek pa Tvsh, Totali i pikëve të marra 159,45 (njqind e pesedhjetë e nente pike dyzet e pese),
- 2- Operatori Ekonomik "BAMI HOLDING" SH.P.K, me Nuis J94416206R dhe me oferte ekonomike 169,674,403.78 (njqind e gjashtedhjetë e nente milion e gjashteqind e shtatedhjetë e kater mije e katerqind e tre pike shtatedhjetë e tete) Lek pa Tvsh, Totali i pikëve të marra 147,6 (njqind e dyzet e shtate pike gjashte),

- 3- Operatori Ekonomik “KUPA” SH.P.K, me Nuis K51615512C dhe me oferte ekonomike 170,114,614.6 (njqind e shtatedhjete milion e njqind e katermbedhjete mije e gjashteqind e katermbedhjete pike gjashte) Lek pa Tvsh, Totali i pikëve të marra 143,55 (njqind e dyzet e tre pike pesedhjete e pese),
- 4- Operatori Ekonomik “SALILLARI” SH.P.K, me Nuis J62903125G dhe me oferte ekonomike 187,554,734.87 (njqind e tetedhjete e shtate million e peseqind e pesedhjete e kater mije e shateqind e tridhjete e kater pike tetedhjete e shtate) Lek pa Tvsh, Totali i pikëve të marra 132,9 (njqind e tridhjete e dy pike nente),

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

BASHKIA SHKODËR

Drejtuar: LAÇAJ sh.p.k. me NUIS J67019018L..Adresa: Lagjja Guerrile, Rruga 1 Qershori-Shkoder

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-15796-08-08-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës: Rikonstruksion Rruga Mehmet Xhelil Fishta

Fondi limit 24,949,094(Njzet e katermilion e nenteqind e dyzet e nentemije e nentedhjete e kater)lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 5 (pese) muaj.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini Nr. 47 datë 12 Gusht 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik KOMBEAS sh.a me NUIS K88103301J

Vlera 17.110.433 (Shtatembedhjetemilion e njqind e dhjetemije e katerqind e tridhjete e tre) lekë pa tvsh.

2. Operatori ekonomik LAÇAJ sh.p.k. me NUIS J67019018L.
Vlera 16.383.890 (Gjashtembedhjetemilion e treqind e tetedhjetë e tremije e teteqind e nentendhjetë) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik SMO VATAKSI sh.p.k. me NUIS L47022001J.
Vlera 17.107.455 (Shtatembedhjetemilion e njeqind e shtatemije e katerqind e pesedhjetë e pese) lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik NDERTUESI 2014 me NUIS L46827004L
Vlera 18.478.420 (Tetembedhjetemilion e katerqind e shtatedhjetë e tetemije e katerqind e njezet) lekë pa tvsh.
5. Operatori ekonomik STERKAJ sh.p.k me NUIS J68310708M
Vlera 20.574.645(Njezetmilion e peseqind e shtatedhjetë e katermije e gjashteqind e dyzet e pese) lekë pa tvsh.
6. Operatori ekonomik MODESTE sh.p.k me NUIS J62903413B
Vlera 18.499.708,10 (Tetembedhjetemilion e katerqind e nentendhjetë e nentemije e shtateqind e tete pike dhjetë) lekë pa tvsh.
7. Operatori ekonomik NDERTUESI 2000 sh.p.k me NUIS J96409033R
Vlera 17.118.727,50 (Shtatembedhjetemilion e njeqind e tetembedhjetemije e shtateqind e njezet e shtate pike pese) lekë pa tvsh.
8. Operatori ekonomik ALB TIEFBAU sh.p.k me NUIS J66703049C
Vlera 19.932.675 (Nëntëmbëdhjetëmilion e nëntëqind e tridhjetë e dymijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.
9. Operatori ekonomik CURRI sh.p.k me NUIS J67902718S
Vlera 21.003.260,25 (Njezet e njemilion e tremije e dyqind e gjashtedhjetë presje njezet e pese) lekë pa tvsh.
10. Operatori ekonomik "KARL GEGA KONSTRUKSION" sh.p.k me NUIS J66703076W
Vlera 18.007.133(Tetembedhjetemilion e shtatemije e njeqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.
11. Bashkimi i operatoreve ekonomik K.M. KONSTRUKSION sh.p.k me NUIS K66725002G& VISCONS GROUP sh.p.k me NUIS L96513208E perfaqesuar nga K.M. KONSTRUKSION sh.p.k
Vlera 18,618,821(Tetembedhjetemilion e gjashteqind e tetembedhjetemije e teteqind e njezet e nje) lekë pa tvsh.
12. Operatori ekonomik ALB – KONSTRUKSION sh.p.k me NUIS J76705049N
Vlera 18.775.627,50 (Tetembedhjetemilion e shtateqind e shtatedhjetë e pesemije e gjashteqind e njezet e shtate presje pesedhjetë) lekë pa tvsh.
13. Operatori ekonomik 2 N sh.p.k me NUIS L31615017L
Vlera 19.530.000 (Nentembedhjetemilion e peseqind e tridhjetemije) lekë pa tvsh.
14. Operatori ekonomik RSM COMPANY sh.p.k me NUIS 810802422
Vlera 18.713.100 (Tetembedhjetemilion e shtateqind e trembedhjetemije e njeqind) lekë pa tvsh.
15. Operatori ekonomik OUEN sh.p.k me NUIS K17529215O
Vlera 23.678.865 (Njezet e tremilion e gjashteqind e shtatedhjetë e tetemije e teteqind e gjashtedhjetë e pese) lekë pa tvsh.
16. Operatori ekonomik KEVIN KONSTRUKSIONsh.p.k me NUIS K71401004W
Nuk ka paraqitur oferte

Nga pjesëmarrësit ka ofertues të skualifikuar:

1. U skualifikua operatori ekonomik STERKAJ sh.p.k me NUIS J68310708M

- Nuk plotesoni piken 2.3.4 Kapaciteti teknik te DST pasi nuk keni paraqitur vetdeklarim nga inxhinierët se ata jane te disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.
2. U skualifikua operatori ekonomik ALB TIEFBAU sh.p.k me NUIS J66703049C
- Ne preventivin e punimeve ka ndryshime volumi tek zeri An – 4 Pusete kontrolli 1x1x1 m b/a 20/25,kapak gize, pasi sasia e kerkuar ne preventivin e publikuar nga AK eshte cope 4 ndersa ne preventivin e paraqitur nga ofertuesi eshte vendosur cope 1.
3. U skualifikua operatori ekonomik KEVIN KONSTRUKSIONsh.p.k me NUIS K71401004W
-Nuk keni paraqitur formularin e ofertes, shtojcen nr. 8 dhe dokumentacionin e nevojshem per kualifikim per këtë procedure prokurimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë LAÇAJ sh.p.k. me NUIS J67019018L..Adresa: Lagjja Guerrile, Rruga 1 Qershori-Shkoder, se oferta ekonomike e paraqitur me vlerë 16.383.890 (Gjashtembdhjetemilion e treqind e tetedhjetë e tremije e teteqind e nentedhjetë) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

BASHKIA MALËSI E MADHE

Drejtuar: [LAÇAJ shpk, me nr. NIPT-i: J67019018L me adrese: SHKODER Lagjja Guerrile, Rruga 1 Qershori, godine 2-kateshe, katiti 1-re, me nr 6/372]

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e thjeshtuar.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-15042-07-31-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Sistemim asfaltim rruga e Virit Kosan, me fond limit 8 145 181 (tetë milion e njëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH dhe 9 774 217 (nëntë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëmbëdhjetë) lekë me tvsh.

Për vitin 2024: 2 074 217 (dy milion e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëmbëdhjetë) lekë me tvsh.

Për vitin 2025: 3 000 000 (tre milion) lekë me tvsh.

Për vitin 2026: 4 700 000 (katër milion e shtatëqind mijë) lekë më tvsh, kohezgjatje 90 dite]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data: 19 Gusht 2024] [Nr. 51]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **LAÇAJ** **J67019018L**
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-t*
Vlera : 6 459 410 (gjashtë milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dhjetë) lekë pa tvsh.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. **NDERTUESI 2014** **L46827004L**
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*
Vlera : 6 702 850 (gjashtë milion e shtatëqind e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. **SMO VATAKSI** **L47022001J**
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*
Vlera : 7 158 090 (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Nuk ka

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [LAÇAJ shpk, me nr. NIPT-i: J67019018L me adrese: SHKODER Lagjja Guerrile, Rruga 1 Qershori, godine 2-kateshe, katiti 1-re, me nr 6/372], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 6 459 410 (gjashtë milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e dhjetë) lekë pa tvsh] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

AGJENCIA E MBROJTJES SE KONSUMATORIT

Drejtuar: **BESNIK MEÇI**
Adresa: Autostrada Tirane-Durrës, Km.5 Kashar, Godine një katëshe përballe QTU-së. Mëzes,
Tiranë, Rurale 2 Nr Pasurie 11/74

Procedura e prokurimit/lotit: Proçedurë e Hapur e Thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF- 15916-08-12-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Shërbim mirëmbajtje automjete” me fond limit: 1.250.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike 19.08.2024 Nr. 51

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Besnik Meçi Numri i NIPT: L12407012R
Vlera 937.500 (nëntëqind e tridhjetë shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:
- Nuk ka pjesëmarrës të skualifikuar

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik BESNIK MEÇI me adresë: Rruga Autostrada Tirane-Durrës, Km.5 Kashar, Godine një katëshe përballe QTU-së. Mëzes, Tiranë, Rurale 2 Nr Pasurie 11/74, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 937.500 (nëntëqind e tridhjetë shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH. është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

OPERATORI I BLERJEVE TE PERQENDRUARA

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "SORI-AL" SHPK

Adresa: Rruga "Faik Konica", Pallati "Golden Park Residence", Hyrja Nr. 1, Kati Nr. 1, Zyra Nr.1, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar", Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-11829-07-02-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti 2: "Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në Spitalin Psikiatrik "Ali Mihali", Vlorë", me fond limit: 316,793,525 (treqind e gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH, ose 3,156,886.15 (tremilion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë pesëmbëdhjetë) Euro pa TVSH, me afat marreveshje kuader 48 (dyzet e tetë) muaj.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.35 datë 08.07.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. "SORI-AL" shpk

K31510059D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 302,149,920 (treqind e dy milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH

2. BOE "S I L V E R" sh.p.k + "NIKA" sh.p.k

K88010301S + J76705047U

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: 292,000,000 (dyqind e nëntëdhjetë e dy milionë) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. BOE "S I L V E R" sh.p.k + "NIKA" sh.p.k

K88010301S + J76705047U

për arsye se:

BOE, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon:

- Anëtar i BOE Operatori ekonomik "NIKA" sh.p.k. me NUIS J76705047U nuk plotëson pikën 2.1.1, të seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e Licencës të kategorisë II.1.A.1

“Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, e cila duhet të lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate. Licenca e paraqitur nga OE “NIKA” sh.p.k. LN-3194-04-2011, ka veprimtari specifike “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Restorant)” e cila nuk është në përputhje me fushën specifike të veprimtarisë objekt prokurimi e cila është “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në spitalin psikiatrik Ali Mihali, Vlorë”. Licenca e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duhet të përfshijë si veprimtari specifike shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e tij, pra si veprimtari specifike e licencës II.1.A.1 duhet përveç gatimit edhe shpërndarja, pra shoqëritë pjesëmarrëse duhet të kenë si veprimtari specifike shërbim katering. Përmbushja e këtij kriteri nga antari i BOE është detyrim sipas sipas pikës 3 të Nenit 88 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

- Anëtari i BOE operatori ekonomik “NIKA” sh.p.k. me NUIS J76705047U nuk plotëson pikën 2.3.5, të seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e 1 (një) mjeti transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore.

Në kontratën e bashkëpunimit Nr. Repertori 5745, Nr. Koleksioni 1929 datë 30.07.2024 lidhur mes shoqërisë “S I L V E R” sh.p.k. me NUIS K88010301S & “NIKA” me NUIS J76705047U , në nenin 4 Pjesëmarrja, është përcaktuar se shoqëria “NIKA” sh.p.k. do të ketë një pjesëmarrje prej 45% të sasisë totale Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarja e ushqimit në spitalin psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë dhe konkretisht furnizimin me produkte ushqimore, transportin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit.

Referuar formularit të vetëdeklarimit të paraqitur nga shoqëria “NIKA” sh.p.k. rezulton se kjo shoqëri nuk disponon një automjet frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore që ka marrë përsipër të realizojë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm: “SORI-AL” shpk, i cili ka paraqitur ofertën me vlerë totale prej 302,149,920 (treqind e dy milion e njëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

BASHKIA ROSKOVEC

Drejtuar: [“2 N” SHPK, adresa: Tirane Paskuqan PASKUQAN Lagjja "Paskuqan Fushe", Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Pare.]

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-15135-08-01-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: ["Ndërtim i parkut të ri të qytetit".]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “BEAN ” SHPK

J72510445Q

- Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

- Vlera 17 773 580.38 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë pik tridhjetë e tetë) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjalë)

2. “2 N” SHPK

L31615017L

- Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

- Vlera: 18 661 795.56 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë pik pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjalë)

3. BOE: “NGRACAN 1934” SHPK & “GLAVENICA” SHPK

J87602809S & K17710805A

- Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

- Vlera 18 899 959.44 (tetëmbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë pik dyzetë e katër) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjalë)

4. BOE: “VISCONS GROUP ” SHPK & “I.C.C GROUP” SHPK

L96513208E & L51308006A

- Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

- Vlera 19 340 135 (nëntëmbëdhjetë million e treqind e dyzetë mijë e njëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjalë)

5. "FLED" SHPK K17621104C
• Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
- Vlera 20 230 741.24 (njëzetë milion e dyqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e dyzetë e një pik njëzetë e katër) lekë pa tvsh
(me numra dhe fjalë)

6. BOE: "SARDO" SHPK & "LIQENI VII" SHPK K13120402W & K01730502W
• Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
- Vlera: 20 900 000 (njëzetë milion e nëntëqind mijë) lekë pa tvsh.
(me numra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "BEAN" SHPK J72510445Q
• Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik "BEAN" SHPK nuk paraqiti dokumentacionin në protokollin e bashkisë brenda afatit të caktuar nga KVO.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: ["2 N" SHPK, adresa: Tirane Paskuqan PASKUQAN Lagjja "Paskuqan Fushe", Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Pare.], se oferta e paraqitur me vlerë totale: 18 661 795.56 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë pik pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh./ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik.

BASHKIA DIBËR

Drejtuar: NDREGJONI me adrese: Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Ndertesa Nr. 32, Hyrja 8

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur e thjeshtuar

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Nr. I references REF-14748-07-29-2024 me objekt: Rehabilitim i rruges se fshatit Gure- Lure , Njesia Administrative Lure, Bashkia Diber , me fond limit 4.163.672 (Kater milion e njeqind e gjashtedhjete e tremije e gjashteqind e shtatedhjete e dy) leke pa TVSH, afati i zbatimit te kontrates 2 muaj

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. DODA-R J97005705B

Vlera e ofruar: 3.819.450 (tre milion e teteqind e nentembedhjete mije e katerqind e pesedhjete) leke pa tvsh.

2. LIQENI VII K01730502W

Vlera e ofruar: 3.982.240 (tre milion e nenteqind e tetedhjete e dy mije e dyqind e dyzete) leke pa tvsh.

3. NDREGJONI K31329048I

Vlera e ofruar: 3.777.900 (Tre milion e shtateqind e shtatedhjete e shtatemije e nenteqind) leke pa tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:
S”ka

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1. NDREGJONI K31329048I

Vlera e ofruar: 3.777.900 (Tre milion e shtateqind e shtatedhjete e shtatemije e nenteqind) leke pa tvsh

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

BASHKIA DIBËR

Drejtuar: : SELAMI me adrese: Diber Peshkopi PESHKOPI Lagjja "Industriale", Rruga "Ismail Feta", Ish fusha e mbetjeve urbane, zona kadastrale 2 Nr.2932, Pasuria nr.23/129-ND

* * *

Procedura e prokurimit: Procedure e hapur

Number of procedure/lot reference:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Nr. I references REF-14740-07-29-2024, me objekt: Sistemim asfaltim i rrugeve te brendshme te fshatit Dohoshisht , lagjia Dede, Selane , dhe rruga per te varrezat e fshatit: me fond: 20.796.929,37(Njzet milion e shtateqind e nentedhete e gjashte mije e nenteqind e njetzet e nente presje tridhete e shtate) leke pa TVSH , afati i zbatimit te kontrates / 8 muaj

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

- 1- Nipti: J77304706L Emri i Subjektit: SELAMI Objekti i Aktivitetit: Linje prodhimi inertesh, linje asfalto betoni, bar-bufe-restaurant-hotel.Ndërtim dhe rikonstruksion ndërtesash, punime infrastrukturë si:ujësjellsa, kanalizimerrugë, impiante të trajtimit dhe pastrimit, tregtim të materialeve të ndërtimit, import-eksp... I cili ka paraqitur oferten ekonomik me vlere 18.164.410,5 (Tetembedhete milion e njeqind e gjashtedhete e kater mije e katerqind e dhjete presje pese) leke pa tvsh.
- 2- Nipti: L31615017L Emri i Subjektit: 2 N Objekti i Aktivitetit: Zbatim, projektim e ndertime civile, ekonomike, punime dheu, sistemin taracime, prodhime elementesh te parafabrikuara, betoni e beton arme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Nderti... I cili ka dhene oferten ekonomike me vlere 19.489.196.5 (Nentembedhete milion e katerqind e tetedhete e nente mije e njeqind e nentedhete e gjashte presje pese) leke pa tvsh.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

S'KA

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

- 1- Nipti: J77304706L Emri i Subjektit: SELAMI Objekti i Aktivitetit: Linje prodhimi inertesh, linje asfalto betoni, bar-bufe-restaurant-hotel.Ndërtim dhe rikonstruksion ndërtesash, punime infrastrukturë si:ujësjellsa, kanalizimerrugë, impiante të trajtimit dhe pastrimit, tregtim të materialeve të ndërtimit, import-eksp... I cili ka paraqitur oferten

ekonomik me vlere 18.164.410,5 (Tetëmbdhjete milion e njëqind e gjashtëdhjete e kater mije e katerqind e dhjete presje pese) leke pa tvsh.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

BASHKIA FUSHË ARRËZ

Drejtuar: /O.E Subjekti “Rroku GUEST”, Sh.p.k me Nipt: K87921701H, me adresë: Rr. Nazmi Kryeziu, Nd 1/1, H 2, Ap.8, Shkodër,]

Procedura e prokurimit/lotit:E Hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-15197-08-02-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [*Objekti*, “Rehabilitim i diges se rezervuarit Iballe”, me fond limit 49 514 870 (dyzet e nente milion e pesëqind e katermbdhjet mije e teteqind e shtatedhjet) leke pa TVSH, financuar nga Buxheti i Shtetit]

Publikimet e mëparshme (*nuk ka pasur*):

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.47 date 12.08.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. B.O.E “DRINI-1” & “NDREGJONI”

J78716317H

K31329048I

Numri i NIPT-t

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera : 37,118,218 (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e tetëmbdhjetë mijë e dyqind e tetëmbdhjetë) leke pa Tvsh dhe 44,541,861 (dyzet e katër milion e pesëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një) leke me Tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. B.O.E “NDERTUESI 2014”& “VARAKU E”

L46827004L

J61902509S

*Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-it*

Vlera 107,151,350 (njëqind e shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH;

3. “Farma Net Albania”sh.p.k, Nipt K92201080V
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera 96,778,010 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dhjetë) lekë pa TVSH;

4. Operatori ekonomik “ISOMETRIC”sh.p.k, Nipt L92207009A
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera 69,211,800 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH;

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. BOE “MARKETING & DISTRIBUTION + EUROMED s’kualifikohet

- Operatori ekonomik BOE “MARKETING & DISTRIBUTION + EUROMED ”sh.p.k, me NUIS J72124001N +K71718012P, nuk përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT, për këto arsye:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.1, të kriterëve të veçanta për kualifikim, shtojca 7 e DT, pasi antari i BOE operatori ekonomik MARKETING & DISTRIBUTION sh.p.k, pjesëmarrës ne BOE me 40%, nuk ka realizuar furnizime të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit, (Antari i BOE ka detyrimin e plotësimit të kërkesave teknike në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në akt-marrëveshje. (neni 88, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar). Konkretisht të gjitha kontratat e ngjashme të paraqitura nga MARKETING & DISTRIBUTION sh.p.k të listuara me poshte nuk jane kontrata te ngjashme me objektin qe prokurohet. Materialet kancelarike, baterite apo letrat mund te jene produkte qe perdoren neper shkolla, por nuk jane produkte didaktike, pra qe ndikojne ne teorine e mesimit apo mesimdhënies. Per kete arsye nuk konsiderohen aspak te ngjashme pasi qellimet dhe e perdorimit jane te ndryshme.

Kontratat e ngjashme: Dokumentat me mertimet (10_fatura_1_loti_1_ dhe 10_fatura_loti_2_merged dhe 11_fatura_2_loti_1 dhe 11_fatura_loti_2), permban fatura vetem per artikuj Bateri, depilator etj. te cilat nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit.

Emertimi	Objekti I kontrates
12_kontrate_ost+_vertetim	Blerje kancelarie

12_kontrate_universiteti_bujqesor_i_tiranes_+_vertetim	Blerje kancelarie(dosje, letra,zarfa, boje printer, bllok, CD)
13_kontrata_fier_+_vertetim_realizimi	Blerje leter
13_Kontratë_DPC_merged	Blerje kancelari(stilolapsa, letra, bojra printeri etj.)
14_Kontratë_AgrokrediT_+_Vertetim_Realizimi	Blerje kancelari(stilolapsa, letra, zarfa,USB etj.)
14_Kontrate_Vlora_+_vertetim_realizimi	Blerje leter A4
15_kontrata_shish_+_vertetim_realizimi	Blerje kancelari(marker, qese, kapse, tela etj.)
15_Kontratë_SHISH_+_Vertetim_Realizimi	Blerje materiale kancelari dhe leter (marker, kapse, vinovil, karton)
16_kontrata_Tirana_Parking_+_Vertetim	Blerje materiale kancelari (etiketa, USB, stilolapsa, dosje etj)
16_Kontratë_leter_ATP_+_Vertetim_Realizimi	Blerje Leter
17_Kontrate_Bashkia_Mat_+_vertetim_realizimi	Blerje kancelari (DVD, CD, Dosje, leter, boje printeri) numri I protokollit i kontrates nuk perputhen me ate qe eshte shenuar te vertetim realizimi
17_Kontrate_Kryeministria_leter_27.10.2023_+_vertetim_Realizimi	Blerje Leter
18_Kontrate_Bashkia_Tirane_Taksat_+_vertetim_Realizimi	Blerje Leter A4
19_Kontrate_Kryeministria_Leter_22.05.2023	Blerje Leter
20_Kontrate_B_Divjake_+_vertet	Blerje Kancelaria

II. Operatori ekonomik BOE nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas Shtojcës 5 Specifikimet Teknike, pasi në katalogogët e paraqitur rezultojnë mangësi serioze si më poshtë vijon:
FIZIKA BAZE

Produkti 1 nuk ofrohet “A Pe-Lead”, gjithashtu per 4 kokat e kauçkut per te fiksuar elementet e kitit jane ofertuar koka gome.

Produkti 8 ne katalog permban 2 paragrafet e fundit me specifikime te produktit 7. Specifikimet e vendosura nuk lidhen me produktin 8, sepse ata I perkasin aparatit 7

Produkti 9 fotoja nuk perputhet me aparatit e kerkuar dhe nuk I referohet aparatit perkates

Produkti 14 nuk tregohet nese kabllot jane me koke takuese apo jo

Produkti 15 foto nuk i referohet produktit

Produkti 17 “Rheostat (0=50) OM” njesia eshte shenuar gabim per reostatin pasi duhet Ω ose Ohm

Produkti 18 foto nuk i referohet specifikimeve teknike

Produkti 19 foto nuk i referohet specifikimeve teknike

Produkti 20 nuk permendet te ofrohet tallazh hekuri

Produkti 21 nuk specifikohet nese elektroskopi ka flete

Produkti 22 nuk permendet nese eshte e perbere nga nje makara alumini me nr Sp251 18 dhe nje tjeter me nr. Sp252 24

Produkti 23 mungon gypi i qelqit

Produkti 25 tek specifikimet “nje pasqyre e luget” eshte perkthyer “a spoon mirror”

FIZIKA E MESME

Produkti 1 nuk ofrohet "A Pe-Lead", gjithashtu per 4 kokat e kauçkut per te fiksuar elementet e kitit jane ofertuar koka gome.

Produkti 13 ne katalog permban 2 paragrafet e fundit me specifikime te produktit 12. Specifikimet e vendosura nuk lidhen me produktin 8, sepse ata i perkasin aparatit 12

Produkti 16 fotoja nuk perputhet me aparatit e kerkuar dhe nuk i referohet aparatit perkates

Produkti 12 eshte i njejte si produkti 7 tek fizika baze por ne foto jane dy produkte te ndryshme

Produkti 16 eshte i njejte si produkti 9 tek fizika baze por ne foto jane dy produkte te ndryshme gjithashtu produkti 9 tek fizika baze nuk i referohet specifikimeve, kjo tregon qe kompania nuk ehste e qarte se çfare produkti do te ofroje.

Produkti 21 nuk tregohet nese kabllot jane me koke takuese apo jo

Produkti 22 nuk specifkohet sakte materiali percjelles, eshte i shkruar gabim e anglisht

Produkti 23 foto nuk i referohet produktit

Produkti 25 "Rheostat (0=50) OM" njesia eshte shenuar gabim per reostatin pasi duhet Ω ose Ohm

Produkti 26 titulli eshte shkruar fem kur duhet te jete f.e.m. , gjithashtu dhe tek specifikimet eshte shkruar e tille

Produkti 28 foto nuk i referohet specifikimeve teknike

Produkti 30 foto nuk i referohet specifikimeve teknike

Produkti 31 nuk permendet te ofrohet tallazh hekuri

Produkti 33 nuk specifkohet nese elektroskopi ka flete

Produkti 34 nuk permendet nese eshte e perbere nga nje makara alumini me nr Sp251 18 dhe nje tjetere me nr. Sp252 24

Produkti 38 nuk permendet nese ofertohe apo jo pasqyre e myset dhe pasqyre e luget

Produkti 39 nuk permendet nese ne kit perfshihet pasqyre e myset

Produkti 40 tek specifkimet "nje pasqyre e luget" eshte perkthyer "a spoon mirror"

Produkti 42 foto nuk i referohet produktit perkates

Produkti 43 nuk specifkohet marresi i valeve

III. Operatori ka paraqitur formularin e deklarimit të ofertës Shtojca 1 në mospërputhje të plotë të vlerave të regjistruara në formularin e cmimeve dhe sasive Shtojca 2, ku në formularin e cmimit ka deklaruar vlerën 5,463,889 (pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ndërsa në fomularin e Cmimeve njësi dhe Sasive ka paraqitur një vlerë në total prej 88,857,523 lekë pa TVSH. Kjo paraqitje e ofertës ekonomike është jo serioze dhe vjen në kundërshtim me përcaktimin e DST për plotësimin e saktë të formularit të deklarimit të ofertës.

2. "ISOMETRIC" sh.p.k

s'kualifikohet

- Operatori ekonomik "ISOMETRIC"sh.p.k, me NUIS L92207009A, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk plotëson kërkesat e vecanta për kualifikim, pasi paraqet mangësi thelbësore në lidhje me vërtetimin e kapaciteteve teknike të kërkuara për realizimin e objektit të prokurimit e konkretisht ;

- I. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim në DST, mbi disponimin e 3(tre)mjete të transportit në pronësi ose qera. Për plotësimin e këtij kriteri, në Formularin e Vetdeklarimit OE ka deklaruar se disponon 2(dy)automjete në pronësi dhe 3(tre) me qera. Për 2(dy) mjetet në pronësi rezultoi se automjetet NISSAN JUKE dhe MERCEDEZ VIANO janë të kategorisë kategorisë "veturë" dhe "suv" për transport të njerëzve, ndërkohë që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar mjete për transportin e mallrave të përcaktuara në shtojcën 6 të

DST. Në lidhje me mjetet e deklaruara me qera, OE ka paraqitur një “Kontratë premtimi qeraje” dhe jo një kontratë qeraje të vlefshme, në kundërshtim me kërkesën e Autoritetit Kontraktor dhe Formularin e Vetdeklarimit ku pretendohet se është sigurur qeraja e autmjetëve. Përveç mosrepektimit të formës juridike të kërkuar, nënshkruesi i kontratës M.A person fizik nuk është pronari i mjeteve të transportit që citohen në marrëveshje, por ato janë regjistruar në emër të SH.A. Dokumentet e paraqitura nuk sqarojnë cila është lidhja e këtyre subjekteve në funksion të kontratës. Nga ana e përmbajtjes dokumenti “Kontratë premtimi qeraje” tregon se OE ISOMETRIC nuk i disponon mjetet me qera as në këtë moment dhe as në momentin në rast se do të klasifikohet. Kontrata e paraqitur “premtim qeraje” parashikon se do hyjë në fuqi vetëm në rastin e fitimit të procedurës së prokurimit dhe pas konfirmimit të aprovimit nga palët, pra nuk ka garanci juridike për AK nëse pala ofruese e mjeteve do të terhiqet nga Marrëveshja. Në konkluzion, dokumentet e paraqitura nga ISOMETRIC sh.p.k për automjetet që disponon deri në afatin e vendsour për hapjen e ofertave, nuk i përmbushin kushtet dhe qëllimet e përcaktuara nga Autoritetin Kontraktor për disponimin e automjeteve të transportit për realizimin e objektit të kontratës.

II. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6 të Kriteve të Vecanta për Kualifikim mbi disponimin e numrit të punonjësve të kërkuar (3 shoferë dhe 6 puntorë të thjeshtë). Nga vlerësimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezultoi se:

Operatori ka ngarkuar në SPE vetëdeklarimin datë 12.08.2024, ku ka listuar 6 (gjashtë) punonjës të thjeshtë dhe 3 (tre) shoferë, si dhe kontratat të punës për personelin e listuar. Referuar kontratave për punonjësit rezultoi se punonjësit e deklaruar si shoferë në fakt janë punonjës të punësuar në pozicione të stafit kryesor drejtues dhe teknik të subjektit e konkretisht:

-Znj.E.H e deklaruar si shofer në kontratën 23.02.2024, rezultoi se punësuar si mjeke e përgjithshme dhe specialiste e aparaturave laboratorike mjeksore

-Z.R.B i deklaruar si shofer në kontratën 23.02.2024, rezultoi se punësuar si inxhinier kimist në funksion të instalimeve të pasjiveve dhe dorëzimeve

-Z.D.H i deklaruar si shofer, në kontratën 23.02.2024 rezultoi se punësuar si Drejtues Teknik dhe specialist Bioteknolog molekular dhe industrial.

Sikurse provohet nga këto dokumente kemi të bëjmë me deklarime të paskata për qëllime kualifikimi, të cilat vërtetojnë mungesën e kapaciteteve teknike të ISOMETRIC në lidhje me realizimin e procesit të lëvrimin të mallrave objekt pasi rezultoi se përveç mosdisponimit të automjeteve subjekti subjekti ofron si shoferë stafin kryesor teknik të shoqërisë (doktoreshw, inxhinier kimist, inxhinier biolog) Në këtë kontekst KVO e vlerëson dokumentacionin më sipër më sipërm konsiderohet i pavlefshëm si deklarim i pasaktë dhe sipas paragrafit të fundit të shtojcës 8 “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”.

III. Operatori ekonomik ISOMETRIC sh.p.k nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas Shtojcës 5 Specifikimet Teknike, pasi në katalogogët e paraqitur rezultojnë mangësi serioze si më poshtë vijon:

FIZIKA BAZE

Produkti 1 “A plastic” nuk specifikohet që është shirit meter, është shkruar gabim

“A Pe-Lead” është shkruar gabim.

Produkti 4 nuk tregon që është e varur në një kornizë prej çeliku dhe e montuar

Produkti 8 nuk tregon që është material plumbi. Modifikuar gabim fjalë e fundit faqe 9 në katalog “Thy are...”

Produkti 9 mungojnë 5 llampushka

Produkti 10 modifikim gabim faqe 11 të katalogut “të urea-shaped Roldus”

Produkti 11 nuk tregohet nëse termometri është merkuri

Produkti 13 foto nuk perputhet me specifikimet, ne foto mungojne 2 kanaçe bakri, 4 ene cilindrike 250mg dhe 4 shufra prej gome

Produkti 17 “3x cell holder 4.5V” ehste shkruar gabim. Mungon kutia per pilat, ka vetem nje kuti per llampat. Ciftet e fijeve lidhese jane ofruar te zeza dhe jo te kuqe

Produkti 18 mungon pajisja qe furnizon me rryme elektrike, 1 cift me tela kapese, 1 bobine ne forme cilindrik, tabela e demonstrimit. Gjithashtu katalogu zyrtar ne faqe 18 produkti me kod PT2113EM eshte ndryshe nga ai I paraqitur ne tender.

Produkti 19 per shufren magnetike mungojne permasat 50x7 mm, mungon permasa e bobines dhe gozhdat duhen 5 cope plastike

Produkti 20 ka te shenuar vetem nje shufer magnetike pa gjatesine pa tallazh hekuri 500mg dhe busull magnetike pa treguar diametrin dhe materialin e saj

Produkti 21 sferat jane ofruar polistiren te metalizuara, mungon dimensionin I dorezes, ka nje kanaçe alimini, mungon nje shirit celluloid, nje trazues teli, nje grep teli, tabela e demonstrimit, fletet e elektroskopit nuk tregohen se cfare materiali jane.

Produkti 23 “A glass funnel” eshte shkruar gabim pasi eshte kerkuar gyp qelqi

Produkti 24 mungon raportori “Protractor”

Produkti 25 pasqyra e sheshte nuk eshte specifikuar nese eshte e tille, pasqyra e luget eshte specifikuar si “Spoon mirror” ndersa pasqyra e myset nuk eshte specifikuar fare

Produkti 26 mungon nje rotor me doreze qe e rrotullon dhe mungon manuali

FIZIKA E MESME

Produkti 1 “A plastic” nuk specifikohet qe eshte shirit meter, eshte shkruar gabim, “a rubber aluminium cylinder” duhet cylinder alumini prej kauçuku. Mungon raportori. “A Pe-Lead” eshte shkruar gabim.

Produkti 4 nuk tregon qe eshte e varur ne nje kornize prej çeliku dhe e montuar

Produkti 5 ne titull eshte vendosur “G” e madhe

Produkti 7 mungon raportori eshte shkruar “a standard type metal rack”, peshorja nuk eshte ofruar me susta

Produkti 12 mungon tabela e demonstrimit

Produkti 13 nuk tregon qe eshte material plumbi. Modifikuar gabim fjalia e fundit faqe 9 ne katalog “Thy are...”

Produkti 14 nuk tregohet qe eshte trup I ngurte me forme te rregullt

Produkti 17 modifikim gabim faqe 11 te katalogut “tëo urea-shaped Roldus”

Produkti 18 nuk tregohet nese termometri eshte merkuri

Produkti 20 foto nuk perputhet me specifikimet, ne foto mungojne 2 kanaçe bakri, 4 ene cilindrike 250mg dhe 4 shufra prej gome

Produkti 25 “3x cell holder 4.5V” ehste shkruar gabim. Mungon kutia per pilat, ka vetem nje kuti per llampat. Ciftet e fijeve lidhese jane ofruar te zeza dhe jo te kuqe

Produkti 27 “A cylinder shape 5c25mm” nuk tregohet qe eshte magnet

Produkti 28 mungon pajisja qe furnizon me rryme elektrike, 1 cift me tela kapese, 1 bobine ne forme cilindrik, tabela e demonstrimit. Gjithashtu katalogu zyrtar ne faqe 18 produkti me kod PT2113EM eshte ndryshe nga ai I paraqitur ne tender.

Produkti 29 “1 Nikel coil ëith 120 turns, duhet 1200 spira me nukel

Produkti 30 per shufren magnetike mungojhne permasat 50x7 mm, mungon permasa e bobines dhe gozhdat duhen 5 cope plastike

Produkti 31 ka te shenuar vetem nje shufer magnetike pa gjatesine pa tallazh hekuri 500mg dhe busull magnetike pa treguar diametrin dhe materialin e saj

Produkti 32 mungon nje multimeter, ne katalog eshte shkruar 1 milimeter, mungon nje pllake prize, mungon tabela e demonstrimit

Produkti 33 sferat jane ofruar polistiren te metalizuara, mungon dimensiononi I dorezes, ka nje kanaçe alimini, mungon nje shirit celluloid, nje trazues teli, nje grep teli, tabela e demonstrimit, fletet e elektroskopit nuk tregohen se cfare materiali jane.

Produkti 36 mungon nje shufer çeliku 150x0.1mm, gjithashtu eshte ofruar nje kronometer por kerkohej 2

Produkti 37 mungon raportori "Protractor"

Produkti 38 katalogu faqe 33 ne faqen zyrtare te kompanise prodhuese ndryshon me faqen 18 te paraqitur ne tender edhe pse kodet jane te njejta. Katalogu i paraqitur eshte me gabime drejtshkrimore ku fjala "human sight defecuians..." defecuians nuk ekziston ne anglisht. Kerkohej thjerre rrafsh luget, pasqyre luget, pasqyre e myser, eshte ofruar "a spherical plane lens, concave mirrors, concave mirrors".

Produkti 40 pasqyra e sheshte nuk eshte specifikuar nese eshte e tille, pasqyra e luget eshte specifikuar si "Spoon mirror" ndersa pasqyra e myset nuk eshte specifikuar fare

Produkti 44 mungon nje rotor me doreze qe e rrotullon dhe mungon manuali

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomikë i mëposhtëm është identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1. "Farma Net Albania" sh.p.k,
Emri i plotë i shoqërisë

Nipt K92201080V
numri i NIPT-it

Vlera 96,778,010 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dhjetë) lekë pa TVSH;

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

FONDACIONI "DURRAH CITY FOOTBALL ACADEMY"

Drejtuar: WinActive Shpk, me NIPT L61621009H me adresë Njësia Administrative nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati nr. 8, Hyrja 1, Kati 1, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-16253-08-14-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Veshje Sportive me fond limit 6,623,600 (gjashtëmilion e gjashtëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh. Afati i lëvrimit: Brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e nëshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Nuk ka pasur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. WinActive shpk	L61621009H
Emri i plotë i shoqërisë	Numri i NIPT-t
Vlera 6,237,313 (gjashtë milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e trembëdhjetë) lekë pa tvsh.	

2. Sokol Hasani	K61819021V
Emri i plotë i shoqërisë	Numri i NIPT-it

Vlera 6,623,580 (gjashtë milion e gjashtëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm: Nuk ka ofertues te skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë WinActive shpk, me Nipt L61621009H, me adrese Njësia Administrative nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati nr. 8, Hyrja 1, Kati 1, Tiranë se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 6,237,313 (gjashtë milion e dyqind e tridhjet e shtatë mijë e treqind e trembëdhjet lekë) Lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

UNIVERSITETI I TIRANËS

Për: “ATOM” shpk, me adresë: Rruga “Islam Alla”, Pallati 56/1, Tiranë, me Nipt L22203042N.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-14102-07-24-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ngritja e një qëndre llogaritëse në mbështetje të bashkëpunimit të IAL-ve Shqiptare me projektin European Compact Muon Solenoid (CMS) në CERN”

Kohëzgjatja e kontratës: 60 ditë.

Publikime të mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: datë 29.07.2024 / Nr.42

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “Advanced Business Solutions - ABS” Shpk Nipt K21710002J
Vlera 24,859,000.00 (njëzet e katërmilion tetëqind e pesëdhjetë e nëntëmijë) lekë pa TVSH.
2. BOE “C.C.S.” Shpk Nipt J61901033C & “INFOSOFT SYSTEMS” Shpk Nipt J61820021C
Vlera 25,978,000.00 (njëzet e pesëmilion nëntëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë) lekë pa TVSH.
3. OE “ATOM” Shpk Nipt L22203042N
Vlera 28,886,500.00 (njëzet e tetëmilion tetëqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Advanced Business Solutions - ABS” Shpk Nipt K21710002J

Përkatësisht për arsyen e mëposhtme:

- Nuk plotëson Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, pikën 2.4.3 pasi nuk plotësohen specifikimet teknike të artikujve me kërkesat në DT konkretisht për Artikullin Nr.1 Server me GPU nuk specifikohet sasia e RAM që ofrohet dhe frekuenca e saj. Në katalog nuk gjejmë asnjë RAM me frekuencë 5600MT/s, serveri i ofruar sipas procesorit të zgjedhur nga OE ofron frekuencë maksimale prej 5200MT/s. Nuk specifikohet tipi i SSD dhe tipi HDD që do të përdoret në server dhe nuk specifikohet tipi i ushqyesit dhe fakti që është redundant, "hot pluggable".
- Për Artikullin Nr.2 Servers me Cluster nuk specifikohet sasia e RAM që ofrohet dhe frekuenca e saj. Në katalog nuk gjejmë asnjë RAM me frekuencë 5600MT/s, serveri i ofruar sipas procesorit të zgjedhur nga OE ofron frekuencë maksimale prej 5200MT/s. Nuk specifikohet tipi i SSD dhe tipi i HDD që do të përdoret në server. Nuk specifikohet tipi i ushqyesit dhe fakti që është redundant, "hot pluggable". Duke u bazuar tek Zgjidhja Teknike Part Number i server P52535-B21 i paraqitur në ofertën teknike nuk korrespondon me parametrat e kërkuara dhe nuk i plotëson specifikimet teknike.
- Për Artikullin Nr.5 Datacenter Switch Garancia e ofruar në katalogun e pajisjes është 1 vit dhe nuk ka specifikim nëse ofrohen përditësimet e software nga prodhuesi.

- Për Artikullin Nr.6 Access Switch janë ofruar: 44 Autosensing 10/100/1000 ports (IEEE 802.3, 802.3u, 802.3ab). Pra janë ofruar 4 porta më pak të tipit Autosensing dhe 4 portat e tjera të ofruar 4 Combo 10/100/10000Base-T ose 100/1000Mbps SFP Ports nuk e kanë këtë funksion.

- Për Artikullin Nr.8 PC Workstations per studente Workstation i ofertuar është i tipit Dell Precision 3460SFF (Small Form Factor) i cili nuk i përket kategorisë mini sipas përcaktimeve të prodhuesit dhe nuk plotëson këtë parameter Teknik i cili është shumë i rëndësishëm për konfigurimin që pretendohet të ketë laboratorin.

2. BOE “C.C.S.” Shpk Nipt J61901033C & “INFOSOFT SYSTEMS” Shpk Nipt J61820021C

Përkatësisht për arsyen e mëposhtme:

Nuk plotëson Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim, pikën 2.4.3 pasi nuk plotësohen specifikimet teknike të artikujve me kërkesat në DT konkretisht për Artikullin Nr.1 Server me GPU, Duke u bazuar tek katalogu nuk specifikohet sasia e RAM që ofrohet dhe frekuenca e saj. Në katalog nuk gjejmë asnjë RAM me frekuencë 5600MT/s, serveri i ofruar sipas procesorit të zgjedhur nga OE ofron frekuencë maksimale prej 5200MT/s. Ndërkohë RAM i zgjedhur në katalog nga OE është HPE 32GB *1x32GB) Dual Rank x8 DDR5-4800 CAS-40-39-39 EC8 Registered Smart Memory Kit i cili është 4800MT/s. Nuk specifikohet tipi i ushqyesit dhe fakti që është redundant, "hot pluggable".

- Për Artikullin Nr.2 Servers me Cluster nuk specifikohet sasia e RAM që ofrohet dhe frekuenca e saj. Në katalog nuk gjejmë asnjë RAM me frekuencë 5600MT/s, serveri i ofruar sipas procesorit të zgjedhur nga OE ofron frekuencë maksimale prej 5200MT/s. Ndërkohë RAM i zgjedhur në katalog nga OE është HPE 32GB *1x32GB) Dual Rank x8 DDR5-4800 CAS-40-39-39 EC8 Registered Smart Memory Kit i cili është 4800MT/s. Nuk specifikohet tipi i ushqyesit dhe fakti që është redundant, "hot pluggable".

- Për Artikullin Nr.5 Datacenter Switch Garancia e ofruar në katalogun e pajisjes është 1 vit dhe nuk ka specifikim nëse ofrohen përditësimet e software nga prodhuesi

- Për Artikullin Nr.8 PC Workstations per student është ofruar HP 16GB (1x16GB) DDR5-4800 ECC SODIM. Ram i ofruar nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara pasi është 800MT/s më i ngadaltë se specifikimet e kërkuara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “ATOM” shpk, me adresë: Rruga “Islam Alla”, Pallati 56/1, Tiranë, me Nipt L22203042N, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 28,886,500.00 (njëzet e tetë milion tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa TVSh, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Për O.E: Adenis Kastrati p.f, me adresë Lagjja Nr. 4, Rruga “Demokracia”, Godina Nr. 29, Kati 1, Bathore, Tiranë, NIPT- L51611004I.

Procedura e prokurimit/lotit: Prokurim Elektronik – Tender i Hapur i Thjeshtuar.

Numri i procedurës / referenca: REF-12727-07-10-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje tonera” për vitin 2024, me vlerë 1,650,750.08 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë pike zero tetë) Lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme (*nese zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim +

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerën përkatëse të ofruar:

1. Operatori Ekonomik: “Infosoft Office” Sh.p.k me NIPT- J62426002Q.
Vlera e ofertuar: 550,416 (pesëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik: “IT Gjergji Kompjuter” Sh.p.k me NIPT- K81503063B.
Vlera e ofertuar: 699,917 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik: “Adenis Kastrati” p.f me NIPT- L51611004I.
Vlera e ofertuar: 844,000 (tetëqind e dyzetë e katërmijë) Lekë pa TVSH.
4. Operatori Ekonomik: “COLOMBO” Sh.p.k me NIPT - K36608208V.
Vlera e ofertuar: 825,375 (tetëqind e njëzetë e pesëmijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.
5. “MARKETING & DISTRIBUTION” Sh.p.k me NIPT- J72124001N.
Vlera e ofertuar: 989,993 (nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjet e tre) Lekë pa TVSH.
6. Operatori Ekonomik: “Blueprint Technologies” Sh.p.k me NIPT- L82428011G.
Vlera e ofertuar: 1,085,000 (një milion e tetëdhjetë e pesëmijë) Lekë pa TVSH.
7. “LIBRARI DYRRAHU” Sh.p.k me NIPT- L91418502J.
Vlera e ofertuar: 1,388,000 (një milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa TVSH.

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori Ekonomik "COLOMBO" Sh.p.k me numër NIPT K36608208V.

Në shqyrtim të procedurës së ndjekur nga OE "Colombo" Sh.p.k me numër NIPT K36608208V, operatori nuk ka plotësuar kriteret sipas DST.

Në bazë të Formularit të Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2.4.2, përcaktohet se: "Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesë mostrat e produkteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht mostrat për artikujt e preventivit me nr. 1; 3; 4; 7, të cilat duhet të paraqiten brenda orës 11:00, të datës 26.08.2024, para hapjes së vlerësimit nga KVO përkatëse. Kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesën për prokurim."

OE "Colombo" Sh.p.k me numër NIPT K36608208V, nuk paraqiti mostrat e produkteve të kërkuara në afatin e përcaktuar. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të plotësojnë kërkesat e veçanta për kualifikim, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST, në të kundërt ofertat që nuk përkatiten në përputhje me këto kërkesa refuzohen si të papranueshme.

Operatori Ekonomik "Infosoft Office" Sh.p.k me numër NIPT J62426002Q.

Gjatë rishqyrtimit më të detajuar të Dokumentacionit të O.E, konstatohet nga ana e K.V.O, se oferta e paraqitur nga OE "Infosoft Office" Sh.p.k me numër NIPT J62426002Q, rezulton anomalisht e ulët, sipas parashikimeve të Nenit 93 të LPP (i ndryshuar).

Oferta e paraqitur nga OE "Infosoft Office" Sh.p.k me numër NIPT J62426002Q, rezulton anomalisht e ulët, sipas parashikimeve të Nenit 93 të LPP (i ndryshuar) për rrjedhojë në zbatim dhe të ndryshimeve të ligjit të prokurimit publik, neni 93, "pika 5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët."

Operatori Ekonomik "IT Gjergji Kompjuter" Sh.p.k me numër NIPT- K81503063B.

Gjatë rishqyrtimit më të detajuar të Dokumentacionit të O.E, konstatohet nga ana e K.V.O, se oferta e paraqitur nga OE "IT Gjergji Kompjuter" Sh.p.k me numër NIPT- K81503063B, rezulton anomalisht e ulët, sipas parashikimeve të Nenit 93 të LPP (i ndryshuar).

Oferta e paraqitur nga OE "IT Gjergji Kompjuter" Sh.p.k me numër NIPT- K81503063B, rezulton anomalisht e ulët, sipas parashikimeve të Nenit 93 të LPP (i ndryshuar) për rrjedhojë në zbatim dhe të ndryshimeve të ligjit të prokurimit publik, neni 93, "pika 5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët."

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se: Adenis Kastrati p.f, me adresë Lagjja Nr. 4, Rruga "Demokracia", Godina Nr. 29, Kati 1, Bathore, Tiranë, NIPT- L51611004I, me vlerë oferte 844,000 (tetëqind e dyzetë e katërmijë) Lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [_-], është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar).

BASHKIA TIRANË

OPERATORIT EKONOMIK “LIGUS” SHPK

Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati Lani Shpk, Shallvare, kati 5, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - mallra.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-13450-07-17-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Karrotrec për Policinë Bashkiake”.

Kohëzgjatja e kontratës: Data e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditë pune. Lejohet lëvrimi i pjesshëm i mjeteve, brenda këtyre afateve. Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [22.07.2024] [Nr.40].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- | | |
|---|------------------------------------|
| 1. Operatori ekonomik “LIGUS” SHPK
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera 67,800,000 [gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetëqind mijë] lekë pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë) | NIPT L51523001S
Numri i NIPT-t |
| 2. Operatori ekonomik “SPARKLE 32” SHPK
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera 69.000.000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion) lekë pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë) | NIPT L51327014R
Numri i NIPT-it |

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- | | |
|---|-----------------|
| 1.Operatori ekonomik “SPARKLE 32” SHPK
Për arsyet e mëposhtme: | NIPT L51327014R |
|---|-----------------|

1. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 1) d. “Lista e cmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2” referuar Kriteve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së, pasi lista e cmimeve dorëzuar nga operatori nuk është dorëzuar në formatin e publikuar në DST. Referuar edhe vendimin të KPP-së Nr. 666/2021 ku për të njëjtin rast është marrë vendimi si me poshtë:
“Sa më sipër KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriteve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “x” Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.”
Gjithashtu, referuar DST-së, Udhëzime për Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika B. PËRGATITJA E OFERTAVE, nënpika 9/1 Periudha e vlefshmërisë së Ofertës, citohet shprehimisht: 1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.
2. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.2.1 të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së ku citohet se: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.” Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentin lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, me Nr. T11162495, datë 06.08.2024, nga ku rezulton se nuk plotëson vlerën e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar e cila duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet, përkatësisht 70.000.000 lekë.
3. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.4.2 të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së ku citohet se: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë licencë të vlefshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kategoria VII.3.B, sipas Udhëzimit Nr. 1546 datë 29.03.2016, “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, ose licencë ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku operatori ekonomik ofertues ka selinë, në rastin e operatorëve ekonomike të huaj.” Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar asnjë dokument që vërteton plotësimin e kriterit të

mësipërm, si rrjedhim KVO është përpara faktit që nuk mund të bëj gjykoj/vlerësoj përse i përket kapacitetit teknik të operatorit ekonomik.

4. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.4.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së ku citohet se: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar për mallrat e kërkuara. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/ Distributorit të Autorizuar si telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet e dokumentuar lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit për mjetet e ofruara”. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur katalogun dhe autorizimin përkatës të mjetit “Kamion Karrotrec Pirun”, ndërkohë që mungon katalogu dhe autorizimi nga prodhuesi/distributori për “Të dhënat e platformës ngritëse”, sipas përcaktimeve të vendosura edhe në specifikimet teknike pjesë përbërëse e DST-ve.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik “Sparkle 32” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur ofertë të pavlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [Operatori ekonomik “LIGUS” SHPK me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati Lani Shpk, Shallvare, kati 5, Tiranë], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 67,800,000 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SARANDË SH.A

Për : Shoqerine “INFOSOFT OFFICE” shpk

NIPT J62426002Q

Procedura e prokurimit : E hapur e thjeshtuar

Numri i references së procedurës : REF 16303 -08-15-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës : Loti 1 : “Blerje Kancelari”

Fondi limit : 1,102,870.30(njemilion njeqind e dymije e teteqind e shtatedhjetemije pike tridhjete) leke pa tvsh

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike nr. 51, date 19 Gusht 2024

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

Kane konkuruar 4 (kater) operatore ekonomike, te cilet kane dorezuar ofertat ekonomike si me poshte:

1. “INFOSOFT OFFICE “ shpk NIPT J 62426002 Q me oferte 795,840.70 (shtateqind e nentedhjete e pese mije e tete qind e dyzete pike shtatedhjete) leke pa tvsh sipas formularit te ofertes.
2. “MARKETING & DISTRIBUTION“ shpk NIPT J 72124001 N me oferte 830,776 (teteqind e tridhjete mije e shtateqind e shtatedhjete e gjashte) leke pa tvsh sipas formularit te ofertes.
3. “LIBRARI DYRRAHU“ shpk NIPT L 91418502 J me oferte 866,666 (teteqind e gjashtedhjete e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhjete e gjashte) leke pa TVSH sipas formularit te ofertes.
4. “IT GJERGJI KOMPJUTER“ shpk NIPT K 81503063 B me oferte 896,617 (teteqind e nentedhjete e gjashtemije e gjashteqind e shtatedhjetemije) leke pa TVSH sipas formularit te ofertes.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit qe kane paraqitur operatoret ekonomike, rezultojne se te kater operatoret ekonomik i plotesojne kerkesat dhe kushtet e DST-se te hartuar nga AK.

Nga sa me siper dhe ne mbeshtetje te Ligjit te Prokurimit Publik Nr. 162, datë 23.12.2020 dhe Nenit 92, KVO-ja konkludon se, ofertat e te 4 operatoreve ekonomik jane te suksesshme, pasi i permbushin te gjitha kriteret dhe kerkesat sipas DST-se te hartuar nga AK.

Duke u nisur nga sa me siper renditja eshte si me poshte:

- | | |
|---|-------------|
| 1.“INFOSOFT OFFICE“ shpk NIPT J62426002Q | KUALIFIKUAR |
| 2.“ MARKETING & DISTRIBUTION “ shpk NIPT J72124001N | KUALIFIKUAR |
| 3. “LIBRARI DYRRAHU” shpk NIPT L 91418502 J | KUALIFIKUAR |
| 4. “IT GJERGJI KOMPJUTER “ shpk NIPT K 81503063 B | KUALIFIKUAR |

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqerine: “INFOSOFT OFFICE“ shpk, me NIPT J62426002Q, Adresa : Tirane, Kashar, Koder Kashar, Autostrada Tirane Dures, km 8 se

oferta e paraqitur, me vlere : 795,840.70 (shtateqind e nentedhjete e pese mije e tete qind e dyzete pike shtatedhjete) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

BASHKIA FIER

Drejtuar: Operatorit ekonomik Enea Masllavica PF
Adresa: Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr,4, Rruga e Dibres, pallati "Andi Konstruksion", kati i pare.
NUIS: L71920001R

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-14977-07-31-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: objekt “Blerje Uniforma per Policine Bashkiake dhe Drejtorine e Sherbimit te MZSH-se, Bashkia Fier”, me 2 lote, Loti 1: Blerje Uniforma per Policine Bashkiake, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej 982 650 (Nenteqind e tetedhjete e dy mije e gjashte qind e pesedhjete) lekë pa TVSH dhe 1 179 180 (nje milion e njeqind e shtatedhjete e nente mije e njeqind e tetedhjete) lekë me TVSH, me burim financimi nga Bashkia Fier, në perputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: - 45 (dyzete e pese) dite nga nënshkrimi i kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [05 Gusht 2024], [Numri 44].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim PQ

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- Operatori ekonomik Enea Masllavica Person Fizik, me NUIS L71920001R. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 951.000 (Nenteqind e pesedhjet e nje mije) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
- Operatori ekonomik Blerina Sadiku Person Fizik, me NUIS K97730102T. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 933,000 [Nentëqind e tridhjetë e tre mijë] pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

- Operatori ekonomik JOSH'S TEX SHPK, me NUIS J66702620Q.
Vlera totale sipas formularit të ofertës është 768 000 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik Blerina Sadiku PF me numër NUIS K97730102T
2. Operatori ekonomik JOSH'S TEX SHPK me numër NUIS J66702620Q

Perkatesisht për arsyet e mëposhtme:

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës O.E Blerina Sadiku Person Fizik, me NUIS K97730102T, konstatoi se:

1. Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3, përcaktohet se:

“Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi për artikujt për këtë objekt prokurimi ose është subjekt tregtar i artikujve objekt prokurimi i autorizuar nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar i Prodhuesit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë i perkthyer në shqip dhe i noterizuar, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij..”

Nga ana e O.E në përmbushje të këtij kriteri është ngarkuar në SPE dokumenti me emertimin “Autorizim_Portwest-Blerina_Sadiku-Bashkia_Fier_-_Policia_Bashkiake_Loti_1”, nga PORTWEST, me lëndë “Autorizim prodhuesi”, datë 08.08.2024, në përmbajtje të së cilit ndër të tjera citohet:

“Autorizojmë kompaninë “Blerina Sadiku” me NIPT K97730102T, me adresë Tiranë, Shqipëri, të dorëzoj ofertën dhe pasi të negocioj dhe të nënshkruaj kontratën me ju të kryej furnizimet e produkteve për prokurimin me titull Loti 1: Blerje Uniforma për Policinë Bashkiake, me numer reference REF:14977-07-31-2024 dhe datë zhvillimi 12.08.2024

Nëse janë të sukseshëm në do të furnizojmë produktet përmes distributorit tonë zyrtar në shqipëri Extrabis SHPK me NIPT L22218008Q...”

Pra sa më sipër, referuar përmbajtjes së këtij dokumenti, fakti që Extrabis SHPK është distributor i PORTWEST deklarohet nga ky i fundit, ndërkohë që operatori ekonomik nuk ka ngarkuar asnjë dokument në SPE për të provuar lidhjen midis Extrabis SHPK si distributor i PORTWEST dhe operatorit ekonomik Blerina Sadiku.

Gjithashtu, dokumenti “Autorizim_Portwest-Blerina_Sadiku-Bashkia_Fier_-_Policia_Bashkiake_Loti_1”, rezulton të jetë leshuar nga një kompani e huaj, ndërkohë që është hartuar në gjuhën shqipe dhe jo në gjuhën zyrtare të vetë kompanisë.

Përsa më sipër konstatuar, KVO më datë 20.08.2024, ju drejtua në rrugë zyrtare nëpërmjet emailt, Z. Ivan Lekic, Menaxher Rajonal- Europa Juglindore, PORTWEST, i cili referuar dokumentit të autorizimit të ngarkuar në SPE, rezulton të ketë firmosur dhe vulosur këtë të fundit, ku i është kërkuar konfirmimi nëse ky dokument është lëshuar nga ana e tij, si dhe nëse Extrabis SHPK, me NIPT L22218008Q, me adresë Autostrada Tr-Dr, km 5, Ndërtesa ZDS, kati 3, Tiranë, Shqipëri, është distributor zyrtar I PORTWEST dhe nëse është në dijeni të faktit që do kryej furnizimin për Lotin 1: Blerje Uniforma për Policinë Bashkiake.

Brenda afatit të caktuar në emalin drejtuar Z. Ivan Lakic (date 23.08.2024) nuk është kthyer përgjigje.

Në këto kushte, KVO vlerëson se dokumenti me emertimin “Autorizim_Portwest-Blerina_Sadiku-Bashkia_Fier_-_Policia_Bashkiake_Loti_1”, i ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3 të Shtojcës 7 të DST-së.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi përfundoi procesin e vlerësimit të procedurës së prokurimit Procedurë e “hapur e thjeshtuar”, me objekt Loti 1 : Blerje Uniforma për Policinë Bashkiake, më datë 12.08.2024, ku rezultoi i kualifikuar i pari operatori ekonomik JOSH’S TEX SHPK, ju drejtua nëpërmjet SPE po më datë 26.08.2024, me kërkesën për paraqitje të dokumentacionit provues të vetëdeklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe të dokumentave të tjera shoqërues të ofertës bazuar në nenin 26, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar brenda datës 29.08.2024.

Nga ana e operatorit ekonomik JOSH’S TEX SHPK, me NUIS J66702620Q, brenda afatit të caktuar në kërkesë nuk u paraqit dokumentacioni i kërkuar si më sipër.

Për sa më sipër, referuar përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST, përkatësisht:

”Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”, oferta e operatorit ekonomik JOSH’S TEX SHPK, me NUIS J66702620Q skualifikohet.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Enea Masllavica PF, me NUIS L71920001R, me adrese: Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr,4, Rruga e Dibres, pallati "Andi Konstruksion", kati i pare,se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 951.000 (nëntëqind e pesëdhjete e një mijë) lekë pa TVSH dhe prej 1.141.200 (një milion e njëqind e dyzetë e nje mijë e dyqind), lekë me TVSH, është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

INSTITUTI I SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË

Drejtuar: OE "Gamma" shpk
Rr."Dervish Hekali", Ndërtesa Nr. 8, Njësia Administrative Nr. 8, Tiranë;

Procedura e prokurimit/lotit: "E Hapur e Thjeshtuar";

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-16539-08-19-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Blerje bazë materiale laboratorike për dëmtuesit e bimëve", 12 muaj nga nënshkrimi I kontratës;

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. O.E "Gamma" sh.p.k,
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera 3,900,000 (tre milion e nëntëqind mijë) Lek pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë) | K31510153H
Numri i NIPT-t |
| 2. O.E "Krijon" sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera 4,271,194 (katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e një qind e nëntëdhjetë e katër)
Lek pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë) | K12023001A
Numri i NIPT-it |
| 3. O.E "MEDFAU" sh.p.k.
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera 4,541,568 (katër milion e pesëqind e dyzet e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e etë) Lek
pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë) | J93610823R
Numri i NIPT-it |

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- | | |
|---|--------------------------|
| 1. O.E "MEDFAU" sh.p.k.
Emri i plotë i shoqërisë | _____
Numri i NIPT-it |
|---|--------------------------|

arsyet e mëposhtme;

- 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar është e specifikuar: Kopje të vertetuara të bilanceve të viteve 2021,2022,2023 të miratuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit. (me firme dhe vule nga ky institucion). Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në SPE rezulton se mungon bilanci 2023.
- Në ofertën teknike mungon “Nr. e faqes ku ndodhet produkti, çertifikimet përkatëse për produktet. Emërtimi i katalogut të artikullit/ produktit “
- Nuk deklarohet” Origjina e mallit”
- 2.3 Kapaciteti teknik është e specifikuar se: Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. (mos markimi me ngjyre të ndezur do të jete kusht skualifikimi). Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në SPE rezulton se ky OE nuk ka markuar specifikimet dhe artikujt.

2. _____ Numri i NIPT-it _____ arsyet e mëposhtme
Emri i plotë i shoqërisë

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “Gamma” shpk, Rr.”Dervish Hekali”, Ndërtesa Nr. 8, Njësia Administrative Nr. 8, Tiranë;, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,900,000 (tre milion e nëntëqind mijë) Lek pa TVSH./ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS

Drejtuar: “BUNA” SHPK me NUIS J61826501C me adresë Lagjja 14, "Bajram Tusha", Shkozet, Durrës.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

“Blerje rafte për bibliotekën, zyra, laboratore dhe blerje perde për godinën e Fakultetit të Edukimit”, me Nr .REF-16328-08-15-2024, me fond limit 4,498,989 (katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e

tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, afati i lëvrimin do të jetë 15 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Loti 1: “Blerje rafte për bibliotekën, zyra, laboratore” me Nr. REF-16331-08-15-2024 me fond limit 1,923,494 (një milion e nëntëqind e njëzet e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) leke pa TVSH, afati i lëvrimin do të jetë 15 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1.Operatori Ekonomik “Igli-Sand” shpk me NUIS J94625209A, me ofertë ekonomike 1 880 000 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSh dhe 2 256 000 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë me TVSh.
- 2.Operatori Ekonomik “BUNA” SHPK me NUIS J61826501C, me ofertë ekonomike 1 432 500 (një milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSh dhe 1 719 000 (një milion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë me TVSh.
- 3.Operatori Ekonomik “EDUART XHIXHA” pf me NUIS L54424205B, me ofertë ekonomike 1 610 000 (një milion e gjashtëqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSh dhe 1 932 000 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë me TVSh.
- 4.Operatori Ekonomik “Erald” sh.p.k me NUIS J74517205P, me ofertë ekonomike 1 377 000 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSh dhe 1 652 400 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë me TVSh.
- 5.Operatori Ekonomik “ERZENI/SH” sh.p.k me NUIS J66902027T, me ofertë ekonomike 1 383 000 (një milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë pa TVSh dhe 1 659 600 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë me TVSh.
- 6.Operatori Ekonomik “SHAGA” shpk me NUIS J96822229J, me ofertë ekonomike 1 915 000 (një milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSh dhe 2 298 000 (dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë) lekë me TVSh.
- 7.Operatori Ekonomik “Urban Furniture” shpk me NUIS L74605203N, me ofertë ekonomike 1 694 500 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind) lekë pa TVSh dhe 2 033 400 (dy milion e tridhjetë e tre mijë e katërqind) lekë me TVSh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “Erald” sh.p.k me NUIS J74517205P, me ofertë ekonomike 1 377 000 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSh dhe 1 652 400 (një milion e

gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë me TVSh, , nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe për këtë arsye nuk kualifikohet pasi :

a).Oferta e tij ekonomike rezulton të jete anomalisht e ulët, dhe në zbatim të Nenit 27 të ligjit Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “për prokurimin publik” i cili shprehet se: Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”.

2. Operatori Ekonomik “ERZENI/SH” sh.p.k me NUIS J66902027T, me ofertë ekonomike 1 383 000 (një milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë pa TVSh dhe 1 659 600 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë me TVSh, nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe për këtë arsye nuk kualifikohet, pasi:

a.nuk përmbush kriterin e shtojcës 8, Formulari përmbledhës i Vetëdeklarimit konkretisht “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A: Deklarata për përmbushjen e Krieteve të Përgjithshme të Kualifikimit”, pasi nuk i ka plotësuar në mënyrë të saktë zërat e kërkuara në këtë formular, duke mos përcaktuar se cilat dokumente duhen për të përmbushur kriterin, në cilën adresë elektronike mund të tërhiqet dokumenti, dhe cili institucion i lëshon dokumentet përkatëse.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “BUNA” SHPK me NUIS J61826501C me adresë Lagjja 14, "Bajram Tusha", Shkozet, Durrës, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej 1 432 500 (një milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSh dhe 1 719 000 (një milion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë me TVSh, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS

Drejtuar: “MUCA” SHPK, me NUIS K01421002H, me adresë Autostrada Tiranë-Durres, km.13, fshati Picar, Vorë,Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

“Blerje rafte për bibliotekën, zyra, laboratore dhe blerje perde për godinën e Fakultetit të Edukimit”, me Nr. REF-16328-08-15-2024, me fond limit 4,498,989 (katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, afati i lëvrimit do të jetë 15 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Loti 2: “Blerje perde për godinën e Fakultetit të Edukimit”. me Nr. REF-16333-08-15-2024 me fond limit 2,575,495 (dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) leke pa TVSH, afati i lëvrimit do të jetë 15 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “BUNA” shpk, me NUIS J61826501C, me ofertë ekonomike 1 874 250 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 2 249 100 (dy milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e njëqind) lekë me TVSH.
2. Operatori ekonomik “MUCA” shpk, me NUIS K01421002H, me ofertë ekonomike 1 931 625 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH dhe 2 317 950 (dy milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë me TVSH.
3. Operatori ekonomik “NETA SHYTI” p.f, me NUIS K51521038P, me ofertë ekonomike 1 790 100 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind) lekë pa TVSH dhe 2 148 120 (dy milion e njëqind e dyzet e tetë mijë e njëqind e njëzet) lekë me TVSH.
4. Operatori ekonomik “SHAGA.” shpk, me NUIS J96822229J, me ofertë ekonomike 1 652 400 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë pa TVSH dhe 1 982 880 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë)lekë me TVSH.
5. Operatori ekonomik “T&J Construction” shpk, me NUIS M29718101T, me ofertë ekonomike 2 089 980 (dy milion e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 2 507 976 (dy milion e pesëqind e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “BUNA” shpk, me NUIS J61826501C, me ofertë ekonomike 1 874 250 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 2 249 100 (dy milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e njëqind) lekë me TVSH, nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe për këtë arsye nuk kualifikohet pasi :
 - a. nuk përmbush pikën 2.3.1 të aftësive teknike dhe profesionale ku përcaktohet se:
 - 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20

% të vlerës së përllogaritur të kontratës, (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratë dhe fatura tatimore për furnizime të mëparshme të ngjashme për perde roller, por nuk plotëson 20% e vlerës së përllogaritur të shumatores së fondit limit të loteve, duke qënë se ka ofertuar për të dy lotet e procedurës së prokurimit.

b. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.2 të aftësive teknike dhe profesionale ku përcaktohet se:

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose Autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt i këtij prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vertetoj kete duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marrëveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar, si dhe cdo dokumentacion tjetër ligjor të vlefshëm që provon lidhjen e distributorit të autorizuar me prodhuesin". (Dokumentacioni duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i njëjësuar me origjinalin.)

Operatori ekonomik "BUNA" shpk nuk ka paraqitur letër/akt marrëveshje angazhimi midis prodhuesit dhe distributorit për mallrat objekt i këtij prokurimi.

2. Operatori ekonomik "NETA SHYTI" p.f, me NUIS K51521038P, me ofertë ekonomike 1 790 100 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind) lekë pa TVSH dhe 2 148 120 (dy milion e njëqind e dyzet e tetë mijë e njëqind e njëzet) lekë me TVSH, nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe për këtë arsye nuk kualifikohet pasi :
 - a. Oferta e tij ekonomike rezulton të jete anomalisht e ulët, dhe në zbatim të Nenit 27 të ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "për prokurimin publik" i cili shprehet se: Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët."
3. Operatori ekonomik "SHAGA." shpk, me NUIS J96822229J, me ofertë ekonomike 1 652 400 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë pa TVSH dhe 1 982 880 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë)lekë me TVSH nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe për këtë arsye nuk kualifikohet pasi :
 - a. nuk përmbush pikën 2.3.1 të aftësive teknike dhe profesionale ku përcaktohet se:
 - 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).

Operatori ekonomik ka paraqitur kontratë dhe fatura tatimore për furnizime të mëparshme, por nuk ka paraqitur dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme për perde roller, referuar procedurës objekt prokurimi.

b. nuk përmbush pikën 2.3.3. të aftësive teknike dhe profesionale ku përcaktohet se :

2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njëjësuar me origjinalin. Në katalog, të markohet në menyrë të qartë dhe të dallueshme malli që ofertohe sipas modelit të deklaruar dhe të shenohen (me nje tjetër ngjyre) specifikimet përkatëse sipas të dhënave qe kerkohen në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të mallit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në

dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog për mallrat e procedurës objekt prokurimi, ku të përcaktohen specifikimet përkatëse sipas të dhënave që kërkohen në DST, si dhe karakteristikat teknike të mallit dhe në këtë mënyrë AK nuk gjykon nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

c. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të aftësive teknike dhe profesione ku përcaktohet se :

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikaten sipas standartit Oeko Tex ® 100 te prodhuesit , për të vertetuar që produkti nuk është i dëmshëm për mjedisin dhe shëndetin referuar desitnacionit të përdorimit të mallrave objekt prokurimi.

Operatori ekonomik ka paraqitur certifikatë sipas standartit Oeko Tex, por me vlefshmëri deri në datën 30.11.2022, e për këtë arsye nuk vërtetohet nga ana e Operatorit Ekonomik se produkti nuk është i dëmshëm për mjedisin.

4. Operatori ekonomik “T&J Construction” shpk, me NUIS M29718101T, me ofertë ekonomike 2 089 980 (dy milion e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH dhe 2 507 976 (dy milion e pesëqind e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH, nuk është në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe për këtë arsye nuk kualifikohet, pasi:

a. nuk përmbush pikën 2.3.1 të aftësive teknike dhe profesionale ku përcaktohet se:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).

Operatori ekonomik ka fatura tatimore për furnizime të mëparshme, por nuk ka paraqitur dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme për perde roller, referuar procedurës objekt prokurimi.

b. nuk përmbush pikën 2.3.3. të aftësive teknike dhe profesionale ku përcaktohet se :

2.3.3. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin. Në katalog, të markohet në menyrë të qartë dhe të dallueshme malli që ofertohe sipas modelit të deklaruar dhe të shenohen (me nje tjeter ngjyre) specifikimet përkatëse sipas të dhënave qe kerkohen në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të mallit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre.

Operatori ekonomik ka paraqitur katalog për mallrat e procedurës objekt prokurimi, por nuk ka përcaktuar specifikimet përkatëse sipas të dhënave që kërkohen në DST, si dhe karakteristikat teknike të mallit dhe në këtë mënyrë AK nuk gjykon nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

c. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të aftësive teknike dhe profesione ku përcaktohet se :

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikaten sipas standartit Oeko Tex ® 100 te prodhuesit , për të vertetuar që produkti nuk është i dëmshëm për mjedisin dhe shëndetin referuar desitnacionit të përdorimit të mallrave objekt prokurimi.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatë sipas standartit Oeko Tex, e për këtë arsye nuk vërtetohet nga ana e Operatorit Ekonomik se produkti nuk është i dëmshëm për mjedisin.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “MUCA” shpk, me NUIS K01421002H, me adresë Autostrada Tiranë-Durrës, km.13, fshati Picar, Vorë,Tiranë ,se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej 1 931 625 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH dhe 2 317 950 (dy milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë me TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE NËNË TEREZA TIRANË

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Farma Net Albania” Sh.p.k., me NIPT: K92201080V, me adresë: Tirane, Njesia Bashkiake nr 8, Rruga Siri Kodra, ndertese 2-kateshe , me zone kadastrale 8340 dhe nr pasurie 8/660, kati 1.

* * *

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e Hapur, e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-13497-07-18-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Furnizim vendosje pajisje për monitorimin e pacientëve gjatë anestezisë dhe sedacionit”, me fond limit: 9,980,000 (nente milion e nenteqind e tetdhjete mije) lekë pa TVSH dhe 11,976,000 (njembedhjete milion e enteqind e shtatedhjete e gjashte mije) lekë me TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “O.E.S DISTRIMED” Sh.p.k.

K31520054N

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontrates (nëse është e zbatueshme: me vlere prej 7,485,000.00 (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

2. “FARMA NET ALBANIA” Sh.p.k. K92201080V

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontrates (nëse është e zbatueshme: me vlere prej 9.882.000,00 (nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “O.E.S DISTRIMED” Sh.p.k. K31520054N

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme: me vlere prej 7,485,000.00 (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

Arsyeja: Operatori ekonomik nuk përmbush të gjitha specifikimet teknike të Shtojcës 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të DST dhe nuk plotëson kërkesat e DST në shtojcën 7, konkretisht nuk plotësohet pika 2.1 gërma “c”, pika 2.3 nënpikat 5, 8 dhe 9.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

1. “FARMA NET ALBANIA” Sh.p.k. K92201080V

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme: me vlere prej 9.882.000,00 (nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH;

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “FARMA NET ALBANIA” Sh.p.k., me NIPT: K92201080V, me adresë Tirane, Njesia Bashkiake nr 8, Rruga Siri Kodra, ndertese 2-kateshe , me zone kadastrale 8340 dhe nr pasurie 8/660, kati 1., se oferta e paraqitur me vlerë totale 9.882.000,00 (nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Drejtuar: SHAGA. SH.P.K

Adresa: Tirane Rruga Hamdi Pepa, ish Parku i Industrise.

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë me të gjitha kushtet e përcaktuara.

Number of procedure/lot reference:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti 3: “Mobilje dhe pajisje për përdorim të vecantë” me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër në vlerën 1,626,000 (një milion e gjashtëqind e njëzetë gjashtë mijë) lekë pa TVSH ose 16,200 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind) Euro pa TVSH dhe me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj.

Numer reference LOTI 3: REF-12218-07-04-2024

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. SHAGA. SH.P.K	NIPT J96822229J
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

Vlera: 1 624 000 (Një milion e gjashtëqind e njëzet e katër mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm: Nuk ka operatorë të skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

SHAGA. SH.P.K	NIPT J96822229J
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

Vlera: 1 624 000 (Një milion e gjashtëqind e njëzet e katër mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë)

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Drejtuar: SHAGA. SH.P.K

Adresa: Tirane Rruga Hamdi Pepa, ish Parku i Industrise.

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë me të gjitha kushtet e përcaktuara.

Number of procedure/lot reference:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti 2: “Mobilje dhe pajisje prej metali për përdorime në ambiente të ndryshme” me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër në vlerën 10,123,700 (dhjetë milion e njëqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH ose 100,864(njëqind mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) Euro pa TVSH dhe me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj.

Numer reference LOTI 2: REF-12216-07-04-2024

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. SHAGA. SH.P.K
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT J96822229J
numri i NIPT-it

Vlera: 10 121 590 (Dhjetë milionë e njëqind e njëzet e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH

(me numra dhe fjalë)

2. BUNA SH.P.K
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT J61826501C
numri i NIPT-it

Vlera: 0 (zero) lekë pa TVSH
Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. BUNA SH.P.K
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT J61826501C
numri i NIPT-it

Arsyeja e skualifikimit:

Operatori ekonomik “BUNA” shpk me NUIS J61826501C, skualifikohet, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në plotësim të kërkesave për pualifikim si dhe nuk ka paraqitur as ofertë ekonomike. Për sa më sipër OE “BUNA”, s’kualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

SHAGA. SH.P.K
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT J96822229J
numri i NIPT-it

Vlera: 10 121 590 (Dhjetë milionë e njëqind e njëzet e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH
(me numra dhe fjalë)

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

OPERATORI I BLERJEVE TË PËROENDRUARA

OPERATORIT EKONOMIK “ATLANTIK 3” SHPK

Adresa: AutostradaTiranë- Durrës, km.10N Vorë, Shqipëri

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar (marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues) Numri i procedurës/referenca e Lotit: me numër reference Loti 2: REF-12066-07-03-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti II. "Blerje Hipoklorit Natriumi për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", me fond limit të Marrëveshjes Kuadër: 1,820,000 (një milion e tetëqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH, me nr reference të procedurës Loti 2: REF-12066-07-03-2024 për nevoja të Autoritetit Kontraktore përfituese Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza".

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Deri në 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Lëvrimi/dorëzimi i mallit për lotin e dytë do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës/kontratave brenda marrëveshjes kuader nga autoritetet kontraktore përfituese.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.35 datë 08.07.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

1. Operatori ekonomik "2 AT" sh.p.k me NUIS K14019001H dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,760,000 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik "Albania Distribution Chemicals" sh.p.k, me NUIS M11815028I dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,660,000 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik "ATLANTIK 3" sh.p.k, me NUIS K22218003V dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,365,000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik "BESIM KAMBERI" p.f, me NUIS L42103023G dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,520,000 (një milion e pesëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH
5. Operatori ekonomik "Biotek" sh.p.k, me NUIS L82203011N dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.
6. Operatori ekonomik "EGIAN MED" sh.p.k, me NUIS L71715003C dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,689,000 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH
7. Operatori ekonomik "MURATI D" sh.p.k, me NUIS K42003004T dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,480,000 (një milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm: Nuk ka operatorë të skualifikuar Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1. "ATLANTIK 3"
Emri i plotë i shoqërisë

NUIS K22218003V
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 1,365,000 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

AUTORITETI PER INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT **TË SHTETIT**

Drejtuar: COMMUNICATION PROGRES, SHPK
NIPT: K01625001C

ADRESA: Rr. “Stanislav Zuber” (Sheshi Shqiponja), Njësia adm. nr. 7, Nd. 2, H. 19, 1023, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur – e thjeshtuar – Prokurim Elektronik- Mallra”, me objekt: “Blerje dhe instalim të sistemeve dhe pajisjeve audiovizuale”, për nevojat e Autoritetit.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF: 15932-08-12-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Afatet e lëvrimit: 50 ditë nga nënshkrimi i kontratës

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

Nr.	Operatori Ekonomik	NIPT:	Çmimi total i ofertës në lekë pa TVSH	Çmimi total i ofertës në lekë me TVSH
1.	COMMUNICATION PROGRES SHPK	K01625001C	5.063.000 (pesë milion e gjashtëdhjetë e tre mijë)	6.075.600 (gjashtë milion e shtatëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind) lekë

2	FREDI ELECTRONIC SH.P.K	K91803020F	5.587.100 (Pesë milion e pesëqind e tetëdhjete e shtatë mijë e njëqind Leke)	6,704,520 (Gjashtë milion e shtatëqind e katërmijë e pesëqind e njëzete Leke)
3	OPTIMA COMMUNICATION shpk	K71903025A	Nuk ka paraqitur ofertë	Nuk ka paraqitur ofertë
4	BOE:PROSOUND SH.P.K FASTECH SHPK	K623200120 J81609010U	5,463,000 leke [Pese milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mije leke];	6,555,600 leke [Gjashte milion e pesëqind e pesëdhjetë e pese mije e gjashtëqind leke];
5	QUANTX IT SOLUTIONS SHPK	M31904013D	5,787,500 [pesë milion e shtatëqind e tetëdhjete e shtate mije e pesëqind] lek;	6,945,000 [gjashte milion e nëntëqind e dyzet e pese mije] lek;

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.	OPTIMA COMMUNICATION shpk	Nuk ka paraqitur ofertë	Nuk ka paraqitur ofertë
2.	BOE: PROSOUND SH.P.K me NIPT: K623200120 FASTECH SHPK me NIPT: J81609010U	5,463,000 leke [Pese milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mije leke];	6,555,600 leke [Gjashte milion e pesëqind e pesëdhjetë e pese mije e gjashtëqind leke];
3.	QuantX IT Solutions, me NIPT: M31904013D	5,787,500 [pesë milion e shtatëqind e tetëdhjete e shtate mije e pesëqind] lek;	6,945,000 [gjashte milion e nëntëqind e dyzet e pese mije] lek;

Arsyet e skuafilikimit: Dokumentet e paraqitura nga OE e sipërcituar NUK PLOTËSOJNË kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit (shih argumentimin tek vlerësimi dokumentacionit për këtë OE).

Konkretisht:

1. OPERATORI EKONOMIK “OPTIMA COMMUNICATION shpk”, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. KVO, vlerëson se dokumentet e OE “OPTIMA COMMUNICATION shpk”, nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST. Operatori ekonomik nuk ka plotësuar asnjë nga kriteret e vendosura në DST.
2. BO “PROSOUND SH.P.K DHE FASTECH SHPK”, nuk plotëson plotësisht kriterin e DST 2.3.5 dokumentet e tenderit. OE “PROSOUND SH.P.K, për pajisjet e markës SYNQ nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi/distributori, po ashtu, për pajisjet e markës SHURE nuk ka

paraqitur autorizim nga prodhuesi/distributori; “PROSOUND SH.P.K ka paraqitur autorizim nga distributori “Omikron Electronics” për prodhimet e GONSIN, por nuk plotëson kriterin për vërtetimin e lidhjes midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

3. OE “QUANTX IT SOLUTIONS” sh.p.k, lidhur me shtojca 6, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, zëri 1.15, “Rack standard 19 inch për instalimin e pajisjeve qendrore”, nuk ka paraqitur katalogun sipas përcaktimeve të kërkesave në DST, kriteri 2.3.4.

OE “QUANTX IT SOLUTIONS” sh.p.k, lidhur me shtojca 6, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, zëri 2.2 Thin Client (Set), nuk ka paraqitur katalogun për monitorin, sipas përcaktimeve të kërkesave në DST, kriteri 2.3.4, konkretisht:

MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Thin Client
Madhësia “Size”:	≥ 23"
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 @ 60 Hz
Raporti i Kontrastit “Constrast Ratio Static”:	1000:01:00
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
“Display Port”:	(1) DP dhe (1) HDMI
Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	Min. 220 V AC, 50 Hz
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [COMMUNICATION PROGRES, SHPK, NIPT: K01625001C, Adresa: Rr. “Stanislav Zuber” (Sheshi Shqiponja), Njësia adm. nr. 7, Nd. 2, H. 19, 1023, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5.063.000 lekë pa tvsh (pesë milion e gjashtëdhjetë e tre mijë) totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

KUVENDI

Nga: Kuvendi
me adresë :Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë.

Drejtuar : Operatorit ekonomik: “IMAGE & COMMUNICATIONS DEVELOPMENT” me NIPT L01511027P dhe me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Donika Kastrioti", Pallati Teknoprojekt, Apartamentet 5/1 dhe 5/6, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur / mallra

Përshkrimi i shkurtër i kontratës “BLERJE E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KONSULTIMIT PUBLIK (OSHC, OJF, PALË INTERESI DHE LOBISTË) DHE SHËRBIM MIRËMBAJTJE 48 MUAJ”.

Numri i procedurës / referenca : REF-10813-06-24-2024

Kohëzgjatja e kontrates : Në total kohëzgjatja e kontratës është 52 muaj e strukturuar si më poshtë:
4 muaj për A) "Aplikacion për ndërveprim me publikun dhe grupet e interesit".
48 muaj për B) " Shërbim mirëmbajtje për 48 muaj".

Sasitë: Sipas tabelës se shtojces 5 të specifikimeve teknike .

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “3i-Solutions”, me NUIS/NIPT L52305007S, me vlerë totale të ofertës 8.705.600 (tetë milionë e shtatëqind e pesë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, të ndarë në dy komponentë kryesorë:

A) Vlera e ofertuar e investimit 4.850.100 (katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind) lekë pa TVSH dhe

B) Vlera e ofertuar e shërbimit 3.855.500 (tre milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “IMAGE & COMMUNICATIONS DEVELOPMENT”, me NUIS/NIPT L01511027P, me vlerë totale të ofertës 9.350.000 (nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, të ndarë në dy komponentë kryesorë:

A) Vlera e ofertuar e investimit 5.750.000 (pesë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH dhe vlerë të shërbimit.

B) Vlera e ofertuar e shërbimit 3.600.000 (tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Infosoft Systems”, me NUIS/NIPT J61820021C pa ofertë ekonomike.

4. Operatori ekonomik “INSTANT.al” sh.p.k, me NUIS/NIPT L81506043D, me vlerë totale të ofertës 8.994.800 (tetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, të ndarë në dy komponentë kryesorë:

A) Vlera e ofertuar e investimit 4.674.800 (katër milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

B) Vlera e ofertuar e shërbimit 4.320.000 (katër milionë e treqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH.

* * *

OPERATORË EKONOMIKË TË SKUALIFIKUAR:

I. Operatori ekonomik “3i-Solutions”, me NUIS/NIPT L52305007S, me vlerë totale të ofertës 8.705.600 (tetë milionë e shtatëqind e pesë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Për arsyet e mëposhtme:

Gjatë shqyrtimit, komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi se ky operator ekonomik nuk ka paraqitur të gjithë dokumentat për përmbushjen e kapacitetit teknik të përcaktuar në kriteret e DST-ve, pika 2.3.3.

1. OE-ja nuk plotëson kriteret teknike të certifikimit të stafit si vijon:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim rrjeti CCNA/CCNP, AWC Certified, Azure Network Engineer Associate, Google Cloud Network Engineer ose ekuivalente.

Nga ana e OE-së për të përmbushur kriterin më lart në SPE janë ngarkuar dokumentet e mëposhtme:

- U paraqit dokumenti “License” i nënshkruar nga Infosecurity sh.pk në emër të A. I. Sh.
- U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating në emër të P.B për Cloud and AWS Skills Test.

Për këtë kriter KVO-ja argumenton sa më poshtë vijon:

Së pari, për dokumentin “License” i nënshkruar nga Infosecurity sh.pk në emër të A. I. Sh, KVO-ja nuk mundi të kryejë verifikimin e vlefshmërisë së tij në adresën e shënuar në këtë dokument për të vërtetuar autenticitetin e tij në <https://infosecurity.al/verifycertificate>, me nr. e verifikimit M018170281123, pasi kjo faqe të ridrejton në një link i cili nuk ekziston.

Certifikatat e kategorisë CCNA/CCNP etj, lëshohen nga zhvilluesi i teknologjisë së routing dhe switching që është Cisco për rastin konkret, nënshkruhen nga CEO i Cisco-s dhe autenciteti i tyre verifikohet në platformën/adresën zyrtare të Cisco-s: <https://www.cisco.com/go/verifycertificate>.

KVO-ja kreu këtë verifikim në faqen zyrtare të Cisco-s dhe kredenciali M018170281123 nuk validohet në platformën e Cisco-s e si i tillë nuk u pranua nga KVO-ja si dokument i vlefshëm.

Së dyti, për dokumentin e lëshuar nga platforma ExpertRating në emër të P.B për Cloud and AWS Skills Test, KVO-ja argumenton se certifikimet përkatëse edhe në këtë rast lëshohen nga zhvilluesi i teknologjisë cloud, në rastin konkret Amazon Web Services.

Nivelet e certifikimit për këtë teknologji fillojnë nga niveli Foundational (AWS Certified Cloud Practitioner) deri në nivelin Professional (AWS Certified Solutions Architect/AWS Certified DevOps Engineer), si dhe certifikimet e nivelit Specialty, të cilat mbulojnë Data Analytics, Networking, Security etj. Në çdo rast, certifikimet për AWS lëshohen nga zhvilluesi që është Amazon Web Services.

KVO-ja argumenton se, platforma ExpertRating.com është një platformë mësimi dhe kursesh dhe dokumentat e lëshuara nga kjo platformë nuk janë certifikime të vlefshme dhe as ekuivalente me certifikatat që lëshohen nga prodhuesi/zhvilluesi i teknologjisë, në rastin konkret AWS.

Sipas argumenteve më lart, KVO vlerëson se dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating në emër të P.B për Cloud and AWS Skills Test nuk konsiderohet si dokument i vlefshëm i kategorisë certifikim për teknologjitë cloud të AWS e për pasojë nuk u pranua nga KVO-ja si dokument i vlefshëm.

2. OE-ja nuk plotëson kriteret teknike të certifikimit të stafit si vijon:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim serverash Windows/linux/cloud CompTIA Server+, Red Hat Certified System Administrator, RHCE, ose ekuivalente.

Nga ana e OE-së për të përmbushur kriterin më lart në SPE janë ngarkuar dokumentet e mëposhtme:

- U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating në emër të A. Sh.
- U paraqit dokumenti i lëshuar nga website alison.com lëshuar për E.S (free online Windows server training course) për Windows Server Administration,
- Certifikatë lëshuar nga alison.com për A. Sh për Computer Network Security –Revised.

Së pari, për këtë kriter, njëloj si më lart KVO-ja argumenton se certifikatat e kategorisë Server Administration, RHCE, RHCA etj, vlerësojnë njohuritë dhe lëshohen nga zhvilluesi i teknologjisë sic është Microsoft, RedHat inc, CompTia për rastet konkrete, nënshkruhen nga CEO e kompanive përkatëse dhe autenciteti i tyre verifikohet në adresat zyrtare të këtyre zhvilluesve të teknologjisë.

KVO-ja argumenton se, platforma ExpertRating.com është një platformë mësimi dhe kursesh dhe dokumentat e lëshuara nga kjo platformë në emër të A. Sh për Linux Test nuk janë certifikime të vlefshme dhe as ekuivalente me certifikatat që lëshohen nga prodhuesi/zhvilluesi i teknologjisë, në rastin konkret Redhat. Ky lloj dokumenti për këto arsye nuk u pranua nga KVO-ja si dokument i vlefshëm apo ekuivalent i certifikimeve për Linux.

Së dyti, për dokumentin e lëshuar në emër të E.S, KVO-ja vëren se ky është dokument i përfundimit të një kursi online falas lëshuar në platformën/website-in alison.com dhe nuk është certifikim i vlefshëm apo ekuivalent për teknologjitë e Microsoft-it, të cilat kanë kategori certifikatash të lëshuara nga prodhuesi i teknologjisë Microsoft, të nënshkruara nga CEO i kompanisë dhe janë të verifikueshme online përmes kredencialit apo transkriptit të Microsoft-it.

Ky lloj dokumenti për këto arsye nuk u pranua nga KVO-ja si dokument i vlefshëm apo ekuivalent i certifikimeve për menaxhim serverash.

Së treti, për dokumentin e lëshuar në emër të A.Sh, KVO-ja vëren se ky është dokument i përfundimit të një kursi online lëshuar në platformën/website-in alison.com dhe nuk është certifikim i vlefshëm apo ekuivalent për “computer security-revised”, të cilat kanë kategori certifikatash të lëshuara nga prodhuesi/zhvilluesi i teknologjisë së sigurisë që mund të jenë kryesisht kompanitë që zhvillojnë platforma të sigurisë XDR/EDR/SOAR, firewalle, Cisco, Microsoft, Amazon web Services, COMPTIA, BroadCom dhe vendorë të ndryshëm produktesh sigurie hardware apo software.

Në çdo rast certifikimet duhet të jenë të nënshkruara nga CEO i kompanisë dhe të verifikueshme online përmes kredencialit apo transkriptit.

Ky lloj dokumenti për këto arsye nuk u pranua nga KVO-ja si dokument i vlefshëm apo ekuivalent i certifikimeve për network security.

3. OE-ja nuk plotëson kriteret teknike të certifikimit të stafit si vijon:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të dhënash në databaza relacionale nga Microsoft SQL Server, Oracle Database 12c R2 Certified Associate, CompTIA DataSys+, CompTIA Data+, Azure DBA, ose ekuivalente.

Nga ana e OE-së për plotësimin e këtij kriteri në SPE janë ngarkuar si vijon dokumentet:

- U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma e mësimi dhe kurseve Udemy për F. M për Oracle SOA 12c 2024.
- U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating në emër të M. H për SQL Server 2012 Skills test.

Së pari, për dokumentin e lëshuar në emër të F.M, KVO-ja vëren se ky është dokument i përfundimit të një kursi online lëshuar në platformen Udemy dhe nuk është certifikim i vlefshëm apo ekuivalent për menaxhim të dhënash në databaza relacionale dhe as nuk tregon kompetencë të për menaxhim databazash relacionale.

Së dyti, argumentet e njëjta vlejné edhe për dokumentin e lëshuar në ExpertRating në emër të M. H. Këto kategori certifikatash duhet të jenë të lëshuara nga zhvilluesi i bazave të dhënave që mund të jenë kryesisht kompanitë që zhvillojnë platforma dhe vendorë të ndryshëm produkteve për database si Microsoft, Oracle, Amazon etj.

Në çdo rast certifikimet duhet të jenë të nënshkruara nga CEO i kompanisë dhe të verifikueshme online përmes kredencialit apo transkriptit.

Ky lloj dokumenti për këto arsye nuk u pranua nga KVO-ja si dokument i vlefshëm apo ekuivalent i certifikimeve për databaza relacionale.

4. OE-ja nuk plotëson kriteret teknike të certifikimit të stafit si vijon:

- Të paktën 3 (tre) persona të certifikuar për programim web html 5, Microsoft 70-480, NCSA CP-450 HTML5 ose ekuivalente.

Nga ana e OE-së për plotësimin e këtij kriteri në SPE janë ngarkuar dokumentet e mëposhtme:

- ❖ U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma e mësimi dhe kurseve Udemy për T.G për HTML5, CSS3 & Javascript Course: Complete Guide.
- ❖ U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating në emër të D.P.
- ❖ U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating në emër të Q. Ll.

Së pari, për dokumentin e lëshuar në emër të T.G, KVO-ja vëren se ky është dokument i përfundimit të një kursi online lëshuar në platformen Udemy dhe nuk është certifikim i vlefshëm apo ekuivalent për programim dhe as nuk tregon kompetencë programimi.

Certifikatat dhe certifikimet e kësaj kategorie nuk lëshohen nga platforma mësimi online por kryesisht nga kompanitë e zhvillimit të software-eve, kompanitë e zhvillimit të këtyre teknologjive si Microsoft, AWS, Oracle etj.

Së dyti, argumentet e njëjta vlejné edhe për dokumentin e lëshuar në ExpertRating në emër të D. P dhe Q. Ll. Këto janë teste në platformën ExpertRating të cilat nuk tregojnë kapacitete dhe njohuri të një certifikimi të mirëfilltë.

Në çdo rast certifikimet duhet të jenë të nënshkruara nga CEO i kompanisë dhe të verifikueshme online përmes kredencialit apo transkriptit.

Këto lloj dokumentesh për këto arsye nuk u pranuan nga KVO-ja si dokumente të vlefshëm apo ekuivalentë të certifikimeve për programim web html 5, Microsoft 70-480, NCSA CP-450 HTML5.

5. OE-ja nuk plotëson kriteret teknike të certifikimit të stafit si vijon:

- Të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar për zhvillim aplikacionesh Certified Scrum Master, IBM Certified APP Developer, Oracle Certified Associate, Microsoft Certified

Solutions Developer ose ekuivalente.

Nga ana e OE-së për plotësimin e këtij kriteri në SPE janë ngarkuar si dokumentet e mëposhtme:

- U paraqit Certifikatë njohje nga Oracle University në emër të P.B.
- U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating për K.I Advanced java Certification skills skills assessment.
- U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating për H.M Java8 Programming Skills Test.
- U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating për M.H ASP.net Web API Skills Test.
- U paraqit dokumenti i lëshuar nga platforma ExpertRating për A. Sh C#7 Skills Test.

Së pari, duke iu referuar edhe argumenteve më lart KVO-ja vlerëson se, certifikimet e paraqitura nuk janë të vlefshme dhe as ekuivalente me certifikimet e kërkuara në DST për zhvillim të aplikacioneve.

Certifikatat dhe certifikimet e kësaj kategorie nuk lëshohen nga platforma mësimi online por nga kompanitë e prodhimit/zhvillimit të software-eve, kompanitë e programimit etj.

Në cdo rast certifikimet duhet të jenë të nënshkruara nga CEO i kompanisë dhe të verifikueshme online përmes kredencialit apo transkriptit.

Këto lloj dokumentesh përveç Oracle Certified Associate për P. B, nuk u pranuan nga KVO-ja si dokument i vlefshëm apo ekuivalent i certifikimeve për zhvillim aplikacionesh.

Në përfundim, pas analizës së kryer të dokumentacionit lidhur me certifikimet teknike të stafit sipas pikës 2.3.3 të shtojcës 7 të DST-ve, KVO- ja konstaton se, në tetë punonjës të prezantuar nga ana e OE-së vetëm 2 prej tyre zotërojnë certifikimet përkatëse të standartizuara dhe të lëshuara nga vendorët e teknologjisë të njohur ndërkombëtarisht dhe të verifikueshme. Për këto arsye, kapaciteti teknik i kompanisë vlerësohet i papërmbushur.

II. Operatori ekonomik “Infosoft Systems”, me NUIS/NIPT J61820021C pa ofertë ekonomike.

Për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bazuar në nenin 82, të Kreut 2, të VKM nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, vendosi të mos kualifikojë si të vlefshme në këtë procedurë prokurimi, ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Systems”, me NUIS/NIPT J61820021C, për arsye të mosparaqitjes të asnjë dokumenti të vlefshëm të kërkuar në DST.

III. Operatori ekonomik “INSTANT.al” sh.p.k, me NUIS/NIPT L81506043D, me vlerë totale të ofertës 8.994.800 (tetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

Për arsyet e mëposhtme:

AK-ja zbatoi Vendimin nr.1083/2024 të KPP-së, por gjatë procesit të kontrollit fizik të dokumentacionit të ofertës, KVO-ja konstatoi që ky i fundit nuk rezultoi konform kërkesave të AK-së si më poshtë:

Më konkretisht tek Kapaciteti teknik :

1. Nuk ploteson kriterin:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të dhënash në databaza relacionale nga Microsoft SQL Server, Oracle Database 12c R2 Certified Associate, CompTIA DataSys+, CompTIA Data+, Azure DBA, ose ekuivalente.

Në nenin 4 “Përkufizime”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, parashikohet se: “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlershme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.

Ky term në rastin konkret të kontratës objekt prokurimi nënkupton barazvlershmërinë e dokumenteve të kategorizuara si certifikata, të cilat vërtetojnë zotërim të njohurive/kapaciteteve teknike të barasvlershme. Pra, nëse kërkohet një certifikim Oracle Database 12c R2 Certified Associate nga zhvilluesi i teknologjisë Oracle, e cila fokusohet në ekuivalenca e kësaj certifikate mund të jetë Azure DBA, e cila lëshohet nga Microsoft. Por në çdo rast, enti dhe autoriteti që lëshon certifikimet është vetë vendori/zhvilluesi i teknologjisë ose vendorë të tjerë të akredituar nga zhvilluesi i teknologjisë.

KVO verifikoi, nëse karakteristikat janë të barasvlershme për dokumentet e vëna në dispozicion nga OE në krahasim me dokumentet e kërkuara nga AK në DST. U verifikua site zyrtar i Oracle ky janë modulet e mësimi për Oracle Database 12c R2 Certified Associate (<https://learn.oracle.com/ols/learning-path/oracle-database-12c-administrator-certified-associate/56098/56099>) dhe u krahasuan me atë çka ofron platforma coursera (<https://www.coursera.org/specializations/oracle-sql-databases#courses>) për dokumentin i cili është vënë në dispozicion nga OE.

Nga analiza e temave mësimore, që reflektojnë brendinë e materies, në këtë tabelë për të dy rastet, KVO argumenton se tematikat e njohurive nuk janë të barasvlershme, pasi kolona në të majtë ka elementë shumë sipërfaqësorë të njohurive të kërkuara dhe për më tepër dokumenti lëshohet pa verifikim identiteti, pa mbikëqyrje dhe pa provim e testim të njohurive.

Ndërsa, po ti referohemi kolonës në të djathtë, vihet re një tematikë mjaft më e gjerë dhe shumë më e thelluar teknike. Për më tepër, në fund të kursit duhet të kalosh provimin me mbikëqyrje dhe verifikim të identitetit, për të marrë certifikatën/për tu certifikuar për njohuritë e fituara.

KVO kreu verifikimet për marrjen e një dokumenti të tillë; Vërehet qartë që çdo gjë është thjesht e realizueshme, pa pagesë dhe kryhet në website <https://www.coursera.org/>.

Ndaj, në gjykimin e KVO dokumenti i vënë në dispozicion nga OE “Kursi online Oracle SQL Databases nga platforma Coursera për Granit Gjana” nuk është i barasvlershëm me Oracle Database 12c R2 Certified Associate apo me kërkesat e tjera të pikës “F”, si më lart, për këtë qëllim ku dokument nuk plotëson kushtet për t’u kualifikuar si dokument i barasvlershëm/ekuivalent.

Në rastin e dokumenteve të vëna në dispozicion nga OE dokumentet të cilat pretendohet të jenë certifikime janë lëshuar prej enteve të pa akredituara, të panjohura dhe për më tepër jo të autorizuar nga zhvilluesi i teknologjive. Si mund të konsiderohet një dokument i lëshuar nga Coursera certifikatë për Microsoft ose Oracle kur vetë Microsoft dhe Oracle kanë të zhvilluar platformën e tyre të mësimi dhe provimeve, verifikime të identitetit me kartë ID, provimin dhe kriteret e tyre për lëshimin e certifikatave? Këto lloj dokumentesh siç argumentohet edhe më lart nuk tregojnë njohuri teknike dhe për pasojë pranimi i tyre rrezikon mosrealizimin e kontratës të shpallur nga AK.

Ky arsyetim i KVO për krahasim të barazvlershmërisë vlen për të gjitha dokumentet e vëna në dispozicion nga OE të cilat janë lëshuar nga platforma coursera. Këto dokumente të lëshuara nga coursera nuk janë dokumente të barasvlershme me certifikatat e kërkuara dhe nuk u pranuan nga KVO.

2. NUK ploteson kriterin:

- Të paktën 3 (tre) persona të certifikuar për programim Web html 5, Microsoft 70-480, NCSA CP-450 HTML5 ose ekuivalente.

U paraqitën nga ana e OE dokumentat e lëshuar nga agjencia e marketingut “The digital ADDA” për Emerlinda Gjana, Granit Gjana dhe Ledio Gjyzeli për përfundim të programit të certifikimit për HTML, CSS dhe Javascript për Web Developers.

II. Njëlloj si në kreun I, operatori ekonomik ka paraqitur dokumente të lëshuara nga “The digital ADDA”, e cila është një agjenci marketingu digjitale që lëshon këto lloj dokumentesh falas dhe pa pagesë e pa verifikim të identitetit të një personi (mjafton plotësimi i një google-form me 12-20 pyetje, për më tepër mund të japësh të gjitha përgjigjet gabim dhe sërish dokumenti të vjen në email). Pra nuk është certifikim i cili vërteton zotërim të njohurive dhe as -ti lidhë këto njohuri me personin përmes ID-së.

KVO e verifikoi këtë platformë dhe vërehet që praktikisht mundet që çdokush me një adresë emaili mund të regjistrohet dhe të marrë çdo lloj dokumenti, ose dokumente si këto që janë vënë në

dispozicion nga ky operator ekonomik. Agjencia e marketingut “The digital ADDA” nuk validon asnjë përgjigje të dhënë, si dhe nuk kryen asnjë lloj verifikimi dhe monitorimi. Në terma teknike, pra nuk garanton njohuri të vërteta për atë çka pretendohet. KVO kreu një verifikim në këtë website (<https://thedigitaladda.com/html-css-and-javascript-for-ëeb-developers-certification/>) për marrjen e një certifikate dhe duke dhënë çdo lloj përgjigje (psh selektoi vetëm alternativat a, iu gjeneruan dokumentet te njehta me ato qe ka vene ne dispozicion ky OE.

Sic duket nga ky verifikim, agjencia e marketingut “The digital ADDA” as nuk kryen verifikime të identitetit të një personi, e as nuk ka proces “proctoring”. Pra mund të shkruash çdo lloj emri dhe pasi plotëson rreth 20 pyetje, pavarësisht saktësisë së përgjigjes, shfaqet në dokument që ke mbaruar kursin. Këtu, KVO gjithashtu rithekson edhe faktin, se përfundimi i një kursi nuk është certifikim. Certifikimi është proces i marrjes së pikëve të caktuara të një provimi dhe testimi të njohurive i cili lëshohet nga zhvillues teknologjie dhe zhvillohet në qendra të akredituara ose me mbikëqyrje (proctored) duke verifikuar identitetin e personit i cili e jep provimin.

KVO pas këtij verifikimi dhe argumentimi vlerëson, se asnjë nga dokumentet e vëna nga OE INSTANT.AL, të cilat janë të lëshuara nga kjo agjenci marketingu digjitale nuk janë dokumente për tu marrë parasysh si certifikata. Gjithashtu, KVO i konsideron këto dokumente të pavlefshëm dhe vënie në dispozicion dhe përdorimin tyre nga ana e këtij operatori ekonomik për të fituar kontrata publike që zhvillohen përmes Agjencisë së Prokurimit Publik, shkelje të ligjit.

Ndryshe janë platformat PearsonVue (Proctored exams) p.sh, te të cilat certifikimet janë me vëzhgim me kamera/audio, të kërkohen dokumente të ID, foto krahasuese etj. si dhe provimi është i kontrolluar. Në çdo rast, certifikimet duhet të jenë të nënshkruara nga CEO i kompanisë dhe të verifikueshme online përmes kredencialit apo transcriptit.

Ky lloj dokumenti i vënë në dispozicion nga operatori ekonomik nuk e garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës pasi nuk garanton zotërim të njohurive të nevojshme teknike në menaxhim të databazave relacionale. Natyra e operacioneve që kërkohen për realizimin e kësaj kontrate shërbimi/mirëmbajtje është e tillë që kërkon një ekspertizë të lartë teknike në programim për realizimin e shërbimit dhe fakti që nuk zotërohen certifikata nga Microsoft, AWS, Oracle, MongoDB apo vendorë të tjerë të teknologjisë ekuivalente me këto nuk dëshmojnë kapacitet të këtij OE për realizimin e kontratës.

KVO përsëri i referohet frymës së legjislacionit për prokurimin publik duke cilësuar se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. Në këtë rast ky OE më këto lloj dokumentesh të vëna në dispozicion nuk vërteton se ka kapacitetet teknike për të zbatuar këtë kontratë, për më tepër ky lloj dokumenti konsiderohet i pavlefshëm sipas argumenteve dhe verifikimeve të kryera më lart.

3. Nuk ploteson kriterin:

- Të paktën 5 (pesë) punonjës të certifikuar për zhvillim aplikacionesh Certified Scrum Master, IBM Certified APP Developer, Oracle Certified Associate, Microsoft Certified Solutions Developer ose ekuivalente.

U paraqitën nga ana e OE dokumentat e lëshuar nga Qendra e formimit profesional të ASHP për Xheni Hoxhallari, Ardit Hyka, Emerlinda Gjana, Granit Gjana, Ledio Gjyzeli për përfundim kursi "Ëeb Design dhe Programim", kurs online Oracle SQL Databases nga Coursera për Granit Gjana.

KVO si më lart argumenton se platforma Coursera është një platformë mësimi dhe kursesh të një niveli shumë sipërfaqësor në terma teknike dhe dokumentet nga platforma Coursera për Granit Gjana nuk janë certifikime të vlefshme dhe as ekuivalente me certifikatat që lëshohen nga prodhuesi/zhvilluesi i teknologjisë, në rastin konkret Microsoft, Oracle etj.

Ky lloj dokumenti për këto arsye nuk mund të quhet si dokument i vlefshëm apo ekuivalent i certifikimeve për Microsoft SQL Server, Oracle Database 12c R2 Certified Associate, CompTIA DataSys+, CompTIA Data+, Azure DBA për arsye se nuk vërteton njohuritë teknike, nuk lëshohet nga vendori/zhvilluesi i teknologjisë përkatëse si dhe nuk janë dokumente të akredituar/njohur, mjafton të ndjekësh videot online dhe këto gjenerohen automatikisht brenda një kohe të shkurtër, pra nuk tregojnë zotërim të njohurive dhe kapaciteteve teknike.

Dokumentet e lëshuara nga qendra e formimit profesional, gjithashtu nuk janë certifikime të një niveli shumë sipërfaqësor në terma teknike dhe dokumentet nga ASHP për Xheni Hoxhallari, Ardit Hyka, Emerlinda Gjana, Granit Gjana, Ledio Gjyzeli, nuk janë certifikime të vlefshme dhe as ekuivalente me certifikatat që lëshohen nga prodhuesi/zhvilluesi i teknologjisë, në rastin konkret Microsoft, Oracle, AWS, MongoDB etj.

Këtu KVO si në rastet e tjera më lart, rithekson sërish faktin, se përfundimi i një kursi nuk është certifikim. Certifikimi është proces i marrjes së pikëve të caktuara të një provimi, i cili lëshohet nga zhvillues teknologjie dhe zhvillohet në qendra të akredituara ose me mbikëqyrje (proctored), duke verifikuar identitetin e personit i cili e jep provimin.

Autoriteti kontraktor ka rolin e posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Për sa më sipër, KVO konstaton, se edhe pas vendimit të KPP-së nr. 506/2024 për të rivlerësuar dhe kualifikuar OE ankimes, sërish dokumentet mbështetëse në origjinal dhe kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna nga operatori ekonomik INSTANT.AL, si në pikëpamje ligjore (kriteret e përcaktuara nga vetë legjislacioni në fuqi për RPP), ashtu edhe në përmbajtje (nuk reflektojnë

cështje të brendisë dhe njohurive që kërkohen në këtë procedurë prokurimi sa i takon kapaciteteve teknike).

Thënë kjo, këto dokumente mbështetëse në origjinal dhe kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna nuk janë në përmbushje të kriterëve teknike dhe të vetëdeklarimeve të dhëna për procedurën objekt “Blerje e sistemit të menaxhimit të konsultimit publik (oshc, ojf, palë interesi dhe lobistë) dhe shërbim mirëmbajtje 48 muaj”. Për këtë qëllim, KVO vendosi skualifikimin e ofertës së OE INSTANT.AL.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “IMAGE & COMMUNICATIONS DEVELOPMENT”, me NIPT L01511027P dhe me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Donika Kastrioti", Pallati Teknoprojekt, Apartamentet 5/1 dhe 5/6 , se oferta paraqitur prej tij, me vlerë të përgjithshme prej 9.350.000 (nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertë fituese paraprake e procedurës.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL DURRËS

Drejtuar për lotin nr.1: BOE: MONTAL J62009007F & BIOMETRIC ALBANIA J61827062E, në adresën: Tiranë, DERVISH HIMA-3KULLAT K.3 AP9/2 dhe Tiranë, Blv. Zhan D’Ark, pallati 53, ap. 6B.

Lloji i procedurës së prokurimit: - E hapur mbi kufirin e lartë monetar (mallra) – Marrëveshje kuader me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj nga nënshkrimi.

Numri i referencës së procedurës- REF-97716-03-07-2024

Numri i referencës së Lotit 1 – REF-97720-03-07-2024

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje materiale konsumi mjekësore për 12 muaj e ndare në 2 (dy) lote”.

Objekti i Lotit 1 – Materiale mjekimi të përgjithshme për nevojat spitalore

Fondi limit/Vlera e Pritshme e Kontratave, për të gjitha lotet rezultojnë: 54.589.104 (pesëdhjetë e katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e katër) lekë pa T.v.sh e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: 525.552 euro pa TVSH

e ndarë në lote:

LOT I MM1: 25.735.020 (njetete e pese milion e shtateqind e tridhjetë e pese mijë e njetete) leke pa TVSH e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 07.03.2024: 247.762 euro pa TVSH

*Vlerat janë konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, date 07.03.2024 me kurs këmbimi 103.87 lekë..

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 Muaj nga nenshkrimi i marrëveshjes kuader.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Data: 11.03.2024, Numri: 14

Buletini i Njoftimeve Publike Data: 13.03.2024, Numri: 24

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

- Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. T R I M E D K51612031J

Vlera e ofruar: 23.456.273,00 (njetete e tre milion e katerqind e pesedhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatedhjetë e tre) Leke pa tvsh.

2. BOE: MONTAL J62009007F & BIOMETRIC ALBANIA J61827062E

Vlera e ofruar: 24.939.520,00 (njetete e kater milion e nenteqind e tridhjetë e nente mijë e peseqind e njetete) Leke pa tvsh.

- Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

• T R I M E D K51612031J

Vlera e ofruar: 23.456.273,00 (njetete e tre milion e katerqind e pesedhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatedhjetë e tre) Leke pa tvsh.

Arsyeja: Bazuar ne Procesverbalin e Komisionit te Vleresimit te Ofertave “Mbi zbatimin e Vendimit te KPP-se nr. 1070/2024 dt. 15.08.2024”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE: MONTAL J62009007F & BIOMETRIC ALBANIA J61827062E, ne adresen: Tiranë, DERVISH HIMA-3KULLAT K.3 AP9/2 dhe Tiranë, Njësia bashkiake nr 2, rruga Vllazen Huta, pallati Vila Park, shkalla 1, kati 6, ap 25, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 24.939.520,00 (njetete e kater milion e nenteqind e tridhjetë e nente mijë e peseqind e njetete) Leke pa tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit per lotin nr. 1.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE VLORË

Drejtuar: MILIFAR sh.p.k
Rr. Xhorxhi Martini 33/1 TIRANE, kodi postar:1000

Proçedura e prokurimit/lotit: PROCEDURE E HAPUR E THJESHTUAR, MALL

Numri i proçedurës / referenca e Lotit: REF-16186-08-14-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “ Shpenzime për D.D.D, Sektori i Shërbimit”, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë proçedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- | | |
|--------------------------|-----------------|
| • 1. MILIFAR sh.p.k | J8142600II |
| Emri i plotë i shoqërisë | Numri i NIPT-it |

Vlera 1 937 000 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH (e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Nuk ka operatorë të skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë MILIFAR sh.p.k me adresë Rr. Xhorxhi Martini 33/1 TIRANE, kodi postar:1000, se oferta e paraqitur me vlerë totale totale 1 937 000 (një milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

BASHKIA SHKODËR

Drejtuar: DeltaREX sh.p.k.Adresa: Lagjia 3 Heronjte, rruga Mirash Ivanaj Nr.9, numer pasuarie 8/463, Shkoder., NUIS L92314031R.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-16529-08-19-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës:”F.V kurrize artificiale dhe blerje cilinder PVC(Levizshmeria dhe sinjalistika)”.
Fondi limit: 4,106,675 (Katërmilion e njëqind e gjashtëmijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e pese) lekë pa tvsh

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 30 (tridhjetë) dite.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 54 datë 26 Gusht 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Operatori ekonomik DeltaREX sh.p.k. me administrator z. Artur Bisha me NUIS L92314031R. Vlera 3,150,000 (Tremilion e njeqind e pesedhjetemije) lekë pa tvsh.

2.Operatori ekonomik R. S. & M sh.p.k. me administrator z. Nikolla Çaçi me NUIS K32203002I. Vlera 3,320,000 (Tremilion e treqind e njezetmije) lekë pa tvsh.

Nuk ka ofertues të skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: DeltaREX sh.p.k me administrator z. Artur Bisha me NUIS L92314031R, me ofertën ekonomike me vlerë 3,150,000 (Tremilion e njeqind e pesedhjetemije) lekë pa tvsh., është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar.

ECO TIRANA

Drejtuar: CompITel

Tirane, Rruga Ndre Mjeda, Pallati Star, Hyrja B1/1, Kati 3, Apartamenti 3.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur, mbi kufirin e larte monentar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-12176-07-04-2024 Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Blerje makine fshese e re, Fondi limit: 19.198.234 (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e katër) Lekë pa tvsh, ekuivalente ne 191.370 (njeqind e nentedhjetete e nje mije e treqind e shtatedhjetete) Euro me kurs kembimi 100.32 (referuar Bankes se Shqiperise date 04.07.2024)

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: nga nenshkrimi i kontratës deri në 31.10.2024

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- | | |
|---|--------------------------------|
| 1. CompiTel
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera 15.000.000 (pesëmbëdhjete milion) Leke pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë) | M31417021V
Numri i NIPT-t |
| 2. Autobren s.r.l
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera 19.060.800 (nëntëmbëdhjete milion e gjashtëdhjete mijë e teteqind) Leke pa tvsh ekuivalente
ne 190.000 (njqind e nentëdhjete mijë) Euro
(e shprehur në shifra dhe fjalë) | 00606250249
Numri i NIPT-it |

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:nuk ka

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë CompiTel, Tirane, Rruga Ndre Mjeda, Pallati Star, Hyrja B1/1, Kati 3, Apartamenti 3se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 15.000.000 (pesëmbëdhjete milion) Leke pa tvsh [shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

ECO TIRANA

To: CompiTel
Tirane, Rruga Ndre Mjeda, Pallati Star, Hyrja B1/1, Kati 3, Apartamenti 3.

Procurement / lot procedure Open Procedure over the upper monetary limit

Number of procedure/lot reference: REF-12176-07-04-2024

Short description of the contract: Purchase of new sweeper vehicle

Limit Fund: 19.198.234 (nineteen million one hundred and ninety-eight thousand two hundred and thirty-four) ALL excluding VAT, equivalent to 191.370 (one hundred and ninety-one thousand three hundred and seventy) Euros with an exchange rate of 100.32 (referred to the Bank of Albania on 04.07.2024)

Duration of the contract. Framework Agreement or deadline for its execution: from the date of signing the contract until 31.10.2024.

Previous publications (if applicable): Public Notices Bulletin [Date] [Number]

Award criteria: the most economically advantageous bid based on costs the most economically advantageous bid based on price x

We hereby inform that the following bidders have participated in this procedure with these respective offered values:

1. CompiTel M31417021V

Value 15.000.000 (fifteen million) ALL vat excluded

2. Autobren s.r.l 00606250249

Value 19.060.800 (nineteen million sixty thousand eight hundred) Lek VAT excluded equivalent to 190,000 (one hundred and ninety thousand) Euro

Out of the participants, the following bidders have been disqualified:

* * *

Referring to the above-mentioned procedure, we inform CompiTel, Tirane, Rruga Ndre Mjeda, Pallati Star, Hyrja B1/1, Kati 3, Apartamenti 3 [respective amount expressed in words and figures]/ total points received [_____] has been identified as the successful bid.

With the publication of this notice, the deadlines for appeal according to the provisions of Article 109 of Law no. 162/2020, dated 23.12.2020, "On Public Procurement" shall commence.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Drejtuar: OE "BIOMETRIC ALBANIA" sh.p.k, me adresë: Njesia bashkiake nr 2, rruga Vllazen Huta, pallati Vila Park, shkalla 1, kati 6, ap 25, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-13316-07-16-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti II: “Blerje materiale konsumi për analizat e ADN”, me afat për zbatimin e saj: Afati i lëvrimin do të jetë 90 (nëntëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): S`ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 40 date 22 Korrik 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik: “BIOMETRIC ALBANIA” sh.p.k, me NIPT J61827062E

Vlera: 10,994,000 (dhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s`kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

S`ka.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë: OE “BIOMETRIC ALBANIA” sh.p.k me adresë: Njesia bashkiake nr 2, rruga Vllazen Huta, pallati Vila Park, shkalla 1, kati 6, ap 25, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 10,994,000 (dhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Drejtuar: OE “KRIJON” sh.p.k, me adresë: Farke FARKE Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-13313-07-16-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti I: “Blerje materiale konsumi për analizat e ADN”, me afat për zbatimin e saj: Afati i lëvrimin do të jetë 90 (nëntëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): S`ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 40 date 22 Korrik 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik: “KRIJON” sh.p.k, me NIPT K12023001A

Vlera: 12,996,800.0 (dymbëdhjete milion e nentëqind e nentëdhjete e gjashte mijë e teteqind) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s`kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

S`ka.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë: OE “KRIJON” sh.p.k me adresë: Farke FARKE Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 12,996,800.0 (dymbëdhjete milion e nentëqind e nentëdhjete e gjashte mijë e teteqind) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Drejtuar: OE "ISOMETRIC" sh.p.k, me adresë: Rruga Dibres Kompleksi Arlis Farmacia 10 shk.2 App. 2, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar".

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-13318-07-16-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti III: "Blerje materiale konsumi për analizat e ADN", me afat për zbatimin e saj: Afati i lëvrimin do të jetë 90 (nëntëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): S'ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 40 date 22 Korrik 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik: "ALMedical" sh.p.k, me NIPT K21511002I

Vlera: 2,350,896 (dy milion e treqind e pesëdhjetë mijë e teteqind e nentëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH.

2. Operatori ekonomik: "FEDOS" sh.p.k, me NIPT K01514009I

Vlera: 2,358,850 Idy milion e treqind e pesëdhjetë e tetë; mijë e tetëqind e pesëdhjetë) pa TVSH.

3. Operatori ekonomik: "ISOMETRIC" sh.p.k me NIPT L92207009A

Vlera: 1,821,850 (nje milion e teteqind e njetete e nje mijë e teteqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik: "KRIJON" sh.p.k, me NIPT K12023001A

Vlera: 1,969,400.0 (nje milion e nenetëqind e gjashtëdhjetë e nente mijë e katerqind) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik: "LEL-Medical" sh.p.k, me NIPT K81917006T

Vlera: 1,975,800 (nje milion e nentëqind e shtatëdhjetë e pese mijë e teteqind) pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

S`ka.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë: OE “ISOMETRIC” sh.p,k me adresë: Rruga Dibres Kompleksi Arlis Farmacia 10 shk.2 App. 2, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,821,850 (nje milion e teteqind e njetete e nje mije e teteqind e pesedhete) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Drejtuar: “NELSA” SH.P.K

Adresa: Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1, Dajt, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë me të gjitha kushtet e përcaktuara
Number of procedure/lot reference:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Objekti Loti III. “Blerje Mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 12,196,604 (dymbëdhjete milion e njeqind e nentedhete e gjashte mije e gjashteqind e kater) lekë pa TVSH, ose 121,625 (njeqind e njetete e njemije e gjashteqind e njetete e pese) EURO pa TVSH dhe me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj.

Numer reference Loti 3: REF-11538-06-28-2024

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1) “ARGENT DACI” P.F. NIPT L01914003T
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 11,989,050 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e nënë mijë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH
(me numra dhe fjalë)

2) “NELSA” SH.P.K NIPT J71601012S
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 11,312,000 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH
(me numra dhe fjalë)

3) “M.C.CATERING” NIPT K72218022J
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 10,303,000 (dhjetë milionë e treqind e tre mijë) lekë pa TVSH
(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

“M.C.CATERING” NIPT K72218022J
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Arsyeja e skualifikimit:

Gjatë procedurave të verifikimit të dokumentacionit të subjektit M.C. CATERING sh.p.k., i klasifikuar i pari sipas procesverbalit të datës 14.08.2024, KVO konstatoi mangësi thelbësore në lidhje me plotësimin e kërkesave të Vecanta për Kualifikim sipas pikës 2.3.7 të KVK argumentuar si poshtë vijon:

1.Nuk disponon kontrata të rregullta furnizimi me mish viçi. Subjekti furnizues i palicensuar sipas legjislacionit të fushës për tregtim mishi.

Si detyrim për plotësimin e dokumenteve provuese sipas pikës 2.3.7, në datën 27.08.2024, M.C.CATERING, për artikullin mish vici, dorëzoi kontratën e furnizimit dt.10.12.2021 Nr.1517 REP 540 KOL, lidhur me subjektin FOGI sh.p.k me objekt “Furnizim me te gjitha llojet e mishit (Vica, gjedhë etj). Referuar këtij dokumenti rezulton se subjekti FOGI sh.p.k nuk dispononte licensën e tregtimit të mishit por është ishte e pajisur me licensë nga QKL (Rritja ose tregtimit i kafshëve të gjalla dhe Nënkatëoria: Mbarështrim i kafshëve në fermat agrolektorale të mëdha”, dhe se merr përsipër të furnizojë me viça për therje subjektin M.C.CATERING). Ky fakt u verifikua nga KVO në Regjistrin Kombëtar të Licensave nga QKL on-line nga ku FOGI rezulton subjekt i licensuar vetëm për tregtim të kafshëve të gjalla dhe nuk disponon asnjë licensë të vlefshme për therjen e mishit dhe tregtimit të tij.

Mbështetur në këto fakte dhe dokumente, KVO vlerësoi në mënyrë shteruese se operatori ekonomik M.C.CATERING nuk plotëson kërkesat sipas pikës 2.3.7 të Kërkesave të Vecanata për Kualifikim në lidhje me vërtetimin e furnizimit me mish viçi pasi operatori me të cilin ofertuesi ka lidhur kontratë furnizimi FOGI sh.p.k, nuk ka të drejta ligjore për shitjen dhe tregtimin e mishit por vetëm për shitjen

dhe furnizimin e kafshëve të gjalla, dhe mbi këtë bazë oferta e këtij operatori ekonomik duhet të refuzohet.

2.Nuk vërteton me dokumente cili është prodhuesi i artikujve me distributor ISMET DARSI p.f -Operatori Ekonomik M.C.CATERING nuk plotëson pikën 2.3.7 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, në lidhje me detyrimin për dorëzimin e dokumenteve provuese për subjektin ISMET DARSI p.f, i cili është deklaruar si Distributor i Autorizuar nga Prodhuesi. Referuar licensës LN-3120-04-2017 “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, subjekti ISMET DARSI nuk është prodhues i artikujve ushqimorë, dhe ofertuesi M.C CATERING kishte detyrimin ligjor të dorëzonte dokumentet ligjore që vëretojnë prodhuesin e artikujve që do të furnizohen nga ISMET DARSI p.f .

Bazuar në sa më sipër, si dhe në zbatim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të nenit 82, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, në përfundim, të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit ligjor, teknik dhe ekonomik për procedurën Loti III “Blerje mishi dhe nënproduktet e tij”, me nr. reference REF-11538-06-28-2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vendosi të s’kualifikojë “M.C. CATERING” sh.p.k. me NUIS K72218022J.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

“NELSA” SH.P.K

Emri i plotë i shoqërisë

Vlera: 11,312,000 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë)

NIPT J71601012S

numri i NIPT-it

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL SHKODËR

Drejtuar: KLAME

Adresa: Tirane Tirane Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF- 07548-05-30-2024/REF- 07554-05-30-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “F.V pajisje per polikliniken sp.Shkoder”

Lot 3 F.V pajisje mobilimi per Polikliniken e Specialiteteve

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “M.LEZHA” J76504013C
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t
Vlera 5,788,400 (pese milion e shtateqind e tetedhete e tete mije e katerqind) leke pa tvsh.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. KLAME K21518003F
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
Vlera 5,699,200 (pese milion e gjashteqind e nentedhete e nente mije e dyqind) leke pa tvsh.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. ERZENI/SH J66902027T
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
Vlera 4,908,900.0 (katermilion e nenteqind e tetemije e nenteqind) leke pa tvsh.
(e shprehur në shifra dhe fjalë).

4. BUNA J61826501C
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
Vlera 5.530.500 (pesë milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind) leke pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë).

5. SHAGA. J96822229J
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
Vlera 5,689,392.00 (pese milion e gjashteqind e tetedhete e nente mije e treqind e nentedhete e dy)
leke pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë).

6. ERALD J74517205P
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it
Vlera 6.218.600 (Gjashtë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.
(e shprehur në shifra dhe fjalë).

7. BOLT K91517011V
 Vlera 6,346,400 (Gjashte milion e treqind e dyzete e gjashtemije e katerqind] leke pa tvsh.
 (e shprehur në shifra dhe fjalë).

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.ERZENI/SH	J66902027T	data e shtojces 1 dhe 2 eshte gabim (data 29.07.2024 jo data 26.07.2024 data e zhvillimit te procedures)
pika 2.3.7 Në katalogë, nuk jane shenuar numrat rendor sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes.		
Mungon deklarata sipas pikes 2.3.9		
Emri i plotë i shoqërisë mëposhtme	Numri i NIPT-it	arsyet e
2. BUNA	J61826501C	Pika 2.3.2 ne formularin e vetdeklarimit si dhe dokumentet provuese mungon profili marangoz.
Pika 2.3.6 Deklarata jo e plote(mungon montimi)		
Pika 2.3.7 Mungon katalogu i prodhuesit per artikullin numer 2.		
Emri i plotë i shoqërisë mëposhtme	Numri i NIPT-it	arsyet e
3.SHAGA.	J96822229J	Formulari permbledhes i vetedeklarimit eshte i vjetri jo sipas shtojces 9 te DST.
		Mungon deklarata
2.3.4		
Emri i plotë i shoqërisë mëposhtme	Numri i NIPT-it	arsyet e
4.BOLT	K91517011V	2.3.7 Operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar si dhe nuk janë të pasqyruara te gjitha specifikimet teknike të kërkuara për artikujt ku duhet të shënohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertës dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar.
Deklarata 2.3.6 jo e plote(mungon montimi).		
Emri i plotë i shoqërisë	Numri i NIPT-it	arsyet e mëposhtme
* * *		

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë KLAME Adresa: Tirane Tirane Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5,699,200 (pese milion e gjashteqind e nentedhjete e nente mije e dyqind) leke pa tvsh / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Drejtuar: OE "O3 LAB" sh.p.k, me adresë: Rruga "Vidhe Gjata" 16, Autostrada Tirane Durres Km 1, Mezez-Kashar, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar".

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-13320-07-16-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti I: "Blerje materiale konsumi për analizat e ADN", me afat për zbatimin e saj: Afati i lëvrimin do të jetë 90 (nëntëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): S`ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 40 date 22 Korrik 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik: "O3 LAB" sh.p.k, me NIPT M01804013U

Vlera: 10,081,183 (dhjete milion e tetëdhjete e një mijë e njëqind e tetëdhjete e tre leke) pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s`kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

S`ka.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë: OE "O3 LAB" sh.p.k, me adresë: Rruga "Vidhe Gjata" 16, Autostrada Tirane Durres Km 1, Mezez-Kashar, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 10,081,183 (dhjete milion e tetëdhjete e një mijë e njëqind e tetëdhjete e tre leke) pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Drejtuar: "BAJRO BROS" SHPK

Adresa: Tirane Rr. Ndre Mjeda, kompleksi rezidencial "Magnet", Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur e Thjeshtuar, mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: LOTI II REF-16437-08-16-2024 Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Për Lotin II "Blerje kondicionerë" për Inspektoritin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me fond të përgjithshëm në vlerën 700,000 (shtatëqind mijë) Lekë pa TVSH , me afat të lëvrimit të mallit brenda 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 54 datë 26.08.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- | | |
|---|------------------------------------|
| 1. "BAJRO BROS" SHPK
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera: 607,500 (gjashtëqind e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH | NUIS M113130290
Numri i NIPT-t |
| 2. "GENERAL PLUS" SHPK
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera: 637,000 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH | NUIS L82020015J
Numri i NIPT-it |
| 3. "LAVIVA TECHNOLOGIES" SHPK
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera: 612,000 (gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH | NUIS M01323012A
Numri i NIPT-it |
| 4. "SULLOLLARI-KLIMA" SHPK
Emri i plotë i shoqërisë
Vlera: 634,400 (gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e katërqind) | NUIS K01529003M
Numri i NIPT-it |

Nuk ka operator ekonomik të skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “BAJRO BROS” shpk Adresa: Tirane Rr. Ndre Mjeda,, kompleksi rezidencial “Magnet” , Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 607,500 (gjashtëqind e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Drejtuar: OE “ISOMETRIC” sh.p.k, me adresë: Rruga Dibres Kompleksi Arlis Farmacia 10 shk.2 App. 2, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapua e thjeshtuar”.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-12938-07-11-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Blerje kit për marrjen e mostrës biologjike të AND-së për të ndaluar/arrestuar, me afat per zbatimin e saj: Afati i lëvrimit do të jetë 90 (nëntëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): S’ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 37 date 15 Korrik 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik: “ISOMETRIC” sh.p.k me NIPT L92207009A

Vlera: 1,876,000 (nje milion e teteqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik: “LEL-Medical” sh.p.k, me NIPT K81917006T

Vlera: 1,880,000 (nje milion e teteqind e tetedhjte mije) pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

S`ka.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë: OE “ISOMETRIC” sh.p,k me adresë: Rruga Dibres Kompleksi Arlis Farmacia 10 shk.2 App. 2, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,876,000 (nje milion e teteqind e shtatedhjte e gjashte mije) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Drejtuar: Operatorit ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k., me NUIS J72124001N, me adresë “Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane - Durres, Km.10”

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Number of procedure/lot reference:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale zyre/kancelari për SUT, për një periudhë 24 mujore”, e ndarë në lote: Loti 2 – Blerje materiale Kancelarie të tjera zyre, me fond limit 1,461,750.00 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, me nr. REF-16445-08-16-2024.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “InfoSoft Office” sh.p.k. J62426002Q
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 1,089,713.62 (një milion e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e trembëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

2. “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k. L91418502J
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 1,440,390 (një milion e katërqind e dyzet mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k. J72124001N
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 1,411,927 (një milion e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. “InfoSoft Office” sh.p.k. J62426002Q
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Arsyet: Bazuar në nenin 93(5) të LPP, pasi Oferta e operatorit ekonomik si më sipër është anomalisht e ulët.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1. “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k. J72124001N
Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) 1,411,927 (një milion e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH. Totali i pikëve të marra (nuk aplikohet)

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM VLORE

Drejtuar: "SYNAPSE ATS" SHPK, me adresse : Tirane Tirane TIRANE Njesia 7, Rruga "Dritan Hoxha", Pallati MC-Inerte, Kati 2 " NIPT L12321011H

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar- Mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-13286-07-16-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Blerje Pajisje Sigurie (sistem i ftohjes se dhomes se serverit) per nevoja te Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Vlore

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Sinteza CO shpk	Numri i NIPT-t	K11324003F						
Vlera	1,700,000	(një milion	e	shtateqindmije)	leke	pa	tvsh.	
2. Advanced Business Solutions-ABS shpk	Numri i NIPT-t	K21710002J						
Vlera	1,900,000	(një milion	e	nenteqindmije)	leke	pa	tvsh.	
3. SYNAPSE ATS shpk	Numri i NIPT-t	L12321011H						
Vlera	1,950,000	(një milion	e	nenteqind	e	pesedhjetemije)	leke	pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Sinteza CO shpk Numri i NIPT-t K11324003F

Vlera 1,700,000 (një milion e shtateqindmije) leke pa tvsh

Arsyet e skualifikimit:

Gjate shqyrtimit te dokumentacionit, Autoriteti Kontraktor verejti se nga operatori ekonomik "Sinteza CO" shpk ishin ngarkuar ne SPE dy katalog me emertimet : KATALOG dhe KATALOG_2.

Autoriteti Kontraktor vërejt se në të dy kataloget gjendet i paraqitur modeli i pajisjes EMICON DX.A 151 D Kc për të cilin operatori ekonomik ka paraqitur edhe ofertën e tij në vlerë, por në njerin nga kataloget me emërtimin “KATALOG” ishin paraqitur të dhëna (parametra teknik) të cilat nuk përputhen me parametrat teknik të percaktuar nga Autoriteti Kontraktor, parametrat teknik në këtë katalog ishin disa me të ulet se ato të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor si për Qarkullimi nominal i ajrit në këtë katalog është 3275 m³/h, ndërkohë Autoriteti Kontraktor e ka percaktuar këtë parameter minimalisht 3500 m³/h.

Po, në këtë “KATALOG”, nuk ishin paraqitur të dhëna për Mikroprocesorin që nëse operon apo jo me dy njësi në një sistem, operim në zonë dhe Sekuencim të punës me funksion gadishmerie.

Në “KATALOG_2” ishin paraqitur shumë modele të pajisjeve, ndër të cilat edhe modeli me emërtim EMICON DX.A 151 D Kc, model me të cilin operatori ekonomik ka paraqitur ofertën e tij në shtojcën 2.

Modeli i paraqitur ka disa parametra që përputhen me ato të kërkuarat nga Autoriteti Kontraktor, por edhe në këtë katalog për të njëjtin model pajisje nuk paraqiten të dhëna mbi Mikroprocesorin nëse operon apo jo me dy njësi në një sistem, operim në zonë dhe Sekuencim të punës me funksion gadishmerie.

Në, këto kushte Autoriteti Kontraktor gjykon dhe vlerëson se në asnjë nga kataloget e paraqitur pajisja me të cilin operatori ekonomik ka ofertuar EMICON DX.A 151 D Kc nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, (në njerin katalog paraqiten parametra teknik me të ulet se ato të kërkuarat dhe asnjë e dhënë mbi mikroprocesorin, në tjetrin nuk paraqiten të dhëna të plota mbi Mikroprocesorin.

Autoriteti Kontraktor vendosi të refuzojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sinteza CO” shpk pasi modeli i pajisjes me të cilin ka paraqitur ofertën e tij në të dy kataloget nuk përmbush specifikimet teknike të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2. Advanced Business Solutions-ABS shpk

Numri i NIPT-t K21710002J

Vlera 1,900,000 (një milion e nentëqindmijë) leke pa tvsh.

Arsyet e skualifikimit:

Gjate shqyrtimit të dokumentacionit, Autoriteti Kontraktor vërejt se nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions” shpk nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e veçantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 8, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme për pothuajse të gjitha rubrikat. Ka dhënë informacion vetëm për personat në cilësinë e administratorëve të shoqërisë dhe ortakëve të cilat përputhen me QKB.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin

publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE "TOWER" SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE "TOWER" SH.P.K, skualifikohet.

7.BOE: TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING SHPK K51428048I & ERALD-G SHPK K36306784K & HTC COMPANY SHPK M11619018P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se nuk përmbush kriterin 2.3.5, te kushteve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se: Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Mekanik
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Elektrik / Elektronike
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Topograf
- Minimumi 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- Minimumi 1 (një) Arkitekt

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave thekson se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik duhet të deklarojnë ne Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit disponimin e stafit Teknik të sipercituar dhe në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik duhet që cdo anetar i bashkimit të deklarojë ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit disponimin e stafit Teknik inxhinierik në përputhje me përqindjen e shërbimit të marre persiper në marreveshjen e Bashkepunimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Transport Highëay Consulting” Sh.P.K & “HTS Company” SH.P.K & Erald-G SH.P.K, ka paraqitur marreveshjen e bashkepunimit të datës 02/08/2024, ku me ane të kesaj marreveshje, shoqërite kane rënë dakort se Shoqëria “Transport Highëay Consulting” Sh.P.K është e autorizuar dhe do të ketë drejtimin dhe mundësinë që të veprojë si udhëheqëse dhe përfaqësuese e bashkimit, kundrejt Autoritetit Kontraktor. Gjithashtu me ane të kesaj marrëveshje bashkëpunimi, shoqëria “HTS Company” SH.P.K dhe Shoqëria Erald-G SH.P.K, kane autorizuar shoqërinë “Transport Highëay Consulting” Sh.P.K, të drejtojë të gjithë procedure e tenderimit dhe në rast shpallje fitues të drejtojë të gjithë marrëdhënien ekonomike duke përfshirë disbursimin e pagesave për shërbimin e mbikqyrjes së punimeve, menaxhinin e përgjithshëm tekniko-inxhinierik si dhe marrëdhëniet juridike me AK si dhe kane ndarë detyrat si më poshtë vijon:

- a- Shoqëria “Transport Highëay Consulting” Sh.P.K, do të mbulojë 55 % të volumit të shërbimit.
- b- Shoqëria Erald-G SH.P.K, do të mbulojë 25 %, të volumit të shërbimit,
- c- Shoqëria “HTS Company” SH.P.K, do të mbulojë 20 % të volumit të shërbimit,

Nga verifikimi i Formulareve Permebledhes te Vetedeklarimit ngarkuar ne SPE, rezulton se Operatoret Ekonomike pjese te ketij Bashkimi kane vetedeklaruar si me poshte vijon:

Transport Highway Consulting (THC) 55% te sherbimit HTS Company 20% te sherbimit Erald-G SH.P.K 25% te sherbimit

Ing Ndertimi Engjell Caka Ing. Ndertimi Skender Çela Ing. Ndertimi Gezim Islami

Ing. Mekanik Robert Thoma Ing. Elektrik Rasim Majko Ing. Mekanik Arben Mua

Ing. Gjeolog Aranit Gelaj Arkitekt Besnik Spahiu Ing. Elektrik Hajdar Kurti

Ing. Hidroteknike Anisa Zake

Ing. Topograf Kujtim Cenameti

Arkitekt Elton Carcani

Komisioni i Vleresimit te ofertave mban ne konsiderate se nenin 88/3, te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Sa argumentuam me siper nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton se anetari i ketij bashkimi operatori ekonomik “Transport Highway Consulting” SH.P.K, i cili ka marre persiper realizimin e 55% te sherbimit nuk permbush kriterin e vecante te percaktuar ne piken 2.3.5, te DST-se, pasi nga 7 drejtues Teknik te kerkuar ne kriterin 2.3.5 te DST-se, ky operator ekonomik disponon vetem 3 inxhinier drejtues Teknik duke mospermbushur disponimin e 55% te kapacitetit Teknik te kerkuar ne kete kriter.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e BOE “Transport HighWay Consulting” Sh.P.K

& "HTS Company" SH.P.K & Erald-G SH.P.K, per mos permbushje te kritereve te vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", BOE "Transport HighWay Consulting" Sh.P.K & "HTS Company" SH.P.K & Erald-G SH.P.K, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "MCE" SHPK me NUIS L72203065K me adresë Rruga "Kavajës", Qendra "Sun Tower", Kati 8, Ap.30, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 12,041,835.41 (dymbëdhjetë milion e dyzet e njëmijë e tetëqind e tridhjetë e pesë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Trjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ministrisë së Drejtësisë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO JO

BASHKIA ELBASAN

Nga: Bashkia Elbasan adresa: rruga "Qemal Stafa", Elbasan.

Drejtuar: " ZENIT & CO" sh.p.k., me adrese: Tirane, rruga Myrteza Topi, nd.18, ap.38, me administrator Z.Arqile Peri

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e hapur e thjeshtuar".

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Loti II REF-14873-07-30-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti II : Mbikëqyrje e objektit "Ndërtim muri pritës në rrugën Hysen Ali Kopili , lagjja 5 Maji, për mbrojtjen e dy banesave nga rrëshqitja" me fond limit 34.451 (tridhjetë e katërmijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekë pa t.v.sh., vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2024, me afat 2 muaj për kryerjen e shërbimit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "PROJECT DALUZ 2019 " sh.p.k. me Nipt L92112031B

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 31.800,90 (tridhjetë e njemije e tetëqind presje nëntëdhjetë) lekë (pa tvsh).

2. BOE: "M.A.K STUDIO" sh.p.k. me Nipt: L01422017O & "GREEN EAGLE CONSULTING" sh.p.k me Nipt: L81603023A

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 31.801 (tridhjetë e njemije e tetëqind e një) lekë (pa tvsh).

3. "Novatech studio " sh.p.k. me Nipt: L01717030C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 31.801 (tridhjetë e njemije e tetëqind e një) lekë (pa tvsh).

4. "BN PROJECT" sh.p.k. me Nipt: L21305035S

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 31.801 (tridhjetë e njemije e tetëqind e një) lekë (pa tvsh).

5. "ZENIT & CO" sh.p.k. me Nipt: K61731002D

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 31.800,83 (tridhjetë e njemije e tetëqind presje tetëdhjetë e tre) lekë (pa tvsh).

Ofertues të skualifikuar nuk ka.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: "ZENIT & CO" sh.p.k., me adrese: Tirane, rruga Myrteza Topi, nd.18, ap.38, me administrator Z.Arqile Peri, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej 31.800,83 (tridhjetë e njemije e tetëqind presje tetëdhjetë e tre) lekë (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor, Bashkia Elbasan me adresë: rruga "Qemal Stafa", Elbasan, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO

JOx

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JOx

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL VLORE

Drejtuar: Drejtuar:[*ECO RIKIKLIM shpk me nipt L61814009B, me adrese, metarulgji bradashesh, pasuria 1070 zona kadastrale 3965, Elbasan*]

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF -93267-01-17-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Evadim i mbetjeve te rrezikshme spitalore ,per nevoja te SRV –

Mareveshje Kuader me nje operator ekonomik -ku te gjitha kushtet jane te percaktuara -me afat 2 vjecar (24 muaj) .

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. *V.A.L.E RECYCLING shpk*
Emri i plotë i shoqërisë

L28029301Q
Numri i NIPT-t

Vlera 13.125.055 (trembedhjetë milionë e njëqind e njëzet e pesë mijë e pesëdhjetë e pese) lek pa Tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. MEDI-TEL shpk
J71519004W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 15.519.877,8

(pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë pike tetë) lek pa Tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. ECO RICIKLIM shpk

L61814009B

Vlera 17.071.865 *(shtatëmbëdhjetë milione e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë)*

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. V.A.L.E RECYCLING shpk

L28029301Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e skualifikimit:

Dokumentacioni i ofertes se operatorit ekonomik "V.A.L.E RECYCLING" shpk nuk është i plotë në përputhje me të gjitha kriteret e vecanta të kualifikimit të përcaktuar në DST, pasi

Leja e tipit A- është e pezullar

2. MEDI-TEL shpk

J71519004W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Arsyet e skualifikimit:

Dokumentacioni i ofertes se operatorit ekonomik "MEDI-TEL" shpk nuk është i plotë në përputhje me të gjitha kriteret e vecanta të kualifikimit të përcaktuar në DST, pasi nuk plotëson kriterin 2.3.5, përkatësisht pikat a,b,c,e,f,

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : [ECO RICIKLIM shpk me nipt L61814009B, me adrese, metarulgji bradashesh, pasuria 1070 zona kadastrale 3965, Elbasan], se oferta e paraqitur me vlerë totale 17.071.865 *(shtatëmbëdhjetë milione e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë)* [shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra] [_____] është identifikuar oferta e suksesshme

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO

JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

(Pas skualifikimit të tre operatoreve ekonomik procedura është anuluar. Operatori ekonomik *ECO RICIKLIM* ka ankimuar brenda afateve ligjore dhe KPP ka dal me vendim Nr.1034/2024)

BASHKIA TIRANË

Drejtuar: OPERATORIT EKONOMIK “Lumturi Haxhijosifi” p.f.
Adresa: Njesia Administrative Nr.9, Rruga Vaso Pasha, Pallati 27, kati i 1-re, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “TiranAgro me Nr REF-16465-08-16-20224

Kohëzgjatja. Aktiviteti do të zhvillohet për një periudhë 3(tre) ditore në datat 11-12-13 Tetor 2024;

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Nr. 54 datë 26 Gusht 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë Ofertuesi i mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Lumturi Haxhijosifi” p.f.

NUIS L47201206I

Vlera e ofertës pa tvsh– 6,066,000 (gjashtë milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 7,279,200 (shtatë milion e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Lumturi Haxhijosifi” p.f. me adresë, Njesia Administrative Nr.9, Rruga Vaso Pasha, Pallati 27, kati i 1-re,

Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 6,066,000 (gjashtë milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh dhe 7,279,200 (shtatë million e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë me tvsh, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Referuar nenit 96 pika 2 germa (b), me publikimin e këtij njoftimi, nuk do të priten afatet e ankimimit duke qënë se pjesëmarrës ka qënë një ofertues i vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor “Bashkia Tiranë” sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

BASHKIA ELBASAN

Nga: Bashkia Elbasan adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: “PROJECT DALUZ 2019” sh.p.k., me adrese: Rruga Besim Mema,103, Kati I, Ap.8, Tirane

Procedura e prokurimit/lotit: “Proçedurë e hapur e thjeshtuar”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Loti III : REF-16859-08-22-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti III : Mbikëqyrje e objektit “Rikonstruksion 2 tualetet e teatrit dhe dhomat e aktorëve” me fond limit 24,122 (njetzet e katermije e njeqind e njetzet e dy) lekë pa t.v.sh., vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2023, me afat 2 muaj për kryerjen e shërbimit.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “PROJECT DALUZ 2019 ” sh.p.k. me Nipt L92112031B

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është 18,713 (tetembedhjetemije e shtateqind e trembedhjete) lekë (pa tvsh).

Operatore Ekonomik të s’kualifikuar nuk ka.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: “PROJECT DALUZ 2019” sh.p.k., me adrese: Rruga Besim Mema,103, Kati I, Ap.8,Tirane, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej 18,713 (tetembedhjetemije e shtateqind e trembedhjete) lekë (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor, Bashkia Elbasan me adresë: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO Jo

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JOx

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

BASHKIA SARANDË

Drejtuar: [“ASI-2A CO” SHPK, me NUIS: K53002402C, me adresë: Fier,Lagja Bishanak,Rruga Skenderbeu,pallati nr.18, hyrja nr.6]

Procedura e prokurimit/lotit: “ Procedurë e hapur e thjeshtuar, Punë”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-15763-08-08-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Qendra Rinore Sarande”, Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP45211350-7 Punime ndërtimi për ndërtesa multifunkionale, Fondi limit: 9 616 048 (Nente milion e gjashtëqind e gjashtemedhjetë mijë e dyzete e tete) leke, pa TVSH, Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 40 (dyzete ditë)]* Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [2024] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “ASI-2A CO ” SHPK

K53002402C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 8 958 333,33 (Tete million e nenteqind e pesedhjetë e tete mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. “SARK ” SHPK

K52531415H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 8 664 688 (tetë million e gjashtëqind e gjahtehjetë e kater mijë e gjashtëqind e tetedhjetë e tete) lekë pa TVSH.

3. “TEA-D ” SHPK

K32522629L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 8 142 750 (tetë million e njeqind e dyzete e dy mijë e shtateqind e pesedhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “SARK ” SHPK

K52531415H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet e mëposhtme: Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret kualifikuese të dokumenteve standarte të tenderit.

2. “TEA-D ” SHPK

K32522629L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet e mëposhtme: Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret kualifikuese të dokumenteve standarte të tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [“ASI-2A CO” SHPK, me NUIS: K53002402C, me adresë: Fier,Lagja Bishanak,Rruga Skenderbeu,pallati nr.18, hyrja nr.6], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 8 958 333,33 (Tete million e nentëqind e pesëdhjetë e tete mijë e treqind e tridhjetë e tre presje tridhjetë e tre) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Sarandë, Rruga “Abedin Dino”, Lagja Nr.1. Sarandë] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [----- S ka], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

SH.A KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE TIRANË

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik JUNIK sh.p.k NIPT J68007522L & HTS COMPANY sh.p.k NIPT M11619018P. Adresa: Lagja SMT, Ndërtesë 2-Katëshe, kati 2, pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Lezhë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur, me mjete elektronike – Punë.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Nr. REF 13525-07-18-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Rehabilitimi i rrjetave metalike për 4 (katër) agregatët në veprën e marrjes së HEC Vau i Dejës dhe rehabilitimi i udhëzuesve të rrjetave në zonën nënujore me polumbarë për 5 (pesë) agregatë".

Kohëzgjatja e kontratës: 39 (tridhjetë e nëntë) muaj e ndarë :

Për realizimin e inspektimit dhe hartimin e projektit afati do të jetë 3 (tre) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Pas përfundimit të procesit të hartimit dhe pranimit të projekt-preventivit dhe projektit të zbatimit, kontraktori ka afat maksimal 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj për realizimin e punimeve përkatëse.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.40, datë 22/07/2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

✚ Bashkimi i Operatorëve Ekonomik JUNIK sh.p.k, NIPT J68007522L & HTS COMPANY sh.p.k, NIPT M11619018P, me vlerë të ofertës ekonomike 235,200,000 (Dyqind e tridhjetë e pesë milion e dyqind mijë) Lekë pa TVSH.

✚ Operatori ekonomik MUHOPLUS LTD, NIPT L52317046G, me vlerë të ofertës ekonomike 238,582,000 (Dyqind e tridhjetë e tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik MUHOPLUS LTD, NIPT L52317046G, pasi :

✚ Nuk ka paraqitur sigurim oferte sipas shtojcës 3;

✚ Nuk plotëson kriterin 2.2.1, pasi vlerat e xhirove vjetore të 3 viteve të fundit të paraqitura nëpërmjet vërtetimit për xhiro vjetore të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë nuk arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën një nga vitet e paraqitura.

✚ Nuk plotëson kriterin 2.2.2, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri;

✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.2, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për disponueshmërinë e pikës së licensës në fushën e projektimit në kategorinë 5- f;

✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.3, në të cilin kërkohet: *Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, për periudhën Prill 2024 – Qershor 2024 1 (një) inxhinier ndërtimi ose hidroteknik; 2 (dy) inxhinier mekanik; pasi në formularin e vetëdeklarimit është deklaruar stafi teknik 1 ing mekanik dhe 1 ing elektrik. Sa më sipër OE nuk disponon 1 ing mekanik dhe 1 ing ndërtimi ose hidroteknik.*

✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.4, pasi në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar nëse disponon apo jo stafin e kërkuar në këtë kriter.

✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.5, pasi në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar nëse disponon apo jo stafin e kërkuar në këtë kriter.

- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.6, pasi në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar nëse disponon apo jo stafin e kërkuar në këtë kriter.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.7, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për disponueshmerinë e certifikatës së kërkuar SSH UNI EN ISO 9712.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.9, pasi nuk është paraqitur për vizitën në kantier, kërkesë e këtij kriteri.
- ✚ Nuk plotëson kriterin 2.3.10, pasi pajisjet e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit nuk janë ato të kërkuar në këtë kriter.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomik JUNIK sh.p.k NIPT J68007522L & HTS COMPANY sh.p.k NIPT M11619018P, adresa: Lagjja SMT, Ndërtesë 2-Katëshe, kati 2, pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Lezhë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 235,200,000 (Dyqind e tridhjetë e pesë milion e dyqind mijë) lek pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare) Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (Tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak): Jo.

BASHKIA MALIQ

- Për : OPERATORIN EKONOMIK "VASHTEMIJA " shpk + mbështetës "SALILLARI" shpk
- Adresa: Adresa: Korce ,Libonik ,Vashtemi Rruga Nacionale Korce Pogradec, Km. i 7, 500 m majtas rruges nacionale, zona kadastrale nr.3716, nr.pasurie 686/5, 686/6.
 - NIPT-I : J64103054Q
- "SALILLARI" shpk
- Adresa: Tirane ,Vore ,Lagjja" Vore", Rruga e Vjetër , Vore Marikaj, Km 1, Godina katërkatëshe, Kati itretë, Nr.5
 - NIPTI: J62903125G

Procedura e prokurimit: : Procedure e hapur /Pune /Sistem Elektronik

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-12665-07-10-2024

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “ *Rehabilitim prita malore në infrastrukturën e dëmtuar Zëmbllak e Plasë*”

Afati i kontratës: 4 muaj

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.37 datë 15.07.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “VASHTEMIA ” shpk + mbështetës “SALILLARI”shpk

- Adresa: Korce ,Libonik ,Vashtemi Rruga Nacionale Korce Pogradec, Km. i 7, 500 m majtas rruges nacionale, zona kadastrale nr.3716, nr.pasurie 686/5, 686/6.

- NIPTI: J64103054Q

“SALILLARI” shpk

- Adresa: Tirane ,Vore ,Lagjja" Vore", Rruga e Vjetër , Vore Marikaj, Km 1, Godina katërkatëshe, Kati itretë, Nr.5

- NIPTI: J62903125G

- Vlera e ofertës: 45678041,84(*dyzet e pesë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyzet e një pikë tetëdhjetë e katër*) lekë pa tvsh

2.Operatori Ekonomik “NIKA” shpk

- Adresa: Shkoder, Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587” 4001.

- NIPT-I : J76705047U

- Vlera e ofertës: 45796860,26 (*dyzet e pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë pikë njëzet e gjashtë*) lekë pa tvsh.

3. Operatori Ekonomik “SPARTAK S.A” shpk + mbështetës Romeo Mankolli, “GJIKURIA” shpk, “KORSEL”shpk, “ALEKS DAJKO” Person Fizik, “SIMAKU” shpk,“AVDOLLI” shpk.

“SPARTAK S.A”

- Adresa: Korçë Bilisht DEVOLL Rruga 5 Maji, Tek Kullat Binjake, Bilisht.

- NIPT-I : K07014610W

“Romeo Mankolli” Person Fizik

- Adresa: Korce Pojan ZEMBLAK Rruga Korce-Bilisht, Km. i 13, Zëmbllak.

- NIPT-I : L24020002A

“GJIKURIA”shpk

-Adresa: Tirane Tirane Njësia Bashkiake Nr. 2, rruga “Faik Konica”, residenca “Lion Park”, kati 3-të, Tiranë.

-NIPT-I :J62903456H

“KORSEL” shpk

-Adresa: Korçe KORCE Lagjja17, Rruga Midhi Kostani,Prane Hipotekes, Objekti Nr. 23

-NIPT-I :J64104124G

“ALEKS DAJKO”Person Fizik

-Adresa: Korce Maliq VLOCISHT Lagjja e Re, Objekt privat nr.29.

-NIPT-I :L93905001R

“SIMAKU”shpk

-Adresa: Korce Libonik SYMIZ Km. i 13, Rruga Korçe-Tirane, zona kadastrale 3553, nr.pasurie 723/10.

-NIPT-I :K43721001Q

“AVDOLLI”shpk

-Adresa: Korce Korçe KORCE Lagjja 18, Rruga Muzakajt, Zona Kadastrale 8561, Nr. Pasurie 4/1110

-NIPT-I :K14721001P

- Vlera e ofertës : 46.316.207,32 (*dyzet e gjashtë million e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatë pikë tridhjetë e dy*)lekë pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik “INA”shpk + Mbështetës “2N”shpk

- Adresa: Tirane ,Rruga Besim Imami, MyslymShyri,MbrapaKarburantit

- NIPT-I :J61814009W

“2N”shpk

- Adresa: Rruga Demokracia, PaskuqanFushe,PallatiII,Kati I ,Tirane, Kodi postar 1029.

- NIPT-I :L31615017L

- Vlera e ofertës: 46362590,75(*dyzet e gjashtë milion e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë pikë shtatëdhjetë e pesë*) lekë pa tvsh

5. Operatori Ekonomik “ARTYKA II”shpk

- Adresa: Korce Bilisht BILISHT Rruga e Mirasit, Km.i I, Prane Ish Nyjes se Inerteve, Bilisht.

- NIPT-I : K26625603U

- Vlera e ofertës: 46949914,64 (*dyzet e gjashtë million e nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e katër*) lekë pa tvsh

6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “INFINIT”shpk & “JOGI” shpk + Mbështetës “LTE Construction”shpk

“INFINIT”shpk

- Adresa: KorcePogradec POGRADEC Rruga Fan Noli, lagjja 3, nr pasurie 3/16.

- NIPT-I: J74304623M

“JOGI” shpk

- Adresa: Fier,L. 11 JANARI.

- NIPT-I :J63229478K

“L.T.E CONSTRUCTION” shpk

-Adresa: Tirane,Kashar,Rruga 3 Deshmoret,godinebanimidhesherbimi 1,2,5,8 dhe 11 kate me 2 kat parkimnentoqe ne prone teshoqeriseLloxhall.

-NIPT-I: L78006801F

- Vlera e ofertës: 49627333,7(*dyzet e nëntë million e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e treqind e tridhjet e tre pikë shtatë*) lekë pa tvsh

7. Bashkim operatorësh ekonomikë “VILDEV - CO”shpk + “A.L.Asfalt”shpk+ mbështetës “AL-DEMIRAJ”

- Adresa:Lagjja 17, Rruga Riza ManÁe, Nr.21.7001,Korçë.
- NIPT-I :K83926001F
- Vlera e ofertës:50.575.617(pesëdhjetëmilion e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh

“A.L-ASFALT”shpk

- Adresa: Durrës ,Xhafzotaj SALLMONE ,RrugaHoxheve, Zona kadastrale 3852, Nr pasurie 19/36
- NIPT-I: K81511508A

“AL-DEMIRAJ”

- Adresa:Korce-bilisht, godina nr.1, rruga superstrada e Bilishtit
- NIPT-I:K56321622A

8. Bashkim operatorësh ekonomikë “XHENGO”shpk + “CURRI”shpk**“XHENGO”shpk**

- Adresa:Korçë,DON. GJON. BUZUKU, L.5,
- NIPT-I: J64103171M

“CURRI”shpk

- Adresa:Tirane ,Njesia Administrative Nr.10, Rruga Kajo Karafili, Nd.2, H.4, Ap.3, 1001
- NIPT-I:J67902718S

- Vlera e ofertës: 50590178 (*pesëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë*) lekë pa tvsh

9. OperatoriEkonomik“FLED”shpk + Mbështetës “BESTA”shpk**“FLED”shpk**

- Adresa: Berat ,Kozare HAVALEHAS, Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozaresKuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307.
- NIPT-I :K17621104C

“BESTA”shpk

- Adresa: Berat Ura Vajgurore Ura Vajgurore Njësia Administrative Poshnje, Ndërtesë dy katëshe, kati i dytë, Zona kadastrale 3032, Pasuria Nr.326/20.
- NIPT-I : J62903182B
- Vlera e ofertës: 51653490,70 (*pesëdhjetë e një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë pikë shtatëdhjetë*) lekë pa tvsh

10. OperatoriEkonomik “REJ” shpk

- Adresa: Tirane,Zogui Zi, Qatar Center, kati 2.
- NIPT-I :J93711608Q
- Vlera e ofertës: 51924064,45 (*pesëdhjetë e një milion e nëntëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë dyzet e pesë*) lekë pa tvsh

11. Operatori Ekonomik “ASI-2A CO” shpk

- Adresa: Fier, RrugaSkenderbeu, LagjjaBishanake,pallati nr 18, hyrja nr. 6.
- NIPT-I :K53002402C
- Vlera e ofertës: 52975060,55 (*pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë pikë pesëdhjetë e pesë*) lekë pa tvsh

12. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “ISOBAR CONSTRUCTION”shpk& “APIS COMSTRUCTION”shpk**“ISOBAR CONSTRUCTION”shpk**

- Adresa: Tirane KASHAR KASHAR Mezez, toke me numer pasurie12/14, volumi 2, faqe 97, e ndodhur ne zonen kadastrale 2629.

- NIPT-I : L12210036D

“APIS CONSTRUCTION” shpk

- Adresa:Tirane ,Njesia bashkiake Nr.2, RrugaGeorge Ë.Bush, Pallati nr.1, Kati 3, Ap nr.26, (Prane ures se Tabakve).

- NIPT-I : L41513008A

- Vlera e ofertës: 53628908,7 (*pesëdhjetë e tre million e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tetë pikë shtatë*) lekë pa tvsh

13. .Operatori Ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” shpk Me mbështetës “ULZA” shpk “ALMO KONSTRUKSION” shpk

- Adresa: TiraneKamezLagjia Zall - Mneri Ri, RrugaNacionaleKamez, 1054

- NIPT-I : J91915001P

“ULZA” shpk

- Adresa: Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkiake nr 5, rruga Zef Jubani, ndertesa 15, hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019

-NIPT-I :J67902928O

- Vlera e ofertës: 53752156 (*pesëdhjetë e tre million e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë*) leke pa tvsh

14. OperatoriEkonomik “BEQIRI” shpk me mbështetës “METEO”shpk

- Adresa: Fier, Lagjia 15 Tetori, rruga Todi Shkurta, pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dyte

- NIPT-I :J98624801V

“METEO”shpk

- Adresa: fshati Cekin Rruga nacionale Gramsh-Elbasan ,Ndërtetsë private ,zona kadastrale NR.1362,Nr pasurie 6/76 ,pranë uzinës

- NIPT-I :L26310801C

- Vlera e ofertës: 57000313,5 (*pesëdhjetë e shtatë million e treqind e trembëdhjetë pikë pesë*) lekë pa tvsh

Nga pjesëmarrësit eshte skualifikuar operatori ekonomik:

1. Operatori Ekonomik “SPARTAK S.A” shpk + mbështetës Romeo Mankolli, “GJIKURIA” shpk, “KORSEL” shpk, “ALEKS DAJKO” Person Fizik, “SIMAKU” shpk, “AVDOLLI”shpk me vlerë të ofertës 46.316.207,32 (*dyzet e gjashtë million e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatë pikë tridhjetë e dy*) lekë pa tvsh.

-Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt :“Rehabilitim prita malore në infrastrukturën e dëmtuar Zëmlak e Plasë”

- Komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi se në Licencën NZ.3962/5 e paraqitur nga Operatori Ekonomik “SPARTAK S.A” shpk mungon NS 18-A(Punime topogjeodezike), e nevojshme për ekzekutimin e punëve të kontratës.

- Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë kontrollit të dokumentacionit të pasqyruar në sistemin elektronik konstatoi se Operatori Ekonomik “SPARTAK S.A” shpk dhe subjekti mbështetës “KORSEL” shpk se nuk kanë paraqitur *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8.*
 - Komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi se Operatori Ekonomik “SPARTAK S.A” shpk + mbështetës Romeo Mankolli, “GJIKURIA” shpk, “KORSEL” shpk, “ALEKS DAJKO” Person Fizik, “SIMAKU” shpk, “AVDOLLI”shpk nuk disponon Drejtuesin Teknik (Inxhinier Ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.
 - Komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi se Operatori Ekonomik “SPARTAK S.A” shpk + mbështetës Romeo Mankolli, “GJIKURIA” shpk, “KORSEL” shpk, “ALEKS DAJKO” Person Fizik, “SIMAKU” shpk, “AVDOLLI”shpk nuk disponon në stafin e tij Inxhinierin Gjeodet të kërkuar nga Autoriteti kontraktues.
 - Komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi se Operatori Ekonomik “SPARTAK S.A” shpk + mbështetës Romeo Mankolli, “GJIKURIA” shpk, “KORSEL” shpk, “ALEKS DAJKO” Person Fizik, “SIMAKU” shpk, “AVDOLLI”shpk nuk disponon në stafin e tij një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikate trajnimi për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”.*
 - Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë kontrollit të dokumentacionit të paraqitur nga sistemi elektronik konstatoi se Operatori Ekonomik “SPARTAK S.A” shpk + mbështetës Romeo Mankolli, “GJIKURIA” shpk, “KORSEL” shpk, “ALEKS DAJKO” Person Fizik, “SIMAKU” shpk, “AVDOLLI”shpk nuk disponon në stafin e tij 2 hekurkthyes, 3 karpentier,3 murator.
 - Komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi nga dokumentacioni i paraqitur nga sistemi elektronik se Operatori Ekonomik “SPARTAK S.A” shpk + mbështetës Romeo Mankolli, “GJIKURIA” shpk, “KORSEL” shpk, “ALEKS DAJKO” Person Fizik, “SIMAKU” shpk, “AVDOLLI”shpk nuk disponon 2 kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 10 ton deri 18 ton, 2 kamioncina me kapacitet mbajtes nga 1.5 deri 5 ton, 4 motobetoniere si dhe 2 tokmak elektrik të nevojshëm për realizimin e kontratës.
2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “INFINIT”shpk & “JOGI” shpk + Mbështetës “LTE Construction”shpkme *vlerë të ofertës 49.627.333,7(dyzet e nëntë million e gjashtëqind e njëzet e statë mijë e treqind e tridhjet e tre pikë shtatë) lekë pa tvsh*
- *Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt “Rehabilitim prita malore në infrastrukturën e dëmtuar Zëmlak e Plasë”*
 - Komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi nga dokumentacioni i paraqitur nga sistemi elektronik se BOE “INFINIT”shpk & “JOGI” shpk + Mbështetës “LTE Construction”shpk shpk nuk disponon në stafin e tij 2 karpentier.
3. Operatori Ekonomik “ASI-2A CO” shpk me vlerë të ofertës: 52.975.060,55 (*pesëdhjetë e dy million e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë pikë pesëdhjetë e pesë*) lekë pa tvsh -*Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt “Rehabilitim prita malore në infrastrukturën e dëmtuar Zëmlak e Plasë”*
- Komisioni i vlerësimit të ofertave konstatoi nga dokumentacioni i paraqitur nga sistemi elektronik se Operatori Ekonomik “ASI-2A CO” nuk disponon në stafin e tij 5 karpentier.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "ISOBAR CONSTRUCTION" shpk & "APIS COMSTRUCTION" shpk me vlerë të ofertës 53.628.908,7 (pesëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tetë pikë shtatë) lekë pa tvsh

-Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST me objekt "Rehabilitim prita malore në infrastrukturën e dëmtuar Zëmblak e Plasë"

• Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik konstatoi se përvoja e mëparshme e ngjashme e paraqitur nga operatori ekonomik "APIS CONSTRUCTION" shpk nuk plotëson kriteret sipas dst për kualifikim. Konkretisht Operatori ekonomik APIS CONSTRUCTION nuk plotëson vlerën për punë të ngjashme për një objekt të vetëm e cila duhet të jetë jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet gjithashtu nuk plotëson vlerën monetare totale e punëve të kryera, të marre së bashku e cila duhet të jete jo më e vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik VASHTEMLIA " shpk + mbështetës "SALILLARI" shpk, me adresë: Vashtemia shpk -Adresa: Korçe , Libonik , Vashtemi Rruga Nacionale Korçe Pogradec, Km. i 7, 500 m majtas rruges nacionale, zona kadastrale nr.3716, nr.pasurie 686/5, 686/6.- NIPTI: J64103054Q ,Salillari shpk -Adresa: Tirane ,Vore ,Lagjja" Vore", Rruga e Vjetër , Vore Marikaj, Km 1, Godina katërkatëshe, Kati i tretë, Nr.5- NIPTI: J62903125G se oferta e paraqitur ,me një vlerë të përgjithshme 45678041,84 (dyzet e pesë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyzet e një pikë tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Maliq sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO JOx

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

BASHKIA LEZHË

Drejtuar: Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “APIS CONSTRUCTION” SH.P.K & “ASI-2A CO” SH.P.K, perfaqesuar nga OE “APIS CONSTRUCTION” SH.P.K, me adrese Njesia bashkiake Nr. 2, Rruga “George W.Bush”, Pallati Nr. 1, Kati 3, Ap. Nr. 26 (Prane ures se Tabakve), Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur, Pune.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-14700-07-29-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i kanalit ujites dega kryesore Koterr-Kakarriq, Bashkia Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 Muaj nga data e nenshkrimit te Kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “BE - IS SH.P.K” SH.P.K, me Nuis K71412003A dhe me oferte ekonomike 74,690,525 (shtatedhjete e kater milion e gjashteqind e nentedhjete mije e peseqind e njezet e pese) Lek pa Tvsh,
2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “NDERTUESI 2014” SH.P.K, me Nuis L46827004L & “VARAKU E” SH.P.K, me Nuis J61902509S dhe me oferte ekonomike 53,925,720 (pesedhjete e tre million e nenteqind e njezet e pese mije e shtateqind e njezet) Lek pa tvsh,
3. Operatori Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis J63229466K dhe me oferte ekonomike 76,975,284.22 (shtatedhjete e gjashte milion e nenteqind e shtatedhjete e pese mije e dyqind e tetedhjete e kater pike njezete e dy) Lek pa Tvsh,
4. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” SH.P.K, me Nuis K07924803N dhe me oferte ekonomike 77,014,048.28 (shtatedhjete e shtate milion e katermbedhjete mije e dyzete e tete pike njezete e tete) Lek pa Tvsh,
5. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “APIS CONSTRUCTION” SH.P.K, me Nuis L41513008A & “ASI-2A CO” SH.P.K, me Nuis K53002402C dhe me oferte ekonomike 73,092,797.12 (shtatedhjete e tre milion e nentedhjete e dy mije e shtateqind e nentedhjete e shtate pike dymbedhjete) Lek pa Tvsh,
6. Operatori Ekonomik “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K, me Nuis L77127002C dhe me oferte ekonomike 68,694,149 (gjashtedhjete e tete milion e gjashteqind e nentedhjete e kater mije e njeqind e dyzet e nente) Lek pa Tvsh,

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K, me Nuis L77127002C,

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.2, te kushteve te veçanta te kualifikimit, ku parashikohet se: *Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatë të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:*

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-1 A Punime gërmimi në tokë.

NP-7 C Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

NP-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS-18 A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te paraqesin licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim e cila përfshin minimalisht kategoritë e mesiperme te percaktuara ne kriterin 2.3.2 te DST-se.

Nga verifikimi ne SPE i Licenses se Zbatimit te subjektit “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K, me Nr. NZ. 7614, date 24.01.2018, rezulton se ky operator ekonomik nuk disponon kategorite e licenses te kerkuar ne DST, konkretisht:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-7 C Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

NP-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS-18 A Punime topogjeodezike.

Po ashtu, nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE verehet se ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te Operatorit Ekonomik “LODI CONSTRUCTION” SH.P.K eshte deklaruar mbeshtetje te kapaciteteve nga ana e subjektit “Alko Impex General Construction”, per kapacitetin teknik per “Pikat 2.3.2, NP7 B, NP12 A, Ns- 18 A, ne lidhje me Pikat 2.3.4 Staf i ing, Pika 2.3.5, Staf i, Pika2.3.6 Staf, Pika2.3.7 Mjetet”

përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “LIQENI VII” SH.P.K & “VARAKU E” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “LIQENI VII” SH.P.K, me Nuis K01730502W & “VARAKU E” SH.P.K, me Nuis J61902509S, *skualifikohet*.

VI- Operatori Ekonomik “Rroku GUEST” SH.P.K, me Nuis K87921701H,

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se ky operator nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose

entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për permbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “Rroku GUEST” SH.P.K, për mos permbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “Rroku GUEST” SH.P.K, me Nuis K87921701H, *skualifikohet*.

VII-Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” SH.P.K, me Nuis 810802422,

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se nuk plotëson kriterin 2.3.1, ku parashikohet se: *Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,*

ose

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

25. Formularin e vlerësimit;

26. Kontratën/Kontratat;

27. Situacionin përfundimtar;

28. Faturat tatimore;

29. Aktin e kolaudimit;

30. Çertifikatë e marrje në dorezim/ Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim .

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

17. Kontratë siper marrje;

18. Situacionin përfundimtar;

19. Fatura tatimore;

20. Akt kolaudimi objekti;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Theksojme se për të permbushur pikën 2.3.1, në lidhje me dëshmitë për përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet të paraqesin dokumentacion për realizimin e punëve të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet për një objekt të vetëm ose punë të ngjashme ku vlera totale e punëve është jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se per pambushjen e ketij kriteri OE ka paraqitur ne SPE kontraten me nr. 48/2016, date 28.09.2016, me object: *Asfaltimi I rruges Dol-Kusar- Goden, Gjakove faza e II-te*, me vlere te kontrates prej 799,650.04 euro.

KVO sqaron se data e shpalljes se njoftimit te kontrates objekt prokurimi eshte data 05.06.2024 dhe per rrjedhoje 5 vite nga kjo date per efekt perlllogaritje te puneve te ngjashme eshte data 05.06.2019.

Nga verifikimi i evidencave te pageses rezulton se pagesat jane realizuar nepermjet faturave per periudhen nga data 06.12.2016 deri me date 28.10.2020, ku verehet se vetem faturat me nr. 25/19, date 06.06.2019, me vlere 64,088.27 euro, fatura nr. 66/19, date 01.11.2019, me vlere 93,119.92 euro, fatura me nr. 44/20, date 28.10.2020, me vlere 31,315.97 euro, fatura nr. 46/20, date 02.11.2020, me vlere 67,420.75 euro, ku vlera totale te faturave te sipercituara eshte prej 191,856.6 euro, fatura te cilat jane leshuar dhe vertetojne punime te kryera brenda afatit 5 vjecar nga data e publikimit te kontrates.

Po ashtu, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se per pambushjen e ketij kriteri OE ka paraqitur ne SPE kontraten me nr. 074/2013, me object: *Zgjerimi I rruges ne qytetin e Pejes (Peje – Prishtine)*, me vlere te kontrates prej 1, 932,075.02 euro, ku nga verifikimi rezulton se punimet kane perfunduar ne vitin 2018, e cila rezulton jashte afatit prej 5 vitesh nga shpallja e kesaj kontrate.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave thekson se per pambushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te paraqesin pune te ngjashme me vlere prej 98,714,177.5 leke pa Tvsh te realizuar ne nje pune te vetme ose pune te ngjashme me vlere te pergjithshme prej 394,856,710 pa tvsh te realizuara brenda 5 viteve nga shpallja e kontrates.

Si me siper, operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbylljen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin

publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “RSM COMPANY” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të veçanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “RSM COMPANY” SH.P.K, me Nuis 810802422, *skualifikohet*.

VIII-Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “ZEQILLARI” SH.P.K, me Nuis L61912024O & “BESTA” SH.P.K, me Nuis J62903182B,

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ka paraqitur oferte teknike në përputhje me kërkesat e pikës 4.4/A, të DST-se.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.9, të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon:

- a. 1 (nje) Impiant prodhimi Inerte
- b. 1 (nje) Impiant prodhimi Asfalti

Për impiantin e prodhimit të inerteve ose asfaltit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit është me qera ose kontrate bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave ose bashkëpunimit. (KVO do të verifikojë nepermjet QKB nëse impianti i prodhimit të inerteve/asfaltit është i pajisur me license 3.1.B, në rast të kundërt OE do të skualifikohet”).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verë se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të disponojnë në pronësi, qira ose kontrate bashkëpunimi “*Impiant prodhimi Inerte dhe Impiant prodhimi Asfalti*” dhe në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vertetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronësinë ndërsa në rast se impianti i prodhimit të inerteve ose asfaltit është me qera ose kontrate bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/bashkëpunimit.

Nga verifikimi në QKB rezulton se asnjëri nga anëtarët e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik nuk disponon leje mjedisore QKL me Kod III.1.B për “*Impiant prodhimi Inerte*” dhe për “*Impiant prodhimi Asfalti*” dhe po ashtu nga verifikimi në SPE rezulton se asnjëri nga anëtarët e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik nuk ka paraqitur kontratën e qirave ose bashkëpunimi me ndonjë prodhues inertesh apo asfalti.

Sa më sipër duke qenë se Bashkimi I Operatoreve Ekonomik nuk disponon leje mjedisore QKL me Kod III.1.B për “*Impiant prodhimi Inerte*” apo “*Impiant prodhimi Asfalti*”, si dhe duke qenë se nuk është paraqitur kontrate qiraje ose bashkëpunimi me ndonjë prodhues inertesh apo asfalti ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nën 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “ZEQILLARI” SH.P.K & “BESTA” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “ZEQILLARI” SH.P.K, me Nuis L61912024O & “BESTA” SH.P.K, me Nuis J62903182B, *skualifikohet*.

IX- Operatori Ekonomik “S I R E T A 2F” SH.P.K, me Nuis K51501008J,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit konstatohet se me procesverbalin Nr. 01, datë 19/07/2024 për vleresimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale në administrim të Bashkisë Lezhe”, Komisioni i Vleresimit të Ofertave ka kualifikuar Operatorin Ekonomik “SIRETA 2F” SH.P.K, me Nuis K51501008J dhe me datën 23.07.2024, i ka kërkuar me anë të sistemit të Prokurimeve Elektronike dorezimin e dokumentacionit fizik origjinal ose kopje të njehesuar me origjinalin sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike deri me datën 01.08.2024.

Komisioni i vleresimit të Ofertave, verifikoi në zyrën e protokoll-arkives regjistrat e shkresave hyres ku nga verifikimi rezultoi se Operatori Ekonomik “SIRETA 2F” SH.P.K, me Nuis K51501008J nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion apo shkresë pranë Bashkisë Lezhe nga data e kërkesës së Autoritetit Kontraktor në SPE deri në datën 01.08.2024 dhe madje as deri në datën e vleresimit të dokumentacionit.

Theksojme se ne nenin 26, pika 6, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik” te ndryshuar, parashikohet se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave thekson se cdo operator ekonomik i cili kualifikohet paraprakisht pas vleresimit te dokumentacionit ne SPE, ka detyrimin ligjor te paraqitjes fizikisht prane Autoritetit Kontraktor te gjithë dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike ne perputhje me nenin 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik”, te ndryshuar.

Per sa me lart, Komisioni i Vleresimit te Ofertave konstaton se Operatori Ekonomik “SIRETA 2F” SH.P.K, me Nuis K51501008J nuk ka paraqitur asnje dokumentacion fizik origjinal apo kopje te njehesuar me origjinalin duke mos permbushur asnje nga kriteret e parashikuara ne DST.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e

nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “S I R E T A 2F” SH.P.K, per mos permbushje te kriterave te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “S I R E T A 2F” SH.P.K, me Nuis K51501008J, *skualifikohet*.

X- Operatori Ekonomik “ALB TIEFBAU” SH.P.K, me Nuis J66703049C,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te procedures se prokurimit konstatohet se me procesverbalin Nr. 01, date 19/07/2024 për vleresimin e dokumentacioni per proceduren e prokurimit me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne administrim te Bashkise Lezhe”, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka kualifikuar paraprakisht Operatorin Ekonomik “ALB TIEFBAU” SH.P.K, me Nuis J66703049C dhe me daten 23.07.2024 i ka kerkuar me ane te Sistemit te Prokurimeve Elektronike dorezimin e dokumentacionit fizik origjinal ose kopje te njehesuar me origjinalin sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike deri me daten 01.08.2024.

Ne vijim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar prane Bashkise Lezhe, me ane te shkreses me Nr. 13172 protokolli hyres, date 01.08.2024, nga OE “ALB TIEFBAU” SH.P.K, konstatoi se:

Se pari, në shtojcën 7, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1, të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se: “Operoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

31. Formularin e vlerësimit;

32. Kontratën/Kontratat;

33. Situacionin përfundimtar;

34. Faturat tatimore;

35. Aktin e kolaudimit;

36. Çertifikatë e marrje në dorezim/ Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim.

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

21. Kontratë siper marrje;

22. Situacionin përfundimtar;
23. Fatura tatimore;
24. Akt kolaudimi objekti;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”.

Theksojme se për te permbushur piken 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për pervojen e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet te paraqesin dokumentacion per realizimin e puneve te ngjashme me vlere jo me te vogel se 50 % e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet për një objekt të vetëm ose punë të ngjashme ku vlera totale e punëve është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Dokumentacioni që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin është si më poshtë vijon:

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Faturat tatimore;
5. Aktin e kolaudimit;
6. Çertifikatë e marrje në dorëzim/ Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim .

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë siper marrje;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Fatura tatimore;
4. Akt kolaudimi objekti;

Ky dokumentacion duhet të pasqyrojë punime të ngjashme të realizuar brenda pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Verehet se për përmbushjen e këtij kriteri, OE ka paraqitur në SPE kontrata të lidhur ndërmjet tij dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me objekt: “Rikonstruksion i rruges Balldren-Bend, Bashkia Lezhe” dhe ka bashkëngjitur Formularin e vlerësimit, Kontratën/Kontratat, Situacionin përfundimtar, Faturat tatimore, Aktin e kolaudimit, por nuk ka paraqitur “Çertifikatë e marrje në dorëzim/ Çertifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim” sipas kërkesave të pikës 2.3.1/a, të kritereve të vecante të parashikuara në DST.

Po ashtu, verehet se për përmbushjen e këtij kriteri OE ka paraqitur në SPE kontratën të lidhur ndërmjet tij dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me objekt: “Ndertimi i rrjetit rrugor dhe infrastrukture urbane të zonës Lezhe, Njesia Administrative Lezhe, Bashkia Lezhe” dhe ka bashkëngjitur Formularin e vlerësimit, Kontratën/Kontratat, Situacionin përfundimtar, Aktin e kolaudimit, por nuk

ka paraqitur “*Faturat tatimore*” dhe “*Çertifikatën e marrje në dorezim/ Çertifikatën e përkohshme e marrjes në dorëzim*” sipas kërkesave të pikes 2.3.1/a, të kriterëve të vecantë të parashikuar në DST.

Gjithashtu për përbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1, OE ka paraqitur në SPE edhe kontratën të lidhur ndërmjet tij dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me objekt: “Rikonstruksion i rruges së Velipojes, Segmenti Harku i Berdices- Baks, Lot III”, kontrate kjo e nënshkruar me datë 13.06.2017 nga palet.

KVO sqaron se data e shpalljes së njoftimit të kontratës objekt prokurimi është data 05.06.2024 dhe për rrjedhojë 5 vite nga kjo datë për efekt përlogaritje të punëve të ngjashme është data 05.06.2019.

Nga verifikimi në SPE, rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur formular vleresimi nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me datë fillimi punimesh 15.06.2017 dhe datë mbarimi punimesh 01.11.2019, i shoqëruar me situacione dhe faturat tatimore ku vërehet se:

- Fatura Nr. 3, datë 30.06.2017, me vlerë prej 20,836,312 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 5, datë 31.07.2017, me vlerë prej 39,971,197 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 7, datë 31.08.2017, me vlerë prej 42,148,078 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 12, datë 19.09.2017, me vlerë prej 24,906,050 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 13, datë 30.09.2017, me vlerë prej 34,666,617 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 15, datë 31.10.2017, me vlerë prej 68,802,590 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 17, datë 30.11.2017, me vlerë prej 68,174,645 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 18, datë 06.12.2017, me vlerë prej 61,021,852 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 1, datë 31.01.2018, me vlerë prej 57,906,662 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 4, datë 28.02.2018, me vlerë prej 46,718,634 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 10, datë 31.03.2018, me vlerë prej 32,760,407 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 11, datë 30.04.2018, me vlerë prej 18,485,046 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 19, datë 31.05.2018, me vlerë prej 50,206,800 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 20, datë 30.06.2018, me vlerë prej 59,945,290 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 23, datë 31.07.2018, me vlerë prej 44,064,551 Leke pa Tvsh, (jashtë afatit prej pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 22, datë 19.09.2019, me vlerë prej 52,700,141 Lek pa Tvsh, (brenda pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),

- Fatura Nr. 111, date 05.12.2019, me vlere prej 16,559,820 Lek pa Tvsh, (brenda pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),
- Fatura Nr. 112, date 05.12.2019, me vlere prej 1,087,077 Lek pa Tvsh, (brenda pese viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës),

Per rrjedhoje vetem Fatura me Nr. 22, date 19.09.2019, me vlere prej 52,700,141 Lek pa Tvsh, Fatura me Nr. 111, date 05.12.2019, me vlere prej 16,559,820 Lek pa Tvsh dhe Fatura me Nr. 112, date 05.12.2019, me vlere prej 1,087,077 Lek pa Tvsh, me vlere totale punimesh prej 70,347,038 Leke pa Tvsh jane leshuar brenda 5 (pese) viteve nga nenshkrimi i kontrates.

Per sa me lart, konstatohet se vetem fatura Fatura me Nr. 22, date 19.09.2019, Fatura me Nr. 111, date 05.12.2019 dhe Fatura me Nr. 112, date 05.12.2019, me vlere totale punimesh prej 70,347,038 Leke pa Tvsh, vertetojne punime te realizuara brenda afatit 5 (pese) vjecar nga shpallja e njoftimit te kontrates.

Sa konstatuam me siper, Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per me teper edhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) ne vendimin nr. 670/2019, ka mbajtur te njejtin qendrim ku nder te tjera ka theksuar se: *“Në kriteret e veçanta të kualifikimit të hartuar nga autoriteti kontraktor, si edhe vetë parashikimeve të aktit nënligjor në zbatim të ligjit, KPP gjykon se operatorët ekonomikë, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme në kontratat për punë publike duhet të dorëzojnë kontrata të përfunduara, pra me anë të dokumentacionit duhet të dëshmojnë se kanë realizuar me sukses punime të përfunduara brenda 3 viteve të fundit (afati sipas parashikimeve ligjore te kohes)”*.

Gjithashtu ne kete vendim Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), ka arsyetuar se: *“Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm”*.

Si perfundim operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa me siper duke qene se per pune te ngjashme nuk ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit, kriteri 2.3.1 konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, në shtojcën 7, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7, të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se: *“Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:*

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 18 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	3

2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 12 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 3.5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
4	Kamion me Vinc	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
5	Eskavator me zinxhire	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
6	Eskavator me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
7	Fadrome me goma	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
8	Minieskavator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
9	Asfaltoshtruese	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
10	Grejder	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
11	Rimorkjator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
12	Autobot uji	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
13	Rrul Vibrues	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
14	Prerese asfalti	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
15	Aparat topogjeodezik me GPS	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - çertifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - çertifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndërsa për mjete të marra me qera/kontrate bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave/ Kontrate Bashkëpunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

KVO thekson se per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te paraqesin si me poshte:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: - certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.

Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase/ bashkëpunimit.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe per permbushjen e ketij kriteri rezulton se:

I. KVO veren se per “Eskavatorin me goma”, me targe AHMT 77, i deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet ne dispozicion me ane te kontrates se qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetes, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se OE nuk ka paraqitur kontraten e qirase, certifikaten e pronesise, lejen e qarkullimit, certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin vjetor, Taksat vjetore, Lejen e transportit si dhe fotot e kerkuara ne DST.

II. KVO veren se per “Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 3.5 ton”, me targa AA274TE, deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet ne dispozicion me ane te kontrates se qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetes, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit Teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, si dhe fotot e kerkuara ne DST.

Po ashtu, verehet se per mjetin “Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 3.5 ton”, me targa AA 274 TE, per disponimin e ketij mjeti, ky operator ekonomik ka paraqitur nje kontrate te thjeshte qiraje lidhur ndermjet tij dhe subjektit “ARDMIR” Shpk, i cili nga verifikimi nuk rezulton te jete pronar i mjetit per te cilin eshte lidhur kontrata e qirase pasi Kamionçina me kapacitet mbajtës min 3.5 ton, me targa AA 274 TE, rezulton te jete ne pronesi te subjektit “ANXHELO-BR 2007”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se subjekti “ANXHELO-BR 2007” me ane te kontrates noteriale te qirase me Nr. Repertori 655 dhe Nr. Koleksioni 537, date 18.06.2023, i ka dhene me qira subjektit “ARDMIR” Shpk kamionçinen me kapacitet mbajtës min 3.5 ton, me targa AA 274 TE, me nje afat prej pese vitesh duke i dhene te drejten e perdorimit te sendit por jo te drejten per dhenien me qira ose perdorim paleve te treta.

III. KVO veren se per “Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 12 ton”, me targa AA760LK, i deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet ne dispozicion me ane te kontrates se qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetes, pasi nga

verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, lejen e transportit, si dhe foto e kerkuara në DST.

IV. KVO verën se për “Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 3.5 ton”, me targa AA173DA i deklaruar në Formularin Permbledhës të Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet në dispozicion me anë të kontratës së qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetës, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, si dhe fotot e kerkuara në DST.

V. KVO verën se për “Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 12 ton”, me targa AB665IS, i deklaruar në Formularin Permbledhës të Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet në dispozicion me anë të kontratës së qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetës, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, lejen e transportit si dhe foto e kerkuara në DST.

VI. KVO verën se për “Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 12 ton”, me targe AA791XF, i deklaruar në Formularin Permbledhës të Vetedeklarimit nga operatori ekonomik si mjet në dispozicion me anë të kontratës së qirase, nuk disponon dokumentacion mbeshtetës, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhe rezulton se nuk ka paraqitur çertifikatën e kontrollit Teknik, siguracionin vjetor, taksat vjetore, lejen e transportit, si dhe foto e kerkuara në DST.

Sa me sipër bazuar në konstatimet e sipercituara, kriteri 2.3.7 i kushteve të vecanta të kualifikimit konsiderohet i papërbushur.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbeshtetur nënin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nënin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e

përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ALB TIEFBAU” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ALB TIEFBAU” SH.P.K, me Nuis J66703049C, *skualifikohet*.

XI- Operatori Ekonomik “A.L-ASFALT” SH.P.K, me Nuis K81511508A,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit konstatohet se me procesverbalin Nr. 01, date 19/07/2024 për vlerësimin e dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale në administrim të Bashkisë Lezhe”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar paraprakisht Operatorin Ekonomik “A.L-ASFALT” SH.P.K, me Nuis K81511508A dhe me datën 23.07.2024 i ka kërkuar me ane të Sistemit të Prokurimeve Elektronike dorëzimin e dokumentacionit fizik origjinal ose kopje të njehesuar me origjinalin sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike deri me datën 01.08.2024.

Në vijim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar pranë Bashkisë Lezhe, me ane të shkresës me Nr. 13231 protokollin hyrës, date 01.08.2024, nga OE “A.L-ASFALT” SH.P.K, konstatoi se:

Në shtojcën 7, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.5, të dokumenteve të procedurës së prokurimit parashikohet se: Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si me poshtë:

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Ing. Gjeodet	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	2 (dy)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeodet (topograf)	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Punonjes për punime në Rruge dhe Asfaltim	5 (pese)	Çertifikate/ Deshmite profesionale
- Shofer	5 (pese)	Leje Drejtimi
- Manovrator	5 (pese)	Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë për muajin Prill 2024.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) që nuk është leshuar sipas legjislacionit përketes të arsimimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përketes të ligjit të prokurimit publik.

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punonjesit në certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues	Numri identifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Në rast se leshuesi është institucion privat)
-----	---------------------------	--	---	--	--

			i		
			certifikates/diplomes		
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës së mesiperme, të cila duhet të dorëzohet në fazën e ofertimit në SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Theksojme se për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin për stafin e sipërcituar formularin permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojces perkatese të DST-se dhe tabelës së mesiperme, të cila duhet të dorëzohet në fazën e ofertimit në SPE. Ndersa dokumentacioni provues si kontratat individuale të punës, Diplomat Universitare/ Diplomat e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale, Certificate e Aftësisë Profesionale (CAP), Lejet Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori si dhe listepagesat e shoqërisë për muajin Prill 2024 duhet të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se OE për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur Formularin Permbledhes të Vetedeklarimit në të cilin për disponimin e 5 (pese) punonjësve “Për punime në Rruge dhe Asfaltim”, ka deklaruar si më poshtë:

“...Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.

Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:

- 1.Xhevahir Deliallisi, me profesion Specialist për Punime në Rruge dhe Asfaltim, i punësuar pranë shoqërisë tone, i paisur me certificate trajnimi AQS/T/S125522024.
- 2.Ivan Deliallisi, me profesion Specialist për Punime në Rruge dhe Asfaltim, i punësuar pranë shoqërisë tone, i paisur me certificate trajnimi AQS/T/S1255122024.
- 3.Dorjan Elezi, me profesion Specialist për Punime në Rruge dhe Asfaltim, i punësuar pranë shoqërisë tone, i paisur me certificate trajnimi AQS/T/S125532024.
- 4.Isuf Saliu, me profesion Specialist për Punime në Rruge dhe Asfaltim, i punësuar pranë shoqërisë tone, i paisur me certificate trajnimi AQS/T/S1255422024.
- 5.Mexhit Shani, me profesion Specialist për Punime në Rruge dhe Asfaltim, i punësuar pranë shoqërisë tone, i paisur me certificate trajnimi AQS/T/S1255422024.....”

Për rrjedhojë, KVO bazuar në nenin 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, të ndryshuar, mori të mirëqenë deklarin e OE-se në formularin

Permbledhes duke kualifikuar kete Operator Ekonomik ne fazen e pare te vleresimit te ofertave ne SPE.

 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Fatura tatimore;
 5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;

Ndërsa për punët e ngjashme të realizuara si nënkontraktor duhet të paraqiten e kontrata e nënkontraktimit ku përcaktohen zërat e punimeve si dhe miratimin e Autoritetit kontraktor/investitorit.

Ky dokumentacion duhet të pasqyrojë punime të ngjashme të realizuar brenda pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Verehet se për pëmbushjen e këtij kriteri, OE ka paraqitur si punë të ngjashme në SPE:

- 1- Kontraten, me objekt: “Mbrotjtje lumore nga km 09+040 deri km 09+240 në aksin Milot Morine”, me vlerë prej 160,701,102.13 Lek pa Tvsh,
- 2- Kontraten, me objekt: “Loti II” “Mbrotjtje nga permbytja nga lumi Osum në Uznove, Berat”, me vlerë prej 42,298,410 Lek pa TVSH,
- 3- Kontraten, me objekt: “Për kryerjen e punimeve të ndertimit, lidhur me projektin “Për ndertimin, Permiresimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Autostradës Milot-Morine”,

-Në lidhje me Kontraten, me objekt: “Mbrotjtje lumore nga km 09+040 deri km 09+240 në aksin Milot Morine”, verehet se kjo kontratë është lidhur ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqipëtar, në cilësinë e Investitorit dhe Operatorit Ekonomik “SALILLARI” SH.P.K, në cilësinë e Sipermarresit, ku bashkëngjitur gjendet Formulari i vlerësimit, Kontrata, Situacioni përfundimtar, Faturat tatimore dhe

Aktin e kolaudimit por nuk ka paraqitur “Çertifikatën e marrje në dorezim/ Çertifikatën e përkohshme e marrjes në dorëzim” sipas kerkesave te pikes 2.3.1, te kriterëve te vecante te parashikuar ne DST.

-Ne lidhje me Kontraten, me objekt: “Loti II” “Mbrojtje nga permytja nga lumi Osum ne Uznove, Berat”, verehet se kjo kontrate eshte lidhur ndermjet Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit Korçe, ne cilesine e Investitorit dhe Operatorit Ekonomik “SALILLARI” SH.P.K, ne cilesine e Sipermarresit, ku bashkengjitur gjendet Formulari i vlerësimit, Kontrata, Situacioni përfundimtar, Akti i kolaudimit, Faturat tatimore dhe Çertifikata e marrjes në dorezim sipas kerkesave dhe ne perputhje me piken 2.3.1/a, te kriterëve te vecante te DST-se.

-Ne lidhje me Kontraten, me objekt: “Per kryerjen e punimeve te ndertimit, lidhur me projektin “Per ndertimin, Permiresimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Autostrades Milot-Morine”, verehet se kjo kontrate eshte lidhur ndermjet dy shoqerive, konkretisht “Albanian Highway Concession” SH.P.K, ne cilesine e Investitorit dhe Shoqerise “SALILLARI” SH.P.K, ne cilesine e Sipermarresit, ku bashkengjitur gjenden Formulari i vlerësimit; Kontrata per kryerjen e punimeve te ndertimit, Situacionet, Faturat tatimore dhe Akti i kolaudimit.

KVO duke marre ne konsiderates se per punet e ngjashme të realizuara me autoritete publike, OE duhet të paraqesin: Formularin e vlerësimit, Kontratën, Situacionin përfundimtar, Akt Kolaudimi, Faturat tatimore dhe Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim, ndersa per punet e ngjashme të realizuara me sektorin privat, OE duhet të paraqesin Kontratë sipermarrje, Leje per kryerje punimesh, Situacionin përfundimtar, Fatura tatimore dhe Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim, per efekt te percaktimit te dokumentacionit te nevojshem per permbushjen e pikes 2.3.1, te kriterëve te vecanta beri nje verifikim te thjeshte ne faqen zyrtare te Qendres Kombetare te Biznesit www.qkb.gov.al, lidhur me pronesine publike apo private te shoqerise “Albanian Highway Concession” SH.P.K, ku nga verifikimi rezultoi se Shoqeria “Albanian Highway Concession” SH.P.K eshte shoqeri me 100 % kapital privat.

Sa argumentuam me siper lidhur me punen e ngjashme me objekt: “Per kryerjen e punimeve te ndertimit, lidhur me projektin “Per ndertimin, Permiresimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Autostrades Milot-Morine” nga verifikimi ne SPE, rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur vetem Formularin e Vleresimit te leshuar nga shoqeria “Albanian Highway Concession” SH.P.K, Kontratë sipermarrje, Situacionin përfundimtar, Fatura tatimore dhe Aktin e Kolaudimit dhe Çertifikatën e përkohshme e marrjes në dorëzim por nuk ka paraqitur Lejen per kryerje punimesh sipas kerkesave te pikes 2.3.1, te kriterëve te vecante te DST-se.

Per me teper nga shqyrtimi i kontrates se koncesionit, miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 870, datë 14.12.2016 PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, “PËR NDËRTIMIN, PËRMIRËSIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E AUTOSTRADËS MILOT–MORINË”, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, DHE KONSORCIUMIT “CATALYST VIVA DAS GENERAL CONTRACTING, LLC – SALILLARI SHPK - BEE TECH – VIOLIAP ATEVE – KASTRATI SHA” verehet se ne kete kontrate eshte miratuar nje liste prej 10

(dhjete) subjektsh te propozuar si nenkontraktore te mundshem konkretisht ne piken 4.1 te koncesionit ku parashikohet se :

4. Nenkontratat

“4.1 Autoriteti Kontraktor pranon se me pranimin e ofertes se Koncesionit ka miratuar edhe nenkontraktoret e propozuar”.

Po ashtu nga shqyrtimi i kontrates se koncesionit verehet se miratimi i nenkontraktoreve qe bejne pjese ne listen e miratuar paraprakisht te cilet do te kryejne punime me porosi te koncesionarit do te behet rast pas rasti nga autoriteti kontraktor ne perputhje me piken 4.2 te kontrates se koncesionit ku parashikohet se:

“4.2 Koncesionari nuk hyn ne asnje marreveshje nenkontraktore pa pelqimin paraprak me shkrim te autoritetit kontraktor”.

Gjithashtu KVO, veren se ne kriterin 2.3.1 te kushteve te vecanta te DST-se parashikohet se:

“Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit”.

Sa argumentuam me siper lidhur me punen e ngjashme me objekt: “Per kryerjen e punimeve te ndertimit, lidhur me projektin “Per ndertimin, Permiresimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Autostrades Milot-Morine” nga verifikimi ne SPE, rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur vetem Formularin e Vleresimit te leshuar nga shoqeria “Albanian Highway Concession” SH.P.K, Kontratë sipermarrje, Situacionin përfundimtar, Fatura tatimore, Aktin e Kolaudit, Çertifikatën e përkohshme e marrjes në dorëzim dhe Shkrese me nr. 1512/3, date 09.02.2021 nga Ministria e Infrastruktures mbi realizimin me sukses te punimeve per periudhen deri me date 09.02.2020 sipas vleresimit te inxhinierit te pavarur, por nuk ka paraqitur pelqimin paraprak apo miratimi nga ana e autoritetit kontraktor per marreveshjen kontraktore dhe Lejen per kryerjen e punimeve sipas kerkesave te pikes 2.3.1, te kriterive te vecante te DST-se.

Si perfundim KVO thekson se vetem per kontraten e lidhur ndermjet Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit Korçe, ne cilesine e Investitorit dhe Operatorit Ekonomik “SALILLARI” SH.P.K, ne cilesine e Sipermarresit, me objekt: “Loti II” “Mbrotje nga permbytja nga lumi Osum ne Uznove, Berat” dhe me vlere kontrate prej 42,298,410 Lek pa TVSH eshte paraqitur dokumentacion ne perputhje kerkesat e kriterit 2.3.1 te DST-se, por edhe kjo kontrate nuk eshte ne masen e 50 % te vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet duke bere qe ky operator ekonomik te mos plotësoje kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave pamvaresisht pervojës disa vjecare te Shoqerise “Salillari” SH.P.K ne fushen e ndertimit te infrastruktures publike rithekson dhe nje here bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotesimit te kriterive te vecanta te paraqitura ne DST, per tu permbushur njesoj nga te gjithe Operatoret Ekonomik pjesemarrës është i

një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerine dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën duke e konsideruar te përbushur kriterin 2.3.1 te kushteve te vecanta.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “SALILLARI” SH.P.K, për mos përbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “SALILLARI” SH.P.K me nipt J62903125G, *skualifikohet*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike “RAFIN COMPANY” SH.P.K, me nipt L52125110A & “2Z KONSTRUKSION”, me nipt J63229466K dhe me oferte ekonomike 214,624,027.51 (dyqind e katermbdhjete milion e gjashtëqind e njetete e kater mije e njetete e shtate pike pesedhjetete e nje) Lek pa tvsh,
2. Bashkimi i operatoreve ekonomike “STERKAJ” SH.P.K, me nipt J68310708M & “BAJRAMI N.” SH.P.K, me nipt K02727202O dhe me oferte ekonomike 235,024,324.03 (dyqind e tridhjetete e pese milion e njetete e kater mije e treqind e njetete e kater pike zero tre) Lek pa tvsh.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni prane zyrave te administrates se Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit Lezhe brenda 10 (dhjete) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

BASHKIA SHKODËR

Drejtuar: KEVIN KONSTRUKSION sh.p.k NUIS K71401004W.Adresa: Rruga Adem Jashari, Ndertesa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake Nr.5 , Tirane

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-13179-07-15-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës: "Rikonstrukcion Shkolla "Ndre Mjeda"

Fondi limit 198,944,392.07 (njëqind e nëntëdhjetë e tetëmilion e nëntëqind e dyzet e katërmijë e treqind e nëntëdhjetë e dy pikë zero shtatë).

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 (dymbëdhjete) muaj.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 40 datë 22 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1-Operatori ekonomik KEVIN KONSTRUKSION sh.p.k NUIS K71401004W

Vlera pas korigjimit aritmetik 131,777,121.25(Njeqind e tridhjetë e njemilion e shtateqind e shtatedhjetë e shtatemije e njeqind e njezet e nje pike njezet e pese) leke pa tvsh

2.Bashkimi i operatoreve ekonomik Nika sh.p.k. NUIS J76705047U & MANE/S sh.p.k, me NUIS J64103865K perfaqesuar nga Nika sh.p.k.

Vlera 132,682,895.99 leke pa TVSH (Njeqind e tridhjetë e dymilion e gjashteqind e tetedhjetë e dymije e teteqind e nentedhjetë e pese pike nentedhjetë e nente)

3.Operatori ekonomik DION-AL sh.p.k. NUIS K67917301H

Vlera 137,509,744.80 leke pa TVSH(Njeqind e tridhjetë e shtatemilion e peseqind e nentemije e shtateqind e dyzet e kater pike tetedhjetë)

4.Bashkimi i operatoreve ekonomik BIBA-X sh.p.k NUIS K32618815N & PEPA GROUP GROUP sh.p.k, NUIS L42215009L& Progres Shkodra sh.p.k NUIS M17324001D perfaqesuar nga Progres Shkodra sh.p.k

Vlera 138,613,433 leke pa TVSH (Njeqind e tridhjetë e tetemilion e gjashteqind e trembedhjetemije e katerqind e tridhjetë e tre)

5.Bashkimi i operatoreve ekonomik BE-IS SH.P.K NUIS K71412003A& S.M.O.UNION sh.p.k, me NUIS J66902042Q perfaqesuar nga S.M.O.UNION sh.p.k.

Vlera 139,188,576.90 leke pa TVSH (Njeqind e tridhjetë e nentemilion e njeqind e tetedhjetë e tetemije e peseqind e shtatedhjetë e gjashte pike nentedhjetë)

6.Bashkimi i operatoreve ekonomik NDERTUESI 2014 sh.p.k NUIS L46827004L & "SHKELQIMI 07" sh.p.k, me NUIS K68121808W perfaqesuar nga NDERTUESI 2014 sh.p.k.

Vlera 139,188,877 leke pa TVSH (Njeqind e tridhjetë e nentemilion e njeqind e tetedhjetë e tetemije e teteqind e shtatedhjetë e shtate)

7.Operatori ekonomik NG STRUCTURES sh.p.k NUIS L79326502O

Vlera 139,697,825 leke pa TVSH (Njeqind e tridhjetë e nentemilion e gjashteqind e nentedhjetë e shtatemije e teteqind e njezet e pese)

8.Bashkimi i operatoreve ekonomik ED KONSTRUKSION sh.p.k NUIS K61625001I & GLAVENICA sh.p.k, me NUIS K17710805A perfaqesuar nga GLAVENICA sh.p.k.

Vlera 144,370,584.32 leke pa TVSH (Njeqind e dyzet e katermilion e treqind e shtatedhjetemije e peseqind e tetedhjetë e kater pike tridhjetë e dy)

9.Bashkimi i operatoreve ekonomik VALONA KONSTRUKSION sh.p.k NUIS K26330202E & VIBTIS sh.p.k, me NUIS L02103503S perfaqesuar nga VALONA KONSTRUKSION sh.p.k.

Vlera 145,769,600 leke pa TVSH (Njeqind e dyzet e pesemilion e shtateqind e gjashtedhjetë e nentemije e gjashteqind)

10.Bashkimi i operatoreve ekonomik B-93 sh.p.k NUIS J62903508R & B93 II sh.p.k, NUIS L52209050O& GRAMA sh.p.k NUIS J77304712J perfaqesuar nga B93 II sh.p.k

Vlera 146,974,932 leke pa TVSH (Njeqind e dyzet e gjashtemilion e nenteqind e shtatedhjetë e katermije e nenteqind e tridhjetë e dy)

11.Operatori ekonomik NDERTIMI sh.p.k NUIS K11325002C

Vlera 148,415,164 leke pa TVSH (Njeqind e dyzet e tetemilion e katerqind e pesembedhjetemije e njeqind e gjaashedhjetete e kater)

12.Operatori ekonomik CURRI sh.p.k. NUIS J67902718S

Vlera 153,996,183.59 leke pa tvsh (Njeqind e pesedhjetete e tremilion e nenteqind e nentedhjetete e gjashtemije e njeqind e tetedhjetete e tre pike pesedhjetete e nente)

13.Bashkimi i operatoreve ekonomik "ONI" sh.p.k NUIS J66902008N & LIQENI VII sh.p.k, me NUIS K01730502W perfaqesuar nga "ONI" sh.p.k.

Vlera 168,705,345.64 leke pa TVSH (Njeqind e gjashtedhjetete e tetemilion e shtateqind e pesemije e treqind e dyzet e pese pike gjashtedhjetete e kater)

14.Bashkimi i operatoreve ekonomik ALKO-IMPEX General Construcion dnsh NUIS K91326028I & LODI CONSTRUCTION sh.p.k, me NUIS L77127002C perfaqesuar nga ALKO-IMPEX General Construcion dnsh.

Vlera 169,069,110 leke pa TVSH (Njeqind e gjashtedhjetete e nentemilion e gjashtedhjetete e nentemije e njeqind e dhjetete)

Ka pjesërmarrës te skualifikuar

1-U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik ALKO-IMPEX General Construcion dnsh NUIS K91326028I & LODI CONSTRUCTION sh.p.k, me NUIS L77127002C perfaqesuar nga ALKO-IMPEX General Construcion dnsh per keto arsye:

-OE "Lodi Konstruksion" shpk ka paraqitur vetem nje kontrate e cila nuk ploteson vleren ne raport me perqindjen e pjesëmarrjes së tij në bashkim.

2-U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik VALONA KONSTRUKSION sh.p.k NUIS K26330202E & VIBTIS sh.p.k, me NUIS L02103503S perfaqesuar nga VALONA KONSTRUKSION sh.p.k. per keto arsye:

-OE VALONA KONSTRUKSION, shpk & VIBTIS Shpk nuk paraqiten marrveshje bashkëpunimi, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

3-U skualifikua Bashkimi i operatoreve ekonomik BIBA-X sh.p.k NUIS K32618815N & PEPA GROUP GROUP sh.p.k, NUIS L42215009L& Progres Shkodra sh.p.k NUIS M17324001D perfaqesuar nga Progres Shkodra sh.p.k. per keto arsye:

OE "Progres Shkodra"shpk nuk paraqiten kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

a) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- Fature tatimore perkatese.

OE "Biba"shpk nuk paraqiten kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

b) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

OE "Biba" shpk ne formularin permbledhes sipas shtojces 8 nuk deklarone emrat e tjere anetare te bashkimit te operatoreve ekonomike.

- Bilancet e vitit 2022 dhe 2021 te Progres Shkodra jane te pakonfirmuara nga Dega e Tatim taksave
- OE "Biba" shpk nuk ka paraqitur pune te ngjashme sipas zerave te preventivit qe ka marre persiper te realizoje pasi mungon certifikata e marrjes ne dorezim te punimeve per objektin: Rindertim I objektit te ri: Shkolle 9-vjecare dhe kopshti Bedrije Bebeziqi...
- Progres Shkodra nuk ka paraqitur pune te ngjashme sipas zerave te preventivit qe ka marre persiper te realizoje pasi kontrata me object: Ndertim magazine ne repartin ushtarak nr.1010 Vau I Dejes ,Shkoder, nuk konsiderohet si pune e ngjashme pasi I mungon miratimi nga ana e Autoritetit Kontraktor si nen/kontraktues

4-U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik "ONI" sh.p.k NUIS J66902008N & LIQENI VII sh.p.k, me NUIS K01730502W perfaqesuar nga "ONI" sh.p.k. per keto arsye:

OE "ONI" shpk nuk paraqiti kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tij në bashkim pasi kontrata e punimeve me Kolegjin Turk nuk ka bashkangjitur situacion punimesh dhe certificate te marrjes ne dorezim. Gjithashtu akt-kolaudimi eshte pa date.

5-U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik NDERTUESI 2014 sh.p.k NUIS L46827004L & "SHKELQIMI 07" sh.p.k, me NUIS K68121808W perfaqesuar nga NDERTUESI 2014 sh.p.k per keto arsye:

Operatori ekonomik "SHKELQIMI 07" SH.P.K. nuk percaktoi Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt sipas kriterave te vendosura nga AK ne shtojcen 7 ,pika 2.3.5 ne dokumentat standarte te denderit.

Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet;

a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjate gjithë kohës qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit. Operatori ekonomik "SHKELQIMI 07" SH.P.K ne formularin sipas shtojces 8 deklarone si Ing. Gjeodet A.K ,por Inxhinjeri nuk eshte i perfshire ne Licensen e shoqerise. Operatori ekonomik "SHKELQIMI 07" SH.P.K te vetdeklarimet e inxhinjereve deklarone Ing. Gjeodet Z.M , kurse ne formularin sipas shtojces 8 ky person deklarohet si teknik ndertimi.

6-U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik B-93 sh.p.k NUIS J62903508R & B93 II sh.p.k, NUIS L522090500& GRAMA sh.p.k NUIS J77304712J perfaqesuar nga B93 II sh.p.k per keto arsye:

- OE "B- 93" shpk ne formularin sipas shtojces 8 pika B Deklarata, nuk deklaroi subjektin , mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet ky operator ekonomik per nr e punonjesve.
- Vetdeklarimet e inxhinierëve të stafit të operatorit ekonomik "B- 93" shpk janë për një objekt tjetër prokurimi.

- Tek zeri I preventivit nr.12 nr. AN 3.6 prej e sistemim pemesh >76 keni vendosur njesime m2 ne vend te cope dhe sasine 150 ne vend te 10 sic parashikohet ne preventivin e punimeve te publikuar nga AK

7-U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik Nika sh.p.k. NUIS J76705047U & MANE/S sh.p.k, me NUIS J64103865K perfaqesuar nga Nika sh.p.k. per keto arsye:

- Operatori Ekonomik "Mane/S" Shpk nuk paraqiti kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim pasi nuk janë me natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit.

Në bazë të përcaktimeve të legjislativës për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme)

- Ne preventivin e paraqitur tek zeri me nr.233 An. E33 Klips tub rigid Ø20mm copë 70 keni ofertuar me vlerën zero duke mos përmbushur detyrimin për plotësimin korrekt të shtojcës 2 "Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit", të DST, ku përcaktohet "Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës

- Nuk keni aplikuar në SPE si bashkim operatorësh ekonomike , por vetëm si operatori ekonomik Nik ash.p.k ne kundërshtim me udhëzimet e Agjencisë së Prokurimeve Publike për ofertimin si bashkim operatorësh ekonomike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "KEVIN KONSTRUKSION sh.p.k NUIS K71401004W , me adresë: Rruga Adem Jashari, Nderresa 4, Hyrja 10, Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë oferta e paraqitur me vlerë totale prej 131,777,121.25 (Njëqind e tridhjetë e një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e një pike njëzet e pesë) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Shkodër, Njësia e Prokurimit. Adresa: Rruga 13 Dhjetori] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO JO

AGJENCIA KOMBETARE TE UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Drejtuari: Operatorit Ekonomik Shoqëria “GJOKA KONSTRUKSION” sh.p.k, me NIPT J91815014U, me seli në Njësia 5, Rruga “Dora D’Istria”, Hyrja nr. 6, Pasuria me numër Nr. 7/637+1-N2, Nr. 7/637+2- N1, Z.K 8270 Tiranë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur me mjete elektronike / punë.

Numri i referencës së procedurës: REF - 12475-07-08-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Ndërtim Ujësjellësi Rajonal nga burimet e Përroit të Lopës dhe Gurrave të Ketës Faza II, Bashkia Klos

Afati kohor për ekzekutimin: 18 (tetëmbëdhjetë) muaj

Fondi limit: 289,594,400 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë pa TVSH

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto X
- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të këtij Njoftimi, ju informojmë se në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik:

- Shoqëria “GJOKA KONSTRUKSION” sh.p.k. NIPT J91815014U

Vlera e Ofertës: 260,301,345.08 (dyqind e gjashtëdhjetë milion e treqind e një mijë e treqind e dyzet e pesë pikë zero tetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k.

Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k
Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k

NIPT K47103804L
NIPT K66613407H

Vlera e Ofertës: 250,478,034.27 (dyqind e pesëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tridhjetë e katër pikë njëzet e shtatë) lekë pa TVSH

3. Operatori Ekonomik:

- Shoqëria “JUNIK” sh.p.k

NIPT J68007522L

Vlera e Ofertës: 266,419,977(dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

4. Operatori Ekonomik:

- Shoqëria “SELAMI” sh.p.k

NIPT J77304706L

Vlera e Ofertës: 269,496,971.51 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH

5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k & Shoqëria “BAJRAMI N.” sh.p.k.

Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k

NIPT J68310708M

Shoqëria “BAJRAMI N.” sh.p.k

NIPT K02727202O

Vlera e Ofertës: 257,511,075 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

Oferta të refuzuara nga Autoriteti Kontraktor:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” me të dhëna: Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k me NIPT K47103804L dhe Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k me NIPT K66613407H, me vlerë të ofertës 250,478,034.27 (dyqind e pesëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tridhjetë e katër pikë njëzet e shtatë) lekë pa TVSH; S’ Kualifikohet për këto arsye:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor, pas verifikimit të kryer të dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomikë ka konkluduar se:

Bazuar në Kriteret e Vecanta për Kualifikim, të publikuara në Dokumentat Standarte të Tenderit, konkretisht Pika 2.3.2 e Kapitullit “Kapaciteti Teknik”, pikat e Licensës, rezultoi se njëri nga Operatorët e këtij Bashkimi konkretisht Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k nuk plotëson pikën e licensës NP-7 Kategoria E dhe pikën e licensës NP-11, Kategoria A.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k, rezulton se është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi e datës 29.07.2024 për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive, nënshkruar ndërmjet Shoqërisë “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k dhe Shoqërisë “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k, nga ku Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 50% të punimeve dhe Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 50% të punimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë në mënyrë elektronike nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë

Autoritetit Kontraktor konstatoi se në përmbushje të Kriterit 2.3.2 Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k ka paraqitur Licensen NZ. 4933/16 të lëshuar nga MIE.

Operatori Ekonomik Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k ka paraqitur Licencen NZ. 3279/20, lëshuar nga MIE. Për Operatorin Ekonomik Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k, konstatohet se ky Operator Ekonomik nuk është i licensuar për Kategorinë NP-11 (Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë) Klasifikimi A, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në Dokumentat Standart të Tenderit të procedurës së prokurimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet akt marrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriteve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentat e Tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi goftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përsa i përket arsyeve të s’kualifikimit të mësipërm, i është referuar edhe Vendimit Nr. 156/2020 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu, referuar Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, konkretisht pikës 2.3 të Kapacitetit Teknik, punëve të ngjashme të dorëzuara nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor konstaton se ky bashkim nuk plotëson kriterin për punën e ngjashme në vlerat e kërkuara sipas përcaktimeve të Autoritetit Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Në nenin 92 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”

Në nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit si dhe rregullat e prokurimit publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k, në përmbushje të kriterit për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit, rezultoi se nga krahasimi i situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të realizuara me preventivin dhe relacionin teknik të objektit të prokurimit, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë ka kryer punime të ngjashme në një vlerë e cila nuk plotëson asnjë prej % (përqindjeve) të kërkuara për punët e ngjashme në pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik të DST-së.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se për sa kohë Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k me anë të dokumentacionit të paraqitur, nuk plotëson as pikën “a” dhe as pikën “b” të nenit 39, pika 5 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si rezultat nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7, “Kapaciteti Teknik” në Dokumentat Standarte të Tenderit, për procedurën e prokurimit.

Mbështetur në nenin 92 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për sa i përket arsyeve të s'kualifikimit të mësipërm, i është referuar edhe Vendimit Nr. 611/2020 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerësoi me 0 pikë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s'kualifikimin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “VIANTE KONSTRUKSION” sh.p.k & Shoqëria “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k.

2. Operatori Ekonomik Shoqëria “SELAMI” sh.p.k me NIPT J77304706L, me vlerë të ofertës 269,496,971.51 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, S’Kualifikohet për këto arsye:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor, pas verifikimit të kryer të dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ky Operator Ekonomik ka konkluduar se:

Referuar Kritereve të Vecanta të Kualifikimit të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST konkretisht Kriteri 2.3.2 pika b) e Kapitullit “Kapaciteti Teknik”:

“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba Ujësjiellësi PE
- Rakorderi Ujësjiellësi PE
- Matësa Uji
- Pompa

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë certifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.”

Operatori Ekonomik Shoqëria “SELAMI” sh.p.k ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm një autorizim për tuba, për një objekt tjetër prokurimi, duke mos pasur asnjë dokumentacion tjetër dhe duke mos plotësuar kështu këtë pikë të kritereve.

Autoriteti Kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor vlerëson me 0 pikë Operatorin Ekonomik Shoqëria “SELAMI” sh.p.k.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqëria “SELAMI” sh.p.k.

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k & Shoqëria “BAJRAMI N.” sh.p.k, me të dhëna Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k me NIPT J68310708M dhe Shoqëria “BAJRAMI N.” sh.p.k me NIPT K02727202O, me vlerë të ofertës 257,511,075 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH. S’Kualifikohet për këto arsye:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor, pas verifikimit të kryer të dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomikë ka konkluduar se:

Referuar Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, konkretisht pikës 2.3 të Kapacitetit Teknik, punëve të ngjashme të dorëzuara nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se ky bashkim operatorësh ekonomikë nuk plotëson punën e ngjashme në vlerat e kërkuara sipas përcaktimeve të Autoritetit Kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Në nenin 92 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*

Në nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285/2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetet e tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit si dhe rregullat e prokurimit publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k. dhe Shoqëria “BAJRAMI N.”sh.p.k në përmbushje të kriterit për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit, nga krahasimi i situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara, të realizuara me preventivin dhe relacionin teknik të objektit të prokurimit, Komisioni Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor konstaton se Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë të mësipërm, ka kryer punime të ngjashme në një vlerë e cila nuk plotëson asnjë prej % (përqindjeve) të kërkuara për punët e ngjashme në pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik.

Komisioni Vlerësimit të Ofertave gjykon se përsa kohë Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k. dhe Shoqëria “BAJRAMI N.” me anë të dokumentacionit të paraqitur, nuk plotëson as pikën “a” dhe as pikën “b” të nenit 39, pika 5 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, atëherë nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.1 të Shtojcës 7, “Kapaciteti Teknik” në dokumentat standarte të tenderit, për procedurën e prokurimit.

Mbështetur në nenin 92 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përsa i përket arsyeve të s'kualifikimit të mësipërm, i është referuar edhe Vendimit Nr. 611/2020 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në nenin 92, pika 1 gërma “b” të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Komisioni Vlerësimit të Ofertave, referuar dokumentacionit sa më sipër të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k. & Shoqëria “BAJRAMI N.” sh.p.k dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ku Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k. ka marrë përsipër kryerjen e 75 % të volumit të fitimit, ndërsa Shoqëria “BAJRAMI N.” ka marrë përsipër 25 % të fitimit, konstatoi se nuk ka një ndarje të punimeve konkrete që merr përsipër për të realizuar secili prej anëtarëve të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.

Referuar VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, e cila në nenin 88 pika 3 parashikon shprehimisht se: *“Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se me anë të kriterit të mësipërm, qëllimi i Autoritetit Kontraktor është vërtetimi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe/ose anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 88 pika 3 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar disponojnë stafin e nevojshëm, makineri, pajisjen në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k. & Shoqëria “BAJRAMI N.” në kontratën e bashkëpunimit neni 3 shprehet se pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë 75% e totalit të fitimit për Shoqërinë “STERKAJ” sh.p.k dhe 25% Shoqëria “BAJRAMI N.” sh.p.k, por nuk është përmendur në asnjë pikë të kësaj marrëveshje një ndarje në % e angazhimit të mjeteve teknike, inxhinerike dhe financiare të secilit operator.

Kjo do të thotë se në këtë procedurë ky bashkim operatorësh ekonomikë është trajtuar si një i tërë (si një operator i vetëm) me qëllim përmbushjen e kriterëve për realizimin e kësaj kontrate. Autoriteti Kontraktor e ka shumë të qartë që oferta është sjellë nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “STERKAJ” sh.p.k dhe Shoqëria “BAJRAMI N.” sh.p.k, nuk është e bazuar pasi qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 88 pika 3 e VKM Nr. 285/2021 “Për Miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, është që secili nga operatorët e bashkimit të disponojë kapacitetet teknike profesionale në përputhje me përqindjen që kanë marrë përsipër të realizohet nga secili prej tyre.

Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet akt marrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo

në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përse i përket arsyeve të s'kualifikimit të mësipërm, i është referuar edhe Vendimit Nr. 527/2020 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson me 0 pikë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë Shoqëria "STERKAJ" sh.p.k & Shoqëria "BAJRAMI N." sh.p.k.

Në zbatim të VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve e kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/bashkive” të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.6.2016 “Për rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullor publik”; VKB nr.38 datë 29.03.2023 “Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor ndodhur në Bashkinë Tepelenë” të sipërfaqes së llojit “Kullotë” me numër pasurie 495/6 ZK 3661, sipas certifikatës së pasurisë me kod unik 3661005072 në pronësi të Bashkisë Tepelenë, ndodhur në Njësinë Administrative Qendër, Bashkia Tepelenë:

NJOFTIM:

- Fillimin e procedurave të dhënies me qira të llojit “Kullotë” me numër pasurie 495/6 ZK 3661 me sipërfaqe 79.9092 ha, ndodhur ne Njësinë Administrative Qendër/ Bashkia Tepelenë.
- Qëllimi i përdorimit do të jetë “Për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj.” dhe “Agropylltari”.
- Çmimi dysHEME do të jetë në zbatim të VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore e jodrusore pyjore”, duke filluar nga 82’500 (tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë/ha/vit për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj. dhe 10’000 (dhjetë mijë) leke/ha/vit për Agropylltari, sipas raportit tekniko-ekonomik të miratuar.
- Afati i kontratës së qirasë është deri në 10 vjet.
- Vlerësimi i konkurrentëve do të bëhet sipas këtyre pikave:
 - Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin pdf. dhe format elektronik në shkallë 1:10’000 ku janë evidentuar elemente kryesore si: kufijtë natyrore, relieve, objekte aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave.....30 pikë.
 - Plani i biznesit dhe investimet.....20 pikë.
 - Niveli i punësimit.....10 pikë.
 - Masa e qirasë për ha/vit.....40 pikë.
- Tërheqja e dokumentacionit të nevojshëm do të bëhet pranë Bashkisë Tepelenë.
- Paraqitja e dokumentacionit do të bëhet në datën 27.09.2024 ora 10:00 në zyrën e protokollit të Bashkisë Tepelenë dhe konkurrimi do të vijojë në salleën e mbledhjeve.
- Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurrim është:
 - a) kërkesën e operatorit së bashku me gjeneralitetet e tyre.
 - b) Ekstraktin e regjistrimit ne QKB për objektin e veprimtarisë.

- c) Projektin teknik të hartuar nga specialist të licencuar ku janë trajtuar të gjithë elementet e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar.
- d) planbизнесin e hollësishëm , ku të përshkruhen qartë:
 - i) plani i punësimit, ndikimi i tij në rritjen e të punësuarve.
 - ii) plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen.
 - iii) Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin, makineri që zotëron.
- e) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme (hartuar nga inxhinier pyjesh me licence).
- f) Ofertën e detyrimit mujor të qirasë.
- g) Certifikatën e regjistrimit dhe ekstraktin historik të regjistrimit në QKB të subjektit.
- h) NUIS/NIPT dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti nuk ka detyrime tatimore.
- i) Vërtetim nga institucionet përkatëse se nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka proces gjyqësor që lidhet me veprimtarinë që ushtron.
- j) Leje mjedisore për aktivitetin e kërkuar, (raport i ndikimit në mjedis i hartuar nga inxhinier mjedisi/studio mjedisore me licencë).
- k) Vërtetimin nga sektori i tatimeve nga Bashkia Tepelenë se subjekti nuk ka detyrime tatimore.
- l) Garanci të mjaftueshme me përballimin e investimit të parashikuar në planbизнесin e dorëzuar (vertetim nga banka).
- m) Deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për shkualifikim.

BASHKIA MALËSI E MADHE **NJOFTIM PËR PËR DHËNIEN ME QIRA**

Bashkia Malësi e Madhe kërkon të japë me qira sipërfaqe të fondit pyjor kullosor për qëllime pushimi, argëtimi dhe për veprimtari turistike, kampingje etj.

1. Fillimi i procedurave për dhënie me qira me anë të konkurimit të sipërfaqes së fondit Pyjor /kullosor publik sipas udhëzimit nr.1, date 09.06.2016 “ Për rregullat , Procedurat e Kërkimit , të shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për Dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik” ndodhet ne zonën kadastrale 3834 Nr.pasurie 869 të ekonomisë pyjore Fushë Zezë , me sipërfaqe 0.7844 ha dhe shtrihet në ngastren/nëngastren 107.

2. Cmimi dysHEME për fillimin e konkurimit do të jetë 96 184 (nëntëdhjetëegjashhtëenjqindetëdhjetëekatërmijë) lekë/ha/vit mbështetur në Raportin Teknik dhe tarifave të përcaktuara në, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca1/10 .

3. Afati i dhënies me qira do të jetë 10 vjet.

4. Veprimtaria që do të ushtrohet në sipërfaqen që do të jepet me qira , bazuar në Raportin Teknik nr.1298/2 Prot, datë 21.06.2024 do të jetë “ Për qëllime pushimi, argëtimi dhe për veprimtari turistike,kampingje etj.

5. Personat fizikë dhe juridike që do të marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetin e tyre ;
- b) ekstratin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen ;
- e) të dhëna për kapacitet teknike ,stafin ,makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme ;
- g) nivelin e punësimit në veprimtari;
- h) leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të kërkuar / raport paraprak i vlerësimit të ndikimit në mjedis hartuar nga specialiste të licensuar;
- i) cmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- j) adresën e subjektit ,telefon , email dhe faks.

6. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim ,janë:

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes (për këtë të paraqesë sigurimin e ofertës në masen 2% të vlerës së investimit të parashikuar);
- b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës , ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushen e veprimtarisë ;
- c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim , hetim në proces , detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

7. Vlerësimi i ofertës mbështetet në grumbullimin e pikëve si më poshte:

- a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet , i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore , si :kufijtë natyrore , relievi ,objektet aktuale , si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar , hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë ;
- b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë ;
- c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;
- d) nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë ;
- e) masën e qirasë për ha/vit 35 pikë.

Dokumentacioni i konkurimit duhet të paraqitet në një zarf të mbyllur të nënshkruar nga konkuresi me mbishkrimin “ Ofertë për dhënien me qira” dhe i dorëzohet komisionit të vlerësimit të ofertave në orën dhe datën e hapjes së konkurimit .

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme përbën shkak për skualifikim .

Vendi i zhvillimit të konkurrimit : Bashkia Malësi e Madhe, Koplík Qendër, Malësi e Madhe.

Ofertat dorëzohen nga të interesuarit/ konkurentët , fizikisht , me postë ose dorazi pranë sekretarisë së Bashkisë Malësi e Madhe.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave të interesuarve / konkurentëve është data 26.09.2024 ora 12:00.

Afati për hapjen e ofertave të konkurentëve do të jetë data 26.09.2024 ora 12:00 , Godina e Bashkisë Malësi e Madhe.

PROCEDURA KONKURRUESE PËR **LEJE MINERARE**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË **FTESË PËR OFERTË**

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në nenin 5 pika 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 36/1 të Ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, pikës 6 dhe 7, 9 (b, c), të VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar, VKM Nr.347, datë 29.04.2011 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”, VKM Nr.380, datë 1.6.2022 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2022 - 2024, në zbatim të strategjisë minerare”, Urdhrit të Ministrit Nr.227, datë 15.03.2012 “Për miratimin e planit vjetor minerar për vitin 2012”, Urdhrit të Ministrit Nr. 287, datë 05.12.2022 “Për miratimin e planit vjetor minerar 2023”, si dhe Urdhrit të Ministrit Nr. 123, datë 05.06.2024 “Për miratimin e planit vjetor minerar 2024”, shpall ftesën për pjesëmarrje në procedurën konkurruese për dhënien e të drejtës për aplikim për leje minerare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për zonat minerare konkurruese Nr. 407, Nr. 420/1, Nr. 122/7, Nr. 22/33.

2. Kërkohet që të realizohet aplikimi për leje minerare për zonat minerare konkurruese Nr. 407, Nr. 420/1, Nr. 122/7, Nr. 22/33, të miratuara në planet vjetor të viteve 2012, 2023 dhe 2024, me të dhënat dhe formën e formularit të ofertës të paraqitura në aneksin 1 të kësaj Ftesë për Ofertë.

3. Kërkesat për kualifikim dhe kriteret e konkurrimit dhe vlerësimit të ofertave për të drejtën e aplikimit për një leje minerare në zonat konkurruese jepen në përputhje me Ligjin Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar, VKM Nr.347, datë 29.04.2011 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për zbatimin e strategjisë minerare”, VKM Nr.380, datë 1.6.2022 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2022 - 2024, në zbatim të strategjisë minerare”, Urdhrit të Ministrit Nr.227, datë 15.03.2012 “Për miratimin e planit vjetor minerar për vitin 2012”, Urdhrit të Ministrit Nr. 287, datë 05.12.2022 “Për miratimin e planit vjetor minerar 2023”, si dhe Urdhrit të Ministrit Nr. 123, datë 05.06.2024 “Për miratimin e planit vjetor minerar 2024”.

4. Ofertuesit të paraqesin vetëm një Ofertë për një zonë konkurruese, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurë konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese. Shpenzimet e kryera për të marrë pjesë në procedurën konkurruese nuk rimbursohen nga Autoriteti Kontraktues.

5. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuar, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e procedurës konkurruese dhe të dërgohen tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, 1001.

6. Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit në bazë të shtetësisë.

7. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është:

Për zonat: Nr. 407, Nr. 420/1, Nr. 122/7, Nr. 22/33;

dt. 08.10.2024, ora 10⁰⁰

8. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.

9. Ofertat do të hapen në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në Sallën e Mbledhjeve, Kati i parë,

10. Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

NJOFTIME TË TJERA

BANKA E SHQIPËRISË TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Mirëmbajtje dhe riparim i disa pajisjeve UPS të Bankës së Shqipërisë, në Tiranë dhe degët e saj”.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit ‘Tender i hapur kombëtar’, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 2,400,300 Lekë. Kandidatët e interesuar mund të pajisen me dokumentet e tenderit, si më poshtë:

- Pranë Sektorit të Prokurimit të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë, Tel: +355 4 241 93 01 /02 /03, ext: 214, çdo ditë me paraqitjen e përfaqësuesit të kandidatit, vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 lekësh, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë, sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi me objekt: “Mirëmbajtje dhe riparim i disa pajisjeve UPS të Bankës së Shqipërisë, në Tiranë dhe degët e saj”;

ose

- Në formë elektronike, pas paraqitjes së kërkesës nga përfaqësuesi i kandidatit, në adresën elektronike të Bankës së Shqipërisë: avaraku@bankofalbania.org.

Në kërkesë duhet të citohet qartë objekti i prokurimit, emri i subjektit, NIPT-i, të dhënat e kontaktit si: adresa, numri i telefonit dhe e-mail-i ku do të dërgohen dokumentet e tenderit.

Oferta duhet të paraqitet në adresën: Banka e Shqipërisë, Selia Qendrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, (ish Hotel Dajti) Tiranë, Tel: 042 419 411, (ext: 214), deri më datë 26 Shtator 2024, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BANKA E SHQIPËRISË
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare”.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit ‘Tender i hapur kombëtar’, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 10,880,400 Lekë. Kandidatët e interesuar mund të pajisen me dokumentet e tenderit, si më poshtë:

- a. Pranë Sektorit të Prokurimit të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë, Tel: +355 4 241 93 01 /02 /03, ext: 214, çdo ditë me paraqitjen e përfaqësuesit të kandidatit, vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 lekësh, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë, sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi me objekt: “Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare”;
ose

- b. Në formë elektronike, pas paraqitjes së kërkesës nga përfaqësuesi i kandidatit, në adresën elektronike të Bankës së Shqipërisë: avaraku@bankofalbania.org.

Në kërkesë duhet të citohet qartë objekti i prokurimit, emri i subjektit, NIPT-i, të dhënat e kontaktit si: adresa, numri i telefonit dhe e-mail-i ku do të dërgohen dokumentet e tenderit.

Oferta duhet të paraqitet në adresën: Banka e Shqipërisë, Selia Qendrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, (ish Hotel Dajti) Tiranë, Tel: 042 419 411, (ext: 214), deri më datë 27 Shtator 2024, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BANKA E SHQIPËRISË
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Shërbimi 2-vjeçar i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomën e serverave dhe arkivën e Bankës së Shqipërisë”.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit ‘Tender i hapur kombëtar’, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 2,800,000 Lekë. Kandidatët e interesuar mund të pajisen me dokumentet e tenderit, si më poshtë:

- a. Pranë Sektorit të Prokurimit të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë, Tel: +355 4 241 93 01 /02 /03, ext: 214, çdo ditë me paraqitjen e përfaqësuesit të kandidatit, vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 lekësh, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë, sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi me objekt: “Shërbimi 2-vjeçar i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomën e serverave dhe arkivën e Bankës së Shqipërisë”;

ose

- b. Në formë elektronike, pas paraqitjes së kërkesës nga përfaqësuesi i kandidatit, në adresën elektronike të Bankës së Shqipërisë: avaraku@bankofalbania.org.

Në kërkesë duhet të citohet qartë objekti i prokurimit, emri i subjektit, NIPT-i, të dhënat e kontaktit si: adresa, numri i telefonit dhe e-mail-i ku do të dërgohen dokumentet e tenderit.

Oferta duhet të paraqitet në adresën: Banka e Shqipërisë, Selia Qendrore Nr. 2 e Bankës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, (ish Hotel Dajti) Tiranë, Tel: 042 419 411, (ext: 214), deri më datë 07 Tetor 2024, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA
NJOFTIM

Në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe V KM-së nr. 53 1, datë 7.9.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për Ilogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë”, njoftojmë se është miratuar katalogu i

standardeve me objekt prokurimi: "Blerje tonerash", me urdhër nr. 142 datë 10.09.2024 të Administratorit të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Katalogu mund të shkarkohet edhe në faqen zyrtare të obp.al në kategorinë: "Rreth nesh"

nënkategoria: "Publikime": <https://obp.al/wp-content/uploads/2024/09/KATALOG-STANDARDESH-BLERJE-TONERASHLdf>

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
NJOFTIM ANULLIMI

Emri: "Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore"
Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu" Nr. 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re"
Email: info@iktk.gov.al
Faqja e internetit: www.iktk.gov.al

Objekti i procedurës së Konkurrimit publik: "Restaurimi i Kishës së Shën Kollit Krutje – Faza I", Krujtje e Sipërme, Lushnje.

Publikuar në datë 02.09.2024 në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 56 datë 02.09.2024.

Fondi limit: 6.250.000 (gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë).

Arsyet e Anulimit: Nuk është paraqitur asnjë ofertë nga asnjë operator ekonomik.

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
Njoftim për vend të lirë pune

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, shpall njoftimin për konkurim të hapur, për vend të lirë pune në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës për staf administrativ si më poshtë:

Drejtor, Drejtorja e Planifikimit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati/ja për Drejtor pranë kësaj drejtorie, janë si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
2. Preferohet që një nga ciklet e studimet ta ketë përfunduar jashtë vendit me rezultate të larta;
3. Të ketë përvojë pune mbi 10 (dhjetë) vjet në pozicione të ngjashme;
4. Të ketë eksperiencë në zbatimin e projekteve të financuar nga donatorë të huaj ose në organizata me financim të huaj;
5. Të ketë eksperiencë në kordinimin e partneriteteve me organizata vendase dhe ndërkombëtare.
6. Të kenë përvojë në planifikimin, zhvillimin dhe zbatimin e strategjive;
7. Të ketë studiuar ose të jetë trajnuar mbi politikat e BE-së;
8. Të ketë përvojë pune në Institucione të Arsimit të Lartë;
9. Të ketë përvojë në përgatitjen e prodhimit të materialeve promocionale si broshura, flyer, fotografi etj;
10. Të kenë njohuri të shkëlqyera në shkrimin dhe editimin e raporteve përshkruese për donatorët ndërkombëtarë;
11. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, punë në grup, dhe aftësi menaxhuese;
12. Të ketë publikime në revista shkencore dhe/ose pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare.
13. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze. Njohja e një prej gjuhëve zyrtare të BE-së përbën avantazh;
14. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formularin e aplikimit për personel administrativ, i cili mund të shkarkohet në faqen e internetit të Universitetit në adresën www.uamd.edu.al ose të tërhiqet dorazi në zyrën e Burimeve Njerëzore të Universitetit;
- Tre letra rekomandimi dhe të paktën një nga tre letrat të jetë nga punëdhënësi / drejtuesi i fundit nëse ka një të tillë;
- Fotokopje të diplomave dhe lista e notave, të noterizuara (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- Çertifikata të njohjes së gjuhëve të huaja dhe të përdorimit të programeve bazë të kompjuterit. (të noterizuara)
- Fotokopje të kartës së identitetit, ose ndonjë dokumenti tjetër identifikimi;
- Fotokopje të noterizuar të librezës së punës, nëse ka, apo vetëdeklarim punësimi ose vetëdeklarim si i punësuar;
- Vetëdeklarim nga kandidati aplikues për gjëndjen gjyqësore;
- Raport mjeko ligjor që vërteton aftësinë e tij për punë;

Aplikantët të cilët i dorëzojnë dokumentat të pa noterizuara, ose kanë mangësi në dokumentacion skualifikohen menjëherë dhe nuk i nënshtrohen fazës së dytë.

Dokumentat duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën:

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Lagja 1, Rruga e Currilave, Durrës.

Aplikim për: Procedurën e konkurimit për staf administrativ në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.

- Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.
- Proçedura e përzgjedhjes së kandidaturave fillon menjëherë pas publikimit të këtij njoftimi dhe do të zhvillohet sipas Statutit dhe Rregullores të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.
- Afati për dorëzimin e dokumentave është 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Njoftim për vend të lirë pune

Në mbështetje të VKM Nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror” i ndryshuar, Shërbimi Social Shtetëror shpall konkurimin për pozicionin e lirë të punës:

Specialist (IT), në Sektorin e Koordinimit dhe Referimit në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Kandidati/ja që kërkon të punësohet në këtë vend pune duhet të plotësojë këto kriterë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë Bachelor në Informatikë, Informatikë/Ekonomike, Shkenca Kompjuterike, Inxhinjeri Elektronike. (Prioritet kanë Aplikantët me Master).
4. Preferohet të ketë eksperiencë pune në profesion;
5. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
6. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
8. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 18.09.2024, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror këto dokumente:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Jetëshkrimi (CV);
3. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
4. Fotokopje të librezës së punës;
5. Fotokopje të kartës së identitetit;
6. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çertifikatë familjare;
8. Vërtetim banimi;
9. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;

10. Çertifikata të kualifikimeve;
11. Referenca pune.

Pas verifikimit paraparak në datën 20.09.2024, do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej konkurimin, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Konkursi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin e Shërbimit Social Shtetëror që gjendet në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

1. Ligji Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”
2. Njohuritë mbi sistemet kompjuterike dhe mbi instalimin, konfigurimin dhe riparimin e pajisjeve hardware;
3. Njohuritë mbi sistemet e operimit dhe funksionimin e rrjeteve;
4. Njohuritë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve web based;
5. Njohuritë mbi sistemet operative: Microsoft Windows 8, 10

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendit të lirë të punës, rezultatet e verifikimit paraparak si dhe datën kur do zhvillohet testimi, mund t’i gjeni në adresën www.sherbimisocial.gov.al

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

Njoftim për vend të lirë pune

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 64, pika 1, Statutin e Universitetit, neni 45, si dhe në Rregulloren e universitetit neni 28, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, shpall konkurs për personel akademik me kohë të plotë, si më poshtë:

1. Personel akademik me kohë të plotë, në Departamentin e Agroushqimit, Fakulteti i Bujqësisë, (dy vende), në fushat e Agroushqimit, Bioteknologjisë ose Biokimisë.

Kritere të përgjithshme:

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas ligjit;

- të ketë mbaruar arsimin e lartë në specialitetin përkatës;
- të ketë mesatare të përgjithshme të notave mbi 8;
- të ketë njohuri të mira të një prej pesë gjuhëve të huaja të BE-së, vërtetuar me certifikatat ndërkombëtare të njohura nga MAS, ose të mbrojtura pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Tiranë.

Kritere të veçanta:

Preferohen kandidatët të cilët:

1. Kanë fituar gradë/titull shkencor, brenda ose jashtë vendit.
2. Kanë përfunduar studimet universitare në fushën e Agroushqimit, Bioteknologjisë ose Biokimisë.
3. Kanë përfunduar studimet universitare dhe të mëtejshme në universitete të njohura jashtë vendit.
4. Kanë përvojë në mësimdhënien universitare në lëndët që do të mbulojnë, si edhe në fushat sipas specialitetit përkatës, të paktën 3 vjet.
5. Kanë kryer kurse ose kualifikime brenda dhe jashtë vendit në fushën përkatëse.
6. Kanë bërë publikime brenda ose jashtë vendit në fushën e specialitetit përkatës.

Kandidatët, për pozicionin si më sipër, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a- Kërkesë për aplikim për vendin e punës;
- b- Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
- c- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- d- Fotokopje të diplomave dhe listave të notave të noterizuara;
- e- Fotokopje të diplomës/certifikatës së gjuhës së huaj dhe të kualifikimeve të tjera të noterizuara;
- f- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti);
- g- Vërtetim i gjendjes shëndetësore (Raport mjekësor për aftësinë në punë);
- h- Librezë shëndetësore (fotokopje);
- i- Deklaratë nga kandidati aplikues për konfliktin e interesit.

Diplomat, certifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me vërtetimin e njohjes dhe njësimit nga MAS, sipas përcaktimit të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015, neni 92, pika 3.

Dokumentet do të dorëzohen brenda 7 ditëve kalendarike nga e nesërmja e publikimit të njoftimit nga Agjencia e Prokurimit Publik, në zyrën e Protokollit të universitetit, me adresë: Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, Shëtitorja “Rilindasit”.

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervistë të drejtpërdrejtë.

Mungesa e një prej dokumentacioneve të kërkuara më sipër, sjell skualifikim të kandidatit.

DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE KORÇË**Njoftim për vend të lirë pune**

Në zbatim të Urdhërit nr. 163 datë 28.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 581, datë 28.09.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, DRTK Korçë shpall të hapur konkursin për pozicionin:

- Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë, Kategoria e pagës III-2

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave është data 19.09.2024

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- a) Menaxhon dhe koordinon punën e sektorit në tërësi
- b) Ndjek dhe evidenton në bashkëpunim edhe me sektorët e tjerë përditësimin e akteve ligjore dhe nënligjore në përputhje me veprimtarinë e institucionit, në përshtatje me Statutin dhe rregulloren;
- c) Bashkëpunon dhe bën interpretime ligjore, jep mendime dhe sugjerime, në rastet kur i kërkohet nga Titullari ose strukturat e tjera të institucionit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe problematikave të konstatuara në zbatim të detyrave të ngarkuara.
- d) Mbikëqyr dhe monitoron aktivitetet e Sektorit për përmbushjen e detyrave të ngarkuara, për këshillimin në lidhje me çështjet ligjore të akteve që dalin nga ministria.
- e) Kontribuon në procesin e vendimmarrjes në nivel drejtorie nëpërmjet sigurimit të dhënave të detajuara për nevojat e këshillimit ligjor dhe monitorimit të impaktit të akteve rregullatorë.
- f) Kryen detyrat që i caktohen nga Titullari i institucionit, gjithmonë në lidhje me fushën e veprimtarisë së sektorit ku bën pjesë, në ushtrim të kompetencave dhe funksioneve të përcaktuara me ligj.
- g) Ofron konsulencë të nevojshme ligjore si dhe kontribuon në zgjidhjen e kërkesave për gjetjen e opsioneve dhe hapësirave ligjore mbi problemet që parashtrihen në rrugë administrative, për çështje me natyrë ligjore (juridike).
- h) Organizon punën brenda sektorit dhe përfaqëson institucionin në të gjitha proceset gjyqësore, ku është palë.
- i) Merr pjesë në grupe pune apo komisione takime pune, seminare, konferenca ose takime të tjera me urdhër të eprorit.
- j) Kryen detyra të tjera përkatëse që i ngarkohen nga eprori direkt.

1.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT DHE KRITERET E VEÇANTA:

Për këtë procedure mund të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet:

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësohen janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- c) Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- d) Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- e) Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe kriteret e veçanta:

- f) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në shkenca Ekonomike/Juridike dhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehësimi nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë).
- g) Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.
- h) Të ketë njohuri të mira në programet bazë të kompjuterit;
- i) Të zotërojë të paktën një nga gjuhët e Bashkimit European.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DOREZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së arkiv-protokollit brenda datës 19.09.2024 dokumentet origjinalë (ose të njehësuar me origjinalin) si më poshtë:

- a- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip
- b- Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Master)
- c- Fotokopje të noterizuar të librezës së punës
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- f – Vërtetim të gjendjes gjyqësore
- h- Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Komisioni i ngritur për ndjekjen e procedurës do të shpallë në stenden e institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga komisioni për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adreses së e-mail).

1.4 FUSHA E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuri mbi Kushtetutën
- b- Njohuri mbi Kodin e Procedurave Administrative, i ndryshuar
- c- Ligjin Nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.
- d- Ligjin 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- d- Njohuri mbi Ligjin nr. 90/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.
- e- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- f- Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Rregullat e etikës në administratën publike”
- g- VKM-në Nr. 581, datë 28.8.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a - Dokumentacionin e dorëzuar deri në 30 pikë, Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv.

a - Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 30 pikë;

Kandidati që merr më pak se 70 pikë në fund të konkurimit nuk konsiderohet i suksesshëm.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të DRTK Korçë dhe stendën e institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronik.

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Njoftim për vend të lirë pune

Në mbështetje të VKM nr. 135, datë 07.03.2018 “Për Miratimin e Statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar Shërbimi Social Shtetëror shpall konkurimin për pozicionin e lirë të punës:

Kujdestar në Shtëpinë e Fëmijëve Shkollor Tiranë.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati/ja:

- Të jetë shtetase shqiptare;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- Të ketë trajnime për çështje të fëmijëve (trajnim i certifikuar);
- Të ketë eksperiencë pune;
- Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
- Të mos jetë e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi nga puna.

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 30.09.2024, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, këto dokumente:

- Kërkesën për aplikim;
- Jetëshkrim (CV);
- Fotokopje të dëftesës së pjekuris;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dëshmi penaliteti ose deklaram të gjendjes gjyqësore;
- Raport mjekësor që vërteton gjendjen e saj shëndetësore;
- Çertifikata të kualifikimeve;
- Referenca pune.

Pas verifikimit paraprak në datën 02.10.2024, do të shpallet lista e konkurentëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme, si edhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Konkurimi do të bazohet në njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

- Njohuri specifike të vendimit nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendit të lirë të punës, rezultatet e verifikimit paraprak si edhe datën kur do zhvillohet intervista, i gjeni në adresën: www.sherbimisocial.gov.al

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Njoftim

Bazuar në nenin 3, 57 pika 2, e ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5, 59 pika 4, 61 pika 1, 63 dhe 64 të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT) si dhe në Udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. 4, datë 02.07.2024, “Për punësimin e personel akademik me kohë të pjesshme dhe mbikëqyrës klinik për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, shpall thirrjen publike për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të konkurrojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (Pedagog të Jashtëm) në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, në UMT, për vitin akademik 2024-2025.

Kandidatët e interesuar për personel akademik me kohë të pjesshme, me shpalljen e këtij njoftimi mund të aksesojnë/vizitojnë faqet zyrtare të internetit të Fakultetit të Mjekësisë Dentare si dhe të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, cituar më poshtë, për t’u njohur me kriteret, dokumentacionin, afatet dhe procedurën që duhet të plotësojnë, dorëzojnë dhe ndjekin për të konkurruar për personel akademik me kohë të pjesshme (Pedagog të Jashtëm) në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

- <http://www.umed.edu.al>
- <https://www.fmd.edu.al>

Universitetit të Mjekësisë, Tiranë
Fakulteti i Mjekësisë Dentare

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË TIRANË **Njoftim për vend të lirë pune**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë shpall 1 (një) vend të lirë pune: SHOFER

Kandidati duhet të plotesojë këto kushte:

- Te ketë shtetësi Shqiptare
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të mos jetë e dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre Penale
- Të ketë përfunduar të paktën arsimin e mesëm.
- Të ketë vendbanimin në territorin e Bashkisë Tiranë,
- Të ketë aftësi të mira komunikimi, organizimi dhe pune në grup.

Të interesuarit duhet të paraqesin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda datës 18.09.2024 këto dokumente :

- Kërkesë me shkrim për t'u punësuar
- Diplomë pjekurie të noterizuar
- Përshkrimin e edukimit dhe karrieres profesionale (CV)
- Dëshmi Penaliteti të lëshuar brenda 3 muajve
- Raport mjeksor për aftësi në pune
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Librezë pune (nëse disponon)
- Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata që nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara dhe të dorëzohen ne zyren e protokollit te gjykeses brenda datës 18.09.2024. Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentave kandidatët do të njoftohen për zhvillimin e intervistes.

TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Njoftim për vend të lirë pune

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, shpall audicionin për pozicionin e lirë të punës “Solist i Dytë Lirik (Tenor)” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.

Për t’i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t’i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurentëve, TKOBAP-ja nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme.

Audicioni do të zhvillohet në datën 11.10.2024, ora 14:30, në Hollin e Katit të Dytë të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje të certifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.
7. Të ketë njohuri të mira gjuhëve të huaja (preferohet anglisht dhe italisht).

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur
2. Jetëshkrimi (CV)
3. Fotokopje të mjetit të identifikimit
4. Diploma, suplementi dhe lista e notave të noterizuara. Nëse aktualisht jeni në përfundim të studimeve të larta në nivelin Master për kanto, të depozitohet diploma Bachelor dhe lista e notave të noterizuara dhe një vërtetim se jeni në përfundim të studimeve. Në rast se arsimimi

është kryer jashtë vendit, të depozitohet edhe dokumenti i njohjes së tyre nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, tituj artistikë, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e aplikantit
6. Libreza e punës e noterizuar ose vërtetim mbi pagesën e kontributeve
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore.

Dokumentacioni të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri në datën 4.10.2024, me objekt: Aplikim për pozicionin e punës “Solist i Dytë Lirik (Tenor)”.
Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e tyre sjell skualifikimin e aplikantit.

Programi për konkurimin është interpretimi i roleve të plota (përzgjedhja e roleve për interpretimin nga kandidatët do të bëhet Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:

Verdi: “La Traviata”

Verdi: “Rigoletto”

Verdi: “Macbeth”

Puccini: “La Boheme”

Puccini: “Madama Butterfly”

Donizetti: “Lucia Di Lammermoor”

Puccini: “Messa Di Gloria”

Mozart: “Messa Di Requiem”

Shënime:

1. Komisioni ruan të drejtën të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.
2. Nëse aplikantët nuk do të kenë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor do të mundësojë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar paraprakisht nga aplikanti në momentin e depozitimit të dokumentacionit.
3. Pas verifikimit të dokumenteve të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e audicionit brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën e postës elektronike: sekretaria@tkob.gov.al.